1 East Bode Road
Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.
awana.org
(630) 213-2000

© 2017 Awana® Clubs International

1 2 3 4 5 6 22 21 20 19 18 17

Scriptures taken from the Holy Bible, New International Version®, NIV®. Copyright ©1973, 1978, 1984 by Biblica, Inc.™ Used by permission of Zondervan. All rights reserved worldwide. www.zondervan.com.

LETËR PËR DREJTUESIN

Përshëndetje! Gati për një udhëtim? Do të zhytemi thellë në historinë më të bukur që është treguar ndonjëherë. Ky libër fokusohet në historinë e Perëndisë. Do të nisim një shqyrtim të mënyrës se si të gjitha historitë e Biblës përshtaten së bashku. Nuk do të mbulojmë çdo detaj, por do të flasim për disa nga temat kryesore të Biblës. Edhe nëse studentët e tu dëgjojnë për herë të parë rreth Biblës apo nëse janë rritur në kishë, kjo histori, historia e Perëndisë, është shumë e rëndësishme. Para se të fillojmë, ju kemi mundësuar një shpjegim të mënyrës si funksionon Trek Bible Study si dhe kemi përgatitur Trek Essentials (pikat thelbësore). Kemi përfshirë gjithashtu atë që pritet që një drejtues të regjistrojë në një seksion. Gati për të filluar? Nisemi!

SI TË PËRDORNI LIBRIN E STUDIMIT BIBLIK TREK

Aktiviteti hyrës

Ku të fillojnë? Filloni këtu! Në fillim të çdo mësimi, studentët kanë një aktivitet hyrës që do t'i prezantojë me mësimin. Ka një hapësirë që ata të krijojnë, vizatojnë, të ngjisin foto të krijimeve të tyre, të bëjnë lista etj. Të gjithë studentët duhet ta plotësojnë këtë seksion që drejtuesi ta firmosë.

Fjalë kyç

Çdo mësim ka një fjalë kyç. Fjalët kyç përmbajnë përkufizimin e konceptit të çdo mësimi. Kërkojuni studentëve tuaj t'i shtojnë këto fjalë në fjalorin e tyre. Fjalët kyç do t'i ndihmojnë me studimet biblike tani, por edhe në të ardhmen.

Mendimi kyç

Mendimi kyç është një përshkrim i shkurtër i asaj për çfarë flitet në mësim.

Mësimi

Studimi biblik fillon me një pasazh nga Shkrimi. Mos e anashkalo këtë pjesë! Kërkoji gjithmonë studentëve të fillojnë me leximin e Fjalës së Perëndisë. Pastaj, vazhdo me leximin e studimit.

Vargu kyç

Vargu kyç është për t'u mësuar përmendësh. Studentët e tu duhet ta mësojnë vargun që drejtuesi të firmosë. Poshtë vargut kyç ka një shpjegim të kuptimit të tij (studentët nuk duhet të mësojnë përmbledhjen që të plotësojnë seksionin). Sigurohu që studentët ta mësojnë vargun dhe të dinë kuptim e tij.

Devocionet

Çdo mësim përmban katër devocione. Çdo devocion nis me një pasazh të vogël nga Shkrimi për t'u lexuar. Pastaj ka disa mendime mbi të cilat duhet të reflektoni dhe disa pyetje që duhet t'i përgjigjeni. Kërkoju studentëve të fillojnë dhe të praktikojnë një kohë me Fjalën e Perëndisë. Studentët duhet ta plotësojnë këtë seksioni që drejtuesi të firmosë.

Çfarë kërkohet që mësuesi të firmosë plotësimin e një seksioni?

1. **Studentët duhet të plotësojnë aktivitetin hyrës në fillim të çdo mësimi.**
2. **Studentët duhet të recitojnë vargun përmendësh.**
3. **Studentët duhet të plotësojnë devocionet.**

Aktivitet hyrës

Këtu studentët do të fillojnë çdo mësim. Ky aktivitet prezantues është i njëjtë si studimet biblike. Mund t'u rekomandosh studentëve që përdorin Trek Essentials, të mbajnë një bllok apo fletore më vete për të shënuar përgjigjet e aktivitetit të çdo jave.

Vargu kyç

Ky është vargu që duhet mësuar përmendësh çdo javë. Është i njëjti varg me atë te **Studimi biblik.**

Mësimi

Ky është mësimi kryesor. Përmbajtja këtu është ndryshe nga ajo e **Studimit biblik**, por materiali mësimor është i ngjashëm me atë të **Studimit biblik**.

Mendimi kyç

Ky është një përshkrim i shkurtër që përmbledh idenë kryesore të çdo mësimi. Mendimet Kyç janë njësoj si te **Studimi biblik**.

Fjalë kyç

Përkufizime të fjalëve kyç në mësime. Fjalët kyç janë njësoj si te **Studimi biblik**.

Leximi nga Bibla

Çdo mësim ka një pasazh nga Shkrimi, të cilën studentët duhet ta lexojnë. Këto pasazhe biblike janë të njëjta me ato të **Studimit biblik**.

Pyetjet për diskutim

Çdo mësim ka dy pyetje për t'u diskutuar, në mënyrë që studentët të reflektojnë në lidhje me gjërat që sapo mësuan. Këto pyetje janë të njëjta me ato të listuar në seksionin Të fillojmë në pjesën Diskutoje të mësimit.

SIGUROHU TË VIZITOSH FAQEN AWANA.ORG/TREK1PRESENTATIONSLIDES DHE SHKARKO FAQET E TREK 1 PRESENTATION.

Kemi përfshirë faqet prezantuese si burim mësimor shtesë. Çdo faqe përmban një nënfaqe me titullin, një me vargun kyç, një me përmbledhjen e mësimit dhe një faqe të ndryshueshme që ti mund ta përdorësh kur mëson studentët e tu.





Mësimi 1.1

PARA SE TË NISTE FILLIMI

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: GJONI 1:1-13

VARGU KYÇ:

Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.

Gjoni 1:1-3

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJE E MËSIMIT:

Çdo histori e ka një fillim. Historia jonë nis me krijimin, atëherë kur nisi fillimi. Megjithatë, Perëndia nuk ka pasur kurrë një fillim. Perëndia ka ekzistuar gjithmonë. Nuk ka pasur kurrë një kohë kur Perëndia nuk ka ekzistuar. Ai është Krijuesi i pakrijuar i gjithçkaje dhe Ai ka ekzistuar gjithmonë. Kjo temë quhet paraekzistenca e Krishtit. Në ungjillin sipas Gjonit, Gjoni e nis këtë libër të Besëlidhjes së Re në mënyrë shumë të ngjashme me fillimin e librit të parë të Besëlidhjes së Vjetër. Libri i Zanafillës nis me frazën: Në fillim... dhe Gjoni gjithashtu e nis në të njëjtën mënyrë. Kapitulli i parë i Gjonit është shumë i rëndësishëm. Tregon se para se të niste fillimi ishte Fjala. Kjo Fjalë është Jezu Krishti. Është e rëndësishme të kuptojmë se Krishti ka ekzistuar para krijimit dhe se ka qenë pjesë aktive e hyjnisë gjatë krijimit. Gjithçka u bë me anë të Tij. Është gjithashtu e rëndësishme të dimë se Krishti nuk u krijua. Ai nuk ishte një zot i krijuar, por Ai është Perëndi. Gjoni merr goxha kohë në ungjillin e tij për të lejuar fjalët e Jezusit të na vërtetojnë ne dhe botës se Ai është hyjnor. Ky mësim është një pikë shumë e mirë nisjeje në të kuptuarit e doktrinës së mirë. Është gjithashtu një mësim thelbësor mbi të cilin ndërtohet e gjithë historia. Nëse Jezusi nuk është hyjnor dhe i barabartë me Perëndinë Atë dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë... çfarë kuptimi ka pjesa tjetër e historisë? Do të ishte thjesht një histori më shumë për një person të mirë. Megjithatë, kjo është më tepër se thjesht një histori në lidhje me një njeri të mirë. Kjo është historia e Perëndisë dhe Ai ka ekzistuar gjithmonë para krijimit të gjithçkaje.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Krishti është Fjala dhe Krijuesi i pakrijuar i gjithçkaje.
- Studentët do të dinë se Jezusi ka ekzistuar para krijimit. Ai është hyjnor dhe është po aq pjesë e hyjnisë sa pjesa tjetër e Trinitetit.
- Studentët do të dinë se gjithçka u krijua nga Jezusi dhe se kjo është historia e Perëndisë.

FJALË KYÇ: Zanafilla: fillimi, krijimi ose burimi

MENDIMI KYÇ: Fjala, Jezusi, Perëndia, është Krijuesi i pakrijuar.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore do të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRAT (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojrat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë.

Loja 1 — Në kërkim të Slime (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 70, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Garë me jastëkë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 59, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Po fillon shkolla! Të gjithë kanë nevojë për ndihmë dhe për një fillim të ri. Kërkoju studentëve të mbledhin para që të blenë çanta dhe t'i mbushin ato me materiale shkollore të dhuruara nga kisha. Kjo është një mënyrë shumë e mirë për t'i kërkuar anëtarëve të vjetër të kishës që të bashkëpunojnë me shërbesën AwanaYM. Pasi të mbushni çantat, jepuani studentëve në nevojë ose dhurojini në një shkollë vendase. Kjo është gjithashtu një mundësi shumë e mirë për të bashkëpunuar me shkollat në të cilat shkojnë studentët e tu. Mund të habitesh se si një vepër e vetme mund të hapë derën për një bashkëpunim tjetër në të ardhmen. Sigurohu që mjetet janë të dobishme për studentët. Ata që janë në gjimnaz nuk kanë nevojë për lapsa me ngjyra dhe xixa. Ose... ndoshta u duhen! Përdore këtë ide në javët e ardhshme ose shënoje këtë faqe për ta përdorur një herë tjetër.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot, para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Kush bëri çfarë? Gjatë kësaj jave, studentët kanë filluar mësimin. Duhet të bënin një listë me 10 sende të krijuara nga njeriu. Duhet të qarkonin atë që mendonin se ishte objekti më i vjetër. Vendosën një kuti pranë objektit më të ri. Vendosën një yll pranë objektit që kishte origjinën më të largët. Vendosën dy yje pranë objektit me origjinën më të afërt. Së fundi, vendosën një shenjë verifikimi (check mark) pranë objektit që e kanë parë të krijohej.

1.
2.
3.
4.
5.
6.
7.
8.
9.
10.

Nise mësimin duke u dhënë mundësinë studentëve që të ndajnë përfundimet e tyre me grupin. Pasi të kenë pasur mundësinë për të ndarë me grupin, fillo t'i angazhosh me dy pyetjet e mëposhtme.

1. Si e di që këto objekte janë krijuar nga dikush në një vend specifik, në një kohë specifike?
2. 2. Si e di që këto objekte nuk janë krijuar para se të lindte njeriu që i krijoi?

PLANIFIKOJE TI-MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.

Gjoni 1:1-3

PËRMBLEDHJE E MËSIMIT: GJONI 1:1-17

JEZUSI FJALA KA EKZISTUAR GJITHMONË.

Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë.

Gjoni 1:1-2

JEZUSI ËSHTË KRIJUESI I PAKRIJUAR.

Të gjitha u bënë me anë të tij dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.

Gjoni 1:3

JEZUSI TË KRIJOI PËR NJË KOHË DHE VEND SPECIFIK TË HISTORISË.

Qe një njeri i dërguar nga Perëndia; emri i tij ishte Gjon. Ai erdhi si dëshmitar, për të dëshmuar për dritën, që të gjithë të besonin nëpërmjet tij; ai nuk ishte drita, por u dërgua për të dëshmuar për dritën. Ai (fjala) ishte drita e vërtetë, që ndriçon çdo njeri që vjen në botë. Ai (fjala) ishte në botë, dhe bota u krijua me anë të tij, por bota nuk e njohu. Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij, të cilët nuk janë lindur nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i burrit, por janë lindur nga Perëndia.

Gjoni 1:6-13

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: ZBATOJE (GRUPI I MADH)

ZBATIMI

Gati për pak argëtim? Ndaji studentët në grupe të barabarta. Sigurohu që çdo grup të ketë një copë të madhe letre dhe një ngjyrë përfaqësuese të vetën. Kërkoju studentëve të marrin ngjyrat e tyre. Duhet të kesh mjaftueshëm ngjyra që të mos ketë dy grupe me të njëjtën ngjyrë. Kërkoju grupeve të zgjedhin:

- Një ngjyrë, çfarë të duan
- Një problem
- Një stinë

Lejoji që për disa minuta, të krijuar në grupe, të gjejnë një shpikje të re. Shpikja duhet të përfshijë ngjyrën që kanë zgjedhur. Duhet të zgjidhin problemin që kanë përmendur dhe gjithashtu të përfshijnë stinën e vitit. Çdo grup duhet ta vizatojë krijimin në një copë letër të bardhë. Pasi grupi të ketë përfunduar krijimin e shpikjes së tyre, kërkoju ta vizatojnë. Pas 10 minutash, kërkoju të ndajnë idetë e tyre. Meqë ra fjala–kjo mund të jetë një kohë e mirë për të bërë foto apo video.

FJALË KYÇ: Zanafilla: fillimi, krijimi ose burimi

MENDIMI KYÇ: Fjala, Jezusi, Perëndia, është Krijuesi i pakrijuar.

Cili është qëllimi i kësaj? Përse ne mund të kemi ide për gjëra të jashtëzakonshme? Sepse jemi krijuar nga Krijuesi i gjithçkaje. Nëse këto vizatime i var në mur, askush nuk mund të debatojë për krijimin e tyre. Mund të mos i kuptojnë plotësisht apo të dinë se si funksionojnë, por ato janë krijuar, edhe nëse njerëzit që i shohin këto krijime mund të mos i kenë takuar kurrë studentët e tu.

KËTË JAVË:

Sfidoji studentët e tu të kërkojnë gjurmët e Perëndisë në botë.

ZBATIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.1 mësuam se, Fjala, Jezusi, Perëndia, është Krijuesi i pakrijuar.

DITA 3

LEXO: GJONI 1:4-5

Fjala i krijoi të gjitha gjërat, përfshirë edhe ty. Jeta që Ai na dha erdhi nga jeta që Ai kishte në vetvete (Gjoni 5:26). Ne nuk kemi jetë, as jetë të përjetshme, pa Të (Gjoni 6:57). Ne i detyrohemi Atij, për çdo pjesë të ekzistencës sonë.

SHTJELLOJMË:

Çfarë kuptimi mendon se ka errësira? Cili është një shembull i errësirës që ti sheh në botë? Sipas këtij pasazhi, cila është më e fortë, errësira jote apo drita e Krishtit?

DITA 4

LEXO: GJONI 1:6-11

Jezusi është i vetmi burim i dritës së vërtetë shpirtërore. Fakti që kaq shumë persona që nuk besojnë në Të, nuk e zbeh aspak dritën e Tij. Intensitetit i ndriçimit të dritës nuk përcaktohet nga sa njerëz po e shohin.

SHTJELLOJMË:

Përse mendon se bota nuk e njohu Jezusin? Çfarë po kërkon të jetë Jezusi?

DITA 5

LEXO: GJONI 1:12-13

Perëndia është zemërgjerë. Kushdo që e pranon dhuratën e Jezusit, duke besuar në emrin e Tij, bëhet fëmijë i Perëndisë dhe askush prej nesh nuk e ka fituar vetë këtë gjë.

SHTJELLOJMË:

Bazuar në këtë pasazh, a është e vërtetë që të gjithë njerëzit janë fëmijët e Perëndisë? Pse po ose jo? Dhe si e di që ti je?

DITA 6

LEXO: GJONI 1:14-17

Gjoni që shkroi këtë pasazh pa Jezusin në mish dhe tregoi atë që pa, ashtu siç bëri dhe Gjon Pagëzori. Ata ishin dëshmitar jo vetëm të Jezusit si person, por edhe të hirit të Perëndisë përmes Jezusit ndaj të gjithëve ne. Historia e tyre u bë historia e asaj që ata panë se Jezusi bënte në jetën e tyre dhe te të gjithë njerëzit përreth. Kjo mund të jetë edhe historia jote.

SHTJELLOJMË:

Kujt mund të fillosh t'i tregosh historinë e Perëndisë këtë javë? Kush ka nevojë të dëgjojë atë që Perëndia ka bërë në jetën tënde?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË?
ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Mos e mbaj mikrofonin vetëm për vete!

Pjesë e të qenët një drejtues i mirë në diskutim është të sigurohesh se ti, i rrituri, nuk e kalon të gjithë kohën duke folur. Pasi ta kesh bërë një pyetje, mos nxito të japësh përgjigjen tënde, thjesht sepse grupi nuk flet. Heshtja mund të jetë diçka e mirë. Do të thotë se studentët po e mendojnë pyetjen që sapo i bëre. Jepi disa minuta për ta përpunuar dhe pastaj prit përgjigjen e tyre. Nëse ata nuk mund t'i përgjigjen pyetjes tënde, përpiqu ta riformulosh që të jetë më personale për ta. E vërteta është se këta studentë kanë diçka për të thënë. Ndihmoji ata, por mos ji i vetmi pjesëmarrës në diskutim.

VLERËSIM:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepja studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

NGA ASGJËJA

JAVA E KRIJIMIT

Mësimi 1.2

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

PERËNDIA ËSHTË KRIJUESI I PAKRIJUAR I GJITHÇKAJE. Ai bëri gjithçka. Gjithçka që shohim është bërë nga dora e Tij. Mësimi i radhës flet për javën e krijimit dhe Perëndinë, i Cili është Krijuesi i pakrijuar që bëri gjithçka nga asgjëja. Ti mund të jesh krijues, por nuk mund të bësh diçka nga asgjëja. Mund të bashkosh elemente apo materiale të caktuara dhe të bësh një organizim të ri të një materie paraekzistuese, por vetëm Perëndia ka meritën e të krijuarit të gjërave nga asgjëja. Ai thjesht foli dhe gjërat filluan të ekzistonin përmes fuqisë së fjalëve të Tij. Kjo është diçka e rëndësishme që ne të kuptojmë Perëndinë si Krijues. Pjesë e të kuptuarit se kush jemi, është të njohurit e Krijuesit tonë. Thjesht fakti se Perëndia është Krijuesi ynë, na informon se për çfarë jemi krijuar. Në këtë mësim do ta shohim Perëndinë si Krijuesin tonë dhe do të shohim si Ai ka krijuar gjithçka nga asgjëja.

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT

VARGU KYÇ:

(Siç është shkruar: "Unë të kam caktuar atin e shumë kombeve"), është ati i të gjithë neve para Perëndisë që ai besoi, i cili i jep jetë të vdekurve dhe thërret gjërat që nuk janë sikur të ishin.

Romakëve 4:17

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë historinë e javës së krijimit.
- Studentët do të dinë çfarë thotë Bibla për Perëndinë në kapitullin e parë të Zanafillës.
- Studentët do të dinë dhe kuptojnë se Perëndia krijoi gjithçka njohim nga asgjëja.

FJALË KYÇ: Creatio ex nihilo: Krijimi nga asgjëja

MENDIM KYÇ: Në krijim, Perëndia bëri gjithçka nga asgjëja.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide, të cilat janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë.

Loja 1 — Vezë të rrahura (shih librin e lojërave, AwanaYM Game Book, faqja 66, për të gjetur listen e materialeve dhe shpjegimin e lojës)

Loja 2 — Luaj me gjërat (shih librin e lojërave, AwanaYM Game Book, faqja 73, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës)

Projekti i shërbesës — Inkurajimi. Të gjithë kanë nevojë për pak inkurajim. Megjithatë, të gjithë inkurajohemi në mënyra të ndryshme, sepse jemi krijuar të ndryshëm. Kërkoju studentëve të gjejnë një mënyrë për të inkurajuar njerëzit me të cilët takohen çdo ditë, gjithashtu edhe ata që nuk i shohin shpesh. Në fakt, kërkoju të zgjedhin shtatë njerëz që mund të inkurajojnë gjatë javës së ardhshme (një person çdo ditë). Inkurajimi është një pjesë thelbësore e jetës dhe sidomos jetës në grup. Nëse di si të inkurajosh dikë, kjo gjë do të të ndihmojë të ndërtosh një marrëdhënie më të thellë me të. Kjo mund të jetë diçka e re për disa nga studentët e tu kështu që mund të të duhet t'i drejtosh dhe t'i ndihmosh. Inkurajoji dhe tregoju atyre si të nisin disiplinën dhe zakonin e të inkurajuarit të tjerët.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme, në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot, para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët e tu kanë përdorur hapësirën te libri i studentit për të krijuar një prezantim të shkronjës së parë të mbiemrit të tyre. (Ndihmesë: Mund të duhet t'ua kujtosh këtë, kështu që mund të dërgosh një mesazh, email apo t'i telefonosh përpara, në mënyrë që të vijnë të përgatitur.) Ata kishin mundësinë të vizatonin, pikturonin ose të bënin kolazh me objekte që gjenin.

Kërkoju disa prej studentëve të ndajnë krijimet e tyre me grupin. Sigurohu ta bësh edhe ti këtë gjë. Kjo do të japë mundësinë për të ndarë më shumë rreth jetës tënde dhe do të ndihmojë të ndërtosh një marrëdhënie më të thellë me ta. Pasi të kesh ndarë me ta, filloje mësimin duke vënë në dukje pikat e mëposhtme:

A nuk është e mrekullueshme sa krijues mund të jemi?

Të gjithë ne bëmë diçka me këto objekte që ekzistonin, por Perëndia bëri gjithçka njohim nga asgjëja!

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

(Siç është shkruar: "Unë të kam caktuar atin e shumë kombeve"), është ati i të gjithë neve para Perëndisë që ai besoi, i cili i jep jetë të vdekurve dhe thërret gjërat që nuk janë sikur të ishin.

Romakëve 4:17

PËRMBLEDHJE E MËSIMIT: ZANAFILLA 1:1-31

PERËNDIA EKZISTONTE PARA SE TË FILLONTE KOHA

Në fillim Perëndia… Zanafilla 1:1

PERËNDIA KRIJOI GJITHÇKA NGA ASGJËJA

Zanafilla 1:1-31

PERËNDIA NA KRIJOI

Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe".

Zanafilla 1:26

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Edhe çfarë? Perëndia bëri gjithçka nga asgjëja... gjë e jashtëzakonshme? Në fakt...po, është e jashtëzakonshme! Ti dhe unë nuk mund ta bëjmë këtë gjë, sado të përpiqemi. Gjithçka ne krijojmë del nga materie apo gjëra tashmë ekzistuese. Ne e kemi parë se sa i fuqishëm është Perëndia dhe se Ai krijoi gjithçka nga asgjëja. Ja disa hapa të rëndësishëm për studentët e tu dhe disa mënyra si ata mund të aplikojnë këtë javë të vërtetën se Perëndia është Krijuesi i tyre.

1. **Meqenëse Perëndia ekzistonte para fillimit të kohës,** unë nuk jam aksidentalisht këtu dhe as universi në të cilin jetoj nuk është. Perëndia ka qenë gjithnjë i pranishëm. Si mund të ndryshojë mendimet e mia dhe si mund të më informojë fakti që Perëndia ka qenë gjithnjë i pranishëm? Nëse Perëndia ka qenë gjithnjë i pranishëm, a kam qenë vërtet vetëm ndonjëherë?

2. **Perëndia krijoi gjithçka.** Ne nuk krijojmë mbeturina. Përse do të duhet ta bënim? Gjithçka dhe çdokush është i veçantë për Perëndinë. Ai i bëri të gjitha! Si e reflektojnë veprimet e mia, respektin që unë kam për krijimin e Perëndisë? A e shoh dhe e trajtoj krijimin e Tij në të njëjtën mënyrë si Ai?

FJALË KYÇ: *Creatio ex nihilo*: Krijimi nga asgjëja.

MENDIM KYÇ: Në krijim, Perëndia bëri gjithçka nga asgjëja.

3. **Perëndia krijoi gjithçka nga asgjëja.** Askush nuk mund ta bëjë këtë. Askush nuk mund të jetë Perëndi, përveç Tij. Në çfarë mënyrë, si mund të ndaloj së përpjekuri për të bërë punën e Perëndisë këtë javë? Ndihmesë: Në cilat aspekte të jetës tënde dëshiron të kesh gjithnjë kontroll?

4. **Perëndia na krijoi.** Ai të krijoi ty dhe të gjithë të tjerët në këtë klasë. Shih pak shumëllojshmërinë e krijuar në shkronjat e mbiemrit tuaj. Perëndia e krijoi secilin prej jush ndryshe dhe ky ndryshim është diçka që duhet festuar dhe duhet përdorur. A ka diçka që mund të bëjmë në kishën apo komunitetin tonë së bashku, që po të ishim vetëm nuk do ta bënim dot?

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.2 mësuam se Perëndia bëri gjithçka në krijim nga asgjëja.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 1:1-10

Vepra e parë e krijimit të Perëndisë në Shkrim ishte krijimi i kësaj gjëje të re të quajtur dritë. Nga kjo, mësojmë se drita është jashtëzakonisht shumë e rëndësishme dhe se nuk do të kishte dritë pa Perëndinë (Zbulesa 22:5). Vepra tjetër krijuese e Perëndisë ishte krijimi i botës, ku vendosi ujërat (Jobi 38:8-11).

SHTJELLOJMË:

A e imagjinon dot të jetosh në një botë pa dritë dhe ujë? A janë ato thelbësore për mbijetesën tonë? Çfarë do të të mungonte më shumë, nëse s'do të kishte më dritë ose ujë?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 1:11-19

Perëndia bëri të gjitha bimët që të riprodhoheshin sipas llojit të tyre. Ai e krijoi jetën që të mund të riprodhohej në llojin e vet, që të shumohej.

SHTJELLOJMË:

Çfarë fryte merr, kur mbjell një pemë molle? Çfarë do të ndodhte nëse do të gjeje portokaj që rriten në një pemë molle? Sa e vështirë do të ishte të jetoje në një botë ku nuk e dimë çfarë fryti do të prodhojë një bimë?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 1:20-25

Në ditën e pestë, Perëndia bëri krijesa të mrekullueshme që ishin të llojeve të ndryshme, peshqit dhe zogjtë në varietete të panumërta, shumë të bukura dhe me ngjyra të ndryshme. Krijimtaria e Tij është vërtet e pafundme.

SHTJELLOJMË:

A ndihesh ndonjëherë keq sepse nuk je njësoj si njerëzit e tjerë? Cilat janë disa mënyra në të cilat ndryshimet e tua unike të bëjnë më të vlefshëm për Perëndinë që të ka krijuar?

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 1:26-31

Pasi krijoi njerëzit sipas shëmbëlltyrës së Tij, Perëndia e quajti krijimin e Tij të 'mirë'. Patjetër, nuk mbeti ashtu. Mëkati ndryshoi gjithçka (Romakëve 8:20-22), por krijimi ishte i përsosur, po ashtu edhe ti. Asgjë që Perëndia ka bërë, përfshirë edhe ty, nuk është gabim. Megjithatë, të gjithë ne kemi zgjedhur shkatërrimin e mëkatit (Romakëve 3:23, 6:23). Ky është problemi nga i cili të gjithë kemi nevojë të shpëtohemi përmes besimit në Jezusin (Efesianëve 2:8-9).

SHTJELLOJMË:

A ke menduar ndonjëherë se Perëndia bëri një gabim kur të krijoi ty? Sipas Zanafillës 1:31, pse është ky një mendim i gabuar?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Zvogëlo fushat e përgjigjeve

Në pyetjet e diskutimeve të javës, studentët mund të duan të kalojnë më shumë kohë në një temë specifike. Para se të filloni diskutimin, mund të jetë ide e mirë të pyesësh secilin student se cila pyetje i ka mbetur më shumë në mendje. Shiko nëse ka ndonjë pyetje që përsëritet më shpesh në grup. Nëse ka, atëherë mund të kalosh më shumë kohë me ato pyetje dhe jo të përpiqesh t'i përsërisësh të gjitha. Kujto që këtë nuk e bën thjesht për të përsëritur të gjitha pyetjet, por për të diskutuar ato që i kanë prekur më shumë studentët e tu. Po të dish ku të fillosh, do të ndihmojë të kesh diskutime më të thella dhe do të ndihmojë të shohësh përparimin e grupit.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 1.3

IMAGO DEI: UNË JAM I/E VEÇANTË

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 1: 26, 27

VARGU KYÇ:

Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën. Zanafilla 1:27

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBAJTJA E MËSIMIT:

ÇFARË E BËN NJË KRIJIM APO SHPIKJE VËRTET TË MREKULLUESHME? Ndoshta ke parë diçka që të ka tërhequr vëmendjen në një dyqan, në televizor ose në një katalog dhe ke thënë: Sa e mrekullueshme! Ashtu si hera e parë që ke parë një kompjuter shumë të hollë ose telefonin e fundit. Ose ndoshta ke qenë në kinema për të parë një film dhe je mahnitur nga efektet speciale. Ose nëse je pak më i vjetër, a të kujtohet hera e parë që nuk të është dashur ta ndryshosh kanalin te televizori? Telekomandë... gjeniale! Të gjithë ne kemi prekur, parë dhe zotërojmë disa shpikje shumë të veçanta. Ato dallojnë nga të tjerat, janë të çmuara dhe kushtojnë shumë. P.sh., videoregjistruesi i parë që ke pasur duhet të të ketë kushtuar mijëra...Në këtë mësim po zhvendosemi nga të folurit për Perëndinë si Krijuesi i pakrijuar që ka bërë gjithçka nga asgjëja, për t'u fokusuar te aspekti më i veçantë i krijimit të Tij, ne. Ne jemi tërësisht ndryshe nga çdo gjë tjetër që Perëndia ka krijuar. Njerëzimi nuk është një lloj kafshe. Ne jemi të veçantë dhe të ndarë nga pjesa tjetër e krijimit. Kafshët mund të imitojnë tinguj dhe mund të kenë tingujt e tyre, por nuk do të shohësh kurrë një grup kafshësh që mblidhet si një orkestër apo të bashkojnë të gjithë tingujt së bashku që të interpretojnë një orkestër. Kafshët mund të pikturojnë gjëra të pakuptimta, por asnjë kafshë nuk ka aftësinë të imitojë veprat e mëdha të Michelangelos apo të përsërisë shpikjet dhe vizatimet e da Vincit. Kur Perëndia krijoi njerëzimin, e bëri në shëmbëlltyrën e Tij, në ngjashmëri me Të. Ai na bëri shumë të veçantë dhe na ndau nga gjithçka tjetër në krijim.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia është Krijuesi.
- Studentët do të dinë se Perëndia krijoi një pafundësi gjërash.
- Studentët do të dinë se Perëndia e bëri njerëzimin sipas shëmbëlltyrës së Tij.

FJALË KYÇ: *Imago Dei: shëmbëlltyrë e Perëndisë*

MENDIM KYÇ: Ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore don të arrish sot?

•

•

•

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Kërce, majmun, kërce! (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 29, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Topi i majmunit (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 61, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — A më ke vënë re?–Ka disa njerëz në kishën tënde që askush nuk i sheh. I dëgjojmë emrat e tyre në një letër me pika lutjesh, por a i njohim vërtet kush janë? Ata janë njerëz. Ndonjëherë u referohemi si të mbyllurit në vete. Ata janë njerëz në kishën tonë që, për një arsye apo për një tjetër, nuk mund të vijnë në kishë apo të jenë pjesë e rregullt e takimeve të kishës. Ata përballen me sëmundje, paaftësi, ndonjëherë kanë nevojë edhe për dikë që t'i marrë me makinë. Mblidhi studentët dhe planifiko një vizitë te disa nga këta njerëz të kishës tënde. Kërkoju që të shërbejnë duke bërë punë shtëpie, punë në kopsht ose thjesht të shkojnë për vizitë bashkë me ty. Perëndia na bëri të gjithëve sipas shëmbëlltyrës së Tij. Është e rëndësishme të kujtohemi t'u shërbejmë atyre që nuk na bien gjithnjë në sy. Jepu studentëve të tu një mundësi për të inkurajuar disa nga njerëzit që nuk i shohin shpesh në kishë.

PLANIFIKOJE-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot, para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët e tu kanë bërë dy lista me nga pesë preferenca. Njëra ishte lista me pesë krijimet më të mira të njeriut dhe tjetra pesë krijimet e preferuara nga Zanafilla 1, pastaj duhet t'i sillnin listat te grupi. Çfarë e bën vërtet të mrekullueshme një shpikje? Kërkoju disa prej studentëve të ndajnë disa nga sendet e listës së parë (krijimet më të mira njerëzore). Shih cilat zgjodhën dhe pastaj shih nëse edhe dikush tjetër ka zgjedhur të njëjtat gjëra. Pastaj merr listën që lidhet me Zanafillën 1 dhe bëj të njëjtën gjë. Kërkoju studentëve të ndajnë preferencat e tyre, më pas ndaj edhe ti të tuat.

Perëndia krijoi gjithçka. Ai krijoi zogjtë, ajrin, atmosferën, ujërat, tokën etj... gjithçka. Të gjithë ne kemi një listë me pesë preferenca kur bëhet fjalë për shumë gjëra në jetën tonë, por kur flasim për krijimin, cila pjesë e tij është në krye të listës? Ne nuk jemi thjesht një pjesë e mbretërisë së kafshëve, ne jemi të ndarë nga gjithçka tjetër dhe dallojmë nga gjithçka tjetër.

PLANIFIKOJE — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.

Zanafilla 1:27

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 1: 26, 27, PSALMI 139: 13-18

PERËNDIA BËRI NJË PAFUNDËSI KRIJIMESH

Zanafilla 1:1-31

PERËNDIA NA BËRI NË SHËMBËLLIM TË TIJ

Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne ..."

Zanafilla 1:26

PERËNDIA NA BËRI NE NJERËZIMIN TË DALLUESHËM NGA PJESA TJETËR E KRIJIMIT

" ...të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe." Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.

Zanafilla 1:26-27

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Edhe çfarë? Ne të gjithë jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë... a thua se është diçka e jashtëzakonshme. Patjetër që është diçka e jashtëzakonshme! Jetojmë në një kohë ku bullizmi është diçka që shumë, madje dhe disa prej atyre në këtë klasë, e përjetojnë çdo ditë. A e ke pyetur ndonjëherë veten çfarë mendon Perëndia për bullizmin? A do ta aprovonte Ai? JO! Ai nuk do të aprovonte që dikush të tallej, të lëndonte apo të abuzonte fizikisht apo verbalisht me krijimin e Tij. Kur ti sheh bullizëm në shkollën tënde, çfarë bën? Ata që bullizohen mund të mos jenë miqtë e tu më të mirë, megjithatë kanë rëndësi për Perëndinë. Ai i krijoi. Ai i krijoi edhe ata sipas shëmbëlltyrës së Tij. Çfarë bën ti kur sheh bullizëm? Çfarë bën ti kur je në ambientin që ndodh apo je online duke parë çfarë postojnë të tjerët? Si vepron përballë këtyre gjërave? A i mbron të tjerët? A e ndan urtësinë që ke marrë nga Fjala e Perëndisë? Si i mbron ti krijesat e Perëndisë? Të gjithë ne jemi të veçantë dhe të çmuar në sytë e Perëndisë. Të gjithë ne jemi të ndarë veçmas si krijesa të bëra sipas shëmbëlltyrës së Tij.

- Si mund të mbrosh krijesat e Perëndisë (ne) këtë javë?
- Si mund t'u tregosh të tjerëve se janë bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë?
- Kush ka nevojë ta dijë se Perëndia e do? Me kë mund ta ndash këtë të vërtetë këtë javë, dikush që ka vërtet nevojë ta dëgjojë?

FJALË KYÇ: *Imago Dei*: shëmbëlltyrë e Perëndisë

MENDIM KYÇ: Ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.3 mësuam se jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 1:26-27

Imago Dei janë fjalë latine që mund t'i kesh dëgjuar më parë. Rrjedhin nga tzelem elohim, një shprehje hebraike që do të thotë "shëmbëlltyrë e Perëndisë". Fakti se jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë i jep jetës njerëzore vlerën e saj kryesore, jo sepse ne jemi të mirë, është mirë sepse Perëndia na bëri sipas shëmbëlltyrës së Vet.

SHTJELLOJMË:

Si ndihesh që je krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë? A të bën të ndihesh se ke më shumë vlerë dhe rëndësi për Perëndinë? Nëse të gjithë ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, a është e drejtë që ne të mallkojmë apo të zhvlerësojmë një qenie tjetër njerëzore? (E dhënë: Shih Jakobi 3:7-10.)

DITA 4

LEXO: PSALMI 139:13-16

Mbreti dhe poeti David, i Izraelit, i shkroi Perëndisë rreth faktit që ishte krijuar nga Ai. Perëndia jo thjesht na bëri të gjithëve sipas shëmbëlltyrës së Tij; Ai bëri secilin nga ne, konkretisht, sipas shëmbëlltyrës së Tij. Vetë Perëndia të modeloi dhe planifikoi jetën tënde, para se ti të lindje (Efesianëve 1:3-6).

SHTJELLOJMË:

Jeta njerëzore ka vlerë për shkak të aftësive që ne kemi apo sepse jemi formuar nga Perëndia? A mendon se plani që Ai ka për ty është i besueshëm? Përse po ose jo?

DITA 5

LEXO: PSALMI 139:17, 18

Është normale që ndonjëherë të ndihemi vetëm, sikur asgjë që bëjmë, themi apo mendojmë nuk ka asnjëherë rëndësi (Psalmi 42:9-11). Davidi e dinte të vërtetën, Perëndia mendon për ne në çdo kohë, për të mirë. Perëndia mendon për ne sepse Ai na bëri, Ai ka plane për ne, dhe Ai na do shumë.

SHTJELLOJMË:

A beson se Perëndia ka dashuri për ty apo mendon se ndonjëherë Ai nuk të pëlqen? Sipas teje, çfarë mendon Perëndia për ty?

DITA 6

LEXO: PSALMI 139:23-24

Davidi kuptoi se, nëse Perëndia dinte gjithçka rreth tij, atëherë Ai njihte edhe sekretet e tij më të errëta (Psalmi 19:12-14). Në vend që të përpiqej t'i fshihte ato nga Perëndia, ai i kërkoi Perëndisë të vinte dhe ta shihte zemrën e tij ashtu siç ishte dhe më pas ta udhëhiqte në drejtimin e duhur.

SHTJELLOJMË:

A ka kuptim t'i fshehim mëkatet tona nga Perëndia? Çfarë mund të të pengojë që t'ia rrëfesh mëkatet e tua Perëndisë dhe t'i kërkosh që të të largojë prej tyre? A je gati të jesh i hapur me Perëndinë për të gjitha dështimet dhe shqetësimet e tua?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Ata thjesht nuk flasin

Ndoshta ke një nga ato grupe që nuk përfshihen në bisedë. Ndoshta e ke të vështirë të marrësh përgjigje prej tyre. Ndonjëherë nuk duhet të ndryshojnë studentët, mund të jemi ne që duhet të ndryshojmë mënyrën si veprojmë si drejtues. Ata kalojnë një pjesë të mirë të çdo dite duke u pyetur nga dikush... Përpiqu të ndryshosh pozicionin tënd ose organizimin e ambientit. Mos e bëj një klasë mësimore, por një dhomë ndenjje. Përdor një strukturë rrethore, si një tavolinë e rrumbullakët ose thjesht uluni në rreth. Në këtë mënyrë të gjithë mund të shohin njëri-tjetrin dhe askush nuk i rri mbi kokë, gjë që mund t'i frikësojë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... Çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 1.4
KUFIJTË:

unë jam i/e limituar

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
ZANAFILLA 2: 8-17

VARGJET KYÇ:

Ku ishe kur unë hidhja themelet e tokës? Thuaje, në rast se ke aq zgjuarsi. Kur i caktova një kufi dhe i vendosa shufra hekuri dhe porta, dhe thashë: "Ti do të arrish deri këtu, por jo më tutje; këtu do të ndalen valët e tua krenare!"

Jobi 38:4, 10-11

PËRMBLEDHJE E MËSIMIT:

BOTA JONË ËSHTË E MBUSHUR ME KUFIJ.

Që nga vegjëlia e deri kur vendosemi në varr, ne bashkëveprojmë me kufijtë. Edhe jeta, edhe vdekja janë kufij. Kufijtë ekzistojnë për të na drejtuar dhe mbrojtur. Ato limitojnë vendet ku mund të shkojmë. Ato na informojnë se kush jemi ne si krijesa. Kufijtë me të cilët hasemi më shpesh janë ata fizikë. Nëse do të shkosh thellë në oqean ose do të shkosh larg në hapësirë, oksigjeni është kufi. Graviteti është kufi. Nëse hidhesh nga kanioni Grand, do të përplasesh në tokë. Distanca është një tjetër kufi. Nuk mund të largohesh nga sistemi solar, do të vdisje pa arritur yllin më të afërt. Ka akoma më shumë kufij. Nget makinën... ke vija të shënuara në rrugë. Në një spital, ka një vijë të kuqe që vetëm kirurgët dhe stafi mund ta kalojnë, familja dhe miqtë duhet të presin jashtë. Ti jeton në një lagje dhe përreth ka gardhe. Nëse luan një lojë me miqtë, duhet të ndjekësh rregullat. Në shtëpinë ku jeton, dhomat janë kufijtë. Lista vazhdon. Jetojmë në një botë të përbërë nga kufijtë. Në fillim, Perëndia e krijoi Adamin dhe Evën, dhe i vendosi në kopsht. Ai vendosi kufij për ta, nuk u dha mbretërim të lire. Ai u tha të mos hanin nga një pemë specifike. Ata mund të hanin nga çdo pemë tjetër e kopshtit të Edenit, përveç kësaj peme. Ajo ishte pema e njohjes të së mirës dhe së keqes, nga e cila nuk mund të hanin. Perëndia i dha Adamit dhe Evës një kufi atë ditë. Perëndia na jep kufij me të cilët duhet të jetojmë, për drejtimin dhe mbrojtjen tonë.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se që prej fillimit Perëndia i vuri njerëzimit kufij.
- Studentët do të dinë se Perëndia i vendosi Adamit kufij. sepse Ai kujdesej për të.
- Studentët do të dinë se Perëndia na vendos kufij për mbrojtjen dhe drejtimin tonë.

FJALË KYÇ: Kufi: diçka që tregon kufizim apo limit

MENDIM KYÇ: Perëndia i vuri kufij Adamit dhe Evës. Ai na ka vënë kufij ty edhe mua gjithashtu.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•
•
•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu. Ti e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Kap diskun fluturues (shih librin e lojrave AwanaYM Game Book, faqja 22, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Pinball me njerëz (shih librin e lojrave AwanaYM Game Book, faqja 51, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Hir për të kufizuarin – në zonën tënde me shumë mundësi ka një burg. Ndoshta jo ngjitur me rrugën tënde, por ka një vend që mban njerëz që nuk kanë jetuar sipas rregullave. Kufijtë e tyre janë limituar vërtet shumë. Janë gjykuar, dënuar dhe tani po kryejnë dënimin e shkeljes së ligjit. Ata shkelën një kufi, megjithatë, ata janë njerëz. Mund të kenë bërë krime të tmerrshme dhe të këqija, të paimagjinueshme. Sidoqoftë janë njerëz dhe jetët e tyre janë të çmuara për Perëndinë. Ndihmoje grupin të kontaktojë me një shërbesë burgjesh vendase dhe shih se si mund të ndihmojnë ata në plotësimin e nevojave të këtyre njerëzve që kanë kufij shumë të limituar. Nëse nuk ka një shërbesë burgjesh në zonën tënde, mblidh libra dhe materiale të aprovuara (mund të bësh një listë duke vizituar faqen e burgut ose duke kontaktuar drejtpërdrejt me burgun) që mund të dhurohen në një burg vendas. Vetëm pse janë pas hekurave dhe janë etiketuar për shkak të asaj që kanë bërë, nuk do të thotë se duhen harruar.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot, para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj javë keni pasur një eksperiment për të bërë. Duhet të ecnit nga një anë e dhomës në tjetrën. Nuk e dinit, por kishte disa rregulla për këtë ecje përgjatë dhomës. Mënyra si ecët, nga një anë në tjetrën, pati rezultate të ndryshme për të gjithë.

Ja dhe pyetja: A do të kishe ecur ndryshe nëse do t'i kishe ditur rregullat më parë? A do të kishe bërë zgjedhje të tjera për mënyrën e jetesës? A ishte e padrejtë që iu lejua të ecnit si të donit, pa ju treguar më parë rregullat e lojës?

Në fillim Perëndia na tregoi rregullat. Ai kujdeset për ne. Ai kujdeset për ty. Ai do që të jetojmë në mënyrën më të mirë në botën që Ai ka krijuar.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGJET KYÇ:

Ku ishe kur unë hidhja themelet e tokës? Thuaje, në rast se ke aq zgjuarsi. Kur i caktova një kufi dhe i vendosa shufra hekuri dhe porta, dhe thashë: "Ti do të arrish deri këtu, por jo më tutje; këtu do të ndalen valët e tua krenare!"

Jobi 38:4, 10-11

PËRMLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 2: 7-17

PERËNDIA I PËRDOR KUFIJTË PËR TË NA MËSUAR.

Dhe Zoti Perëndi e urdhëroi njeriun duke i thënë: "Ha bile lirisht nga çdo pemë e kopshtit".

Zanafilla 2:16

PERËNDIA I PËRDOR KUFIJTË PËR TË NA MBROJUR.

Por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri.

Zanafilla 2:17

PERËNDIA I PËRDOR KUFIJTË PËR TË NA DREJTUAR.

Do të respektoni, pra, të gjitha statutet dhe dekretet e mia dhe do t'i vini në zbatim, me qëllim që vendi ku po ju çoj të banoni të mos ju vjellë jashtë.

Levetiku 20:22

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Të gjithë jetojmë në një botë të shënuar nga kufijtë. Prindërit vendosin orare kthimi në shtëpi, mësuesit kanë rregulla në klasë, trajnerët kanë standarde për lojtarët në fushë dhe jashtë saj. Nuk do të kalojmë kurrë përtej rregullave në këtë botë.

Kur mendojmë kufijtë, shumicës nga ne i vijnë në mendje rregullat. Herë pas here hasim vështirësi me rregullat. Na duken të padrejta dhe shpesh bëhemi gati t'i thyejmë. Thyerja dhe mosrespektimi i këtyre kufijve mund të ketë ndikim të madh në jetën tonë. Cilat rregulla i ndjek me kënaqësi dhe cilat ke vështirësi t'i respektosh e t'u bindesh? Përse të duken të vështira? A është ky rregull për të mirën dhe sigurinë tënde? Ndoshta dëshiron që këto rregulla të largohen nga jeta jote, por ndoshta nuk e ke kuptuar rrezikun nëse mungon ai rregull. Le të provojmë këtë gjë ...

- Cili është ai rregull që duhet të ndjekësh tani, por do të doje të mos e ndiqje?
- Përse mendon se ekziston ai rregull?
- A po të mbron ky rregull nga diçka që ndoshta as nuk e ke menduar?

FJALË KYÇ: Kufi: diçka që tregon kufizim apo limit

MENDIM KYÇ: Perëndia i vuri kufij Adamit dhe Evës. Ai na ka vënë kufij ty edhe mua gjithashtu.

Perëndia vendos kufij në jetën tonë për një arsye. Ai do të na mësojë diçka për veten e Tij. Ai do që ne të jemi të mbrojtur dhe ta jetojmë jetën sipas planit që Ai ka projektuar. Perëndia gjithashtu do që ne të drejtohemi prej atyre kufijve që të mund ta jetojmë jetën plotësisht.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.4 mësuam se Perëndia i vuri Adamit dhe Evës kufij. Ai na ka vendosur edhe neve kufij.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 2:7-9

Gjithçka rreth nesh, forma jonë, pamja jonë, madje edhe fryma, na është dhënë nga Perëndia. Si Dhënësi i jetës, askush nuk është më i kualifikuar se Ai për të vendosur kufijtë brenda të cilëve duhet të jetojmë.

SHTJELLOJMË:

A është e logjikshme për ty që, si Dhënësi i jetës, Perëndia të ketë të drejtën për të na treguar cila është mënyra më e mirë për ta jetuar jetën? Cili është një kufi që Perëndia ka vendosur për ty që shërben për të mirën tënde?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 2:10-14

Këto vargje duken si mësim gjeografie. Përse janë pjesë e Zanafillës? Pjesërisht ato na ndihmojnë të kuptojmë se kopshti i Edenit ishte vend i vërtetë. Nuk është një metaforë, analogji apo përrallë. Adami ishte një njeri i vërtetë që jetonte në një vend të vërtetë të tokës sonë.

SHTJELLOJMË:

Cili është vendi yt i preferuar në botë? Si do të ishte Edeni në krahasim me këtë vend? A do të ishte më i mirë apo më i keq?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 2:15

Shpeshherë, e mendojmë kopshtin e Edenit si një resort ku Adami rrinte shtrirë dhe pushonte, një parajsë ku nuk ishte e nevojshme të punoje. , Perëndia i dha Adamit një vend dhe një qëllim. Të njëjtën dhuratë na e ka dhënë edhe ne.

SHTJELLOJMË:

A mendon ndonjëherë se do të ishe më i lumtur nëse do të ishe diku tjetër? A e ke menduar ndonjëherë se Perëndia të ka sjellë në këtë vend dhe në këtë kohë për një arsye? A mund të mendosh për disa nga arsyet që Perëndia të ka vendosur aty ku je?

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 2:16-17

Vër re diçka në urdhërimin që Perëndia i dha Adamit. Nuk ishte thjesht një jo. I tha të bënte një gjë dhe të mos bënte një tjetër.

Perëndia do që ti të karakterizohesh jo vetëm nga ajo që refuzon të bësh, por edhe nga ajo në të cilën përkushtohesh të bësh në jetën tënde. Kufijtë, rregullat, urdhërimet dhe mençuria e Tij na ndihmojnë të kuptojmë si duhet të jetojmë, jo thjesht si të MOS jetojmë.

SHTJELLOJMË:

Cili është një kufi që Perëndia ka vendosur, por që ty të zemëron? Cili është aspekti pozitiv i atij kufiri ku ti mund të përqendrohesh?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Topi folës

Ndoshta grupi yt nuk ka probleme me diskutimet në grup. Sa mirë për ty! Megjithatë, kur punon me këtë moshë, mund të jetë sfiduese t'u japësh të gjithëve një mundësi për të folur, sidomos kur ke disa personalitete vërtet dominuese në grup. Gjej diçka që mund ta pasosh. Një top, një bidon bosh, një jastëk etj. Kushdo që e ka objektin në dorë mund të flasë, ndërsa të gjithë të tjerët duhet të dëgjojnë. Kjo është një teknikë e thjeshtë, por mund të jetë e duhura për të vënë pak rregull gjatë diskutimit. Është e rëndësishme që të gjithë të kenë mundësinë të flasin. Shpesh dëgjojmë vetëm fëmijët e zhurmshëm të grupit, por mendimtarët më të thellë janë zakonisht ata që flasin më pak shumicën e kohës. Jepi mundësinë të gjithëve të flasin dhe të dëgjohen.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 1.5

Mashkulli DHE femra

UNË NUK JAM VETËM

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 2:7, 21-25

VARGU KYÇ:

Por në fillim të krijimit, Perëndia i bëri mashkull e femër.

Marku 10:6

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

TË GJITHË NE JEMI NDRYSHE. Nuk ka dyshim për këtë. Nga forma e qelizave tona deri në ngjyrën specifike të syve tanë, të gjithë jemi krijuar për të qenë unikë. Adami bën një zbulim të rëndësishëm dhe vëren diçka që prek çdo ditë secilin prej nesh. Ai është vetëm. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, Adami ndjeu se ç'do të thoshte të ndieje nevojën e miqësisë. Ai pa përreth dhe nuk kishte asnjë si ai. Adami kishte nevojë për dikë që ta kuptonte. Ai kishte nevojë për dikë, gjurmët e të cilit të ishin njësoj me të tijat. Perëndia e dinte se nuk ishte mirë që njeriu të ishte vetëm. Që nga fillimi, Perëndia qartësoi se vetmia nuk duhet të jetë praktikë e zakonshme e jetës sonë. Ne kemi nevojë për të tjerët në jetën tonë. Ne kemi nevojë për njerëz me aftësi, talente dhe dhunti ndryshe nga tonat. Perëndia bëri që Adami të binte në një gjumë të thellë dhe hoqi një brinjë nga ai për të krijuar Evën. Eva nuk do të ecte pas Adamit, as nuk do të vraponte shumë para tij. Eva ishte bërë për t'u bashkuar me Adamin. Ata ishin shumë ndryshe nga njëri-tjetri, por kombinimi i pikave të dobëta dhe të forta që kishin ndryshe nga njëri-tjetri, i bënte unik. Njohja e mënyrës dhe qëllimit të krijimit tonë ka një rol të rëndësishëm në të kuptuarit e identitetit tonë. Perëndia ka plane për të përdorur aftësitë dhe talentet e veçanta që i ka dhënë secilit prej nesh për të përmbushur qëllimet e Tij.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia e dinte se nuk ishte mirë që Adami të ishte vetëm.
- Studentët do të dinë se Perëndia e bëri Evën nga Adami dhe se të dy ata janë të ndryshëm nga njëri-tjetri.
- Studentët do të dinë se Perëndia vendos njerëz në jetën tonë që janë të ndryshëm nga ne.

FJALË KYÇ: Unik: të mos kesh të ngjashëm apo të barabartë, i pakrahasueshëm

MENDIM KYÇ: Perëndia e bëri njeriun pjesën e veçantë dhe unike të krijimit të Tij.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Hedhja e emrave (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 64, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Gjëra (shih librin e lojrave AwanaYM Game Book, faqja 95, për të gjetur listen e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Kërko ndihmë. Një nga gjërat më të vështira në botë është të kërkosh ndihmë. Na pëlqen të jemi njerëz që i plotësojmë vetë nevojat tona. Megjithatë, një nga mënyrat më të mira për t'u miqësuar me dike është t'i kërkosh ndihmë. Shpesh i shohim shërbesat si përjetime të njëanshme, por studentët e tu mund të kenë një nevojë dhe dikush brenda grupit apo kishës mund të përjetojë gëzimin e të shërbyerit nëse do ta dinte këtë nevojë. Disa prej studentëve mund të kenë vështirësi me detyrat e shtëpisë apo në lëndë të caktuara. Sfidoji të gjejnë dikë dhe t'i kërkojnë ndihmë. Duke kërkuar ndihmë, ata po i japin mundësinë dikujt në komunitet të shërbejë. Ose ndoshta një student nuk përshtatet mirë apo është i ri në grupin e Trek. Sfido njërin prej studentëve që të ndihmojë studentin e ri me një projekt të vogël shërbese (p.sh., shkrimi i letrave inkurajuese, ndihmë me rregullin apo pastrim etj.). Duke kërkuar ndihmë, ky student po i jep mundësinë personit të ri që të shërbejë dhe gjithashtu po thotë: "Unë të shoh dhe do të doja të më ndihmoje."

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDEAS —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave duhet të mendonit për dikë në grupin tuaj dhe të bënit një listë me tri pika të forta që shikoni tek ai. (Shënim: Drejtues, kini parasysh që disa prej studentëve më të tërhequr mund të mos zgjidhen nga studentët. Nëse e ndani këtë gjatë kohës në grup duhet të mendoni ta bëni për të gjithë studentët ose për disa nga ata që janë më të tërhequr. Ata nuk flasin shumë, por ata pyesin: A më sheh dikush?)

Ja tek është pyetja: A do të ishte e njëjtë lista e pikave të forta për të gjithë personat në klasë?

Me shumë mundësi, jo.

Perëndia na ka bekuar me shumë dhunti të ndryshme. Ndonjëherë është më e lehtë të tregojmë dobësitë tona sesa të lemë pikat e forta të shkëlqejnë. Në mësimin tonë, Adami ka një problem. Ai është vetëm. Nuk ka asnjë si vetja. Perëndia thotë se nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm. Ne kemi nevojë për njëri-tjetrin.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Por në fillim të krijimit, Perëndia i bëri mashkull e femër.

Marku 10:6

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 2:7, 18-25

PERËNDIA THA SE NJERIU NUK DUHET TË JETË VETËM.

Pastaj Zoti Perëndi tha: "Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t'i bëj një ndihmë që i leverdis ..."

Zanafilla 2:18

PERËNDIA BËRI NJË NDIHMË QË I LEVERDISTE ADAMIT.

Dhe njeriu u vuri emra tërë bagëtisë, zogjve të qiellit dhe çdo kafshe të fushave; por për njeriun nuk u gjend asnjë ndihmë e përshtatshme për të. Atëherë Zoti Perëndi e futi në një gjumë të thellë njeriun, të cilin e zuri gjumi; dhe mori një nga brinjët e tij dhe e mbylli mishin në atë vend. Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr njeriut formoi një grua dhe e çoi te njeriu. Dhe njeriu tha: "Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri."

Zanafilla 2:21-23

NE JEMI KRIJUAR NË MËNYRË UNIKE PËR T'I SHËRBYER DHE PËR TË DASHUR NJËRI-TJETRIN.

Në rast se dikush mund të mposhtë atë që është vetëm, dy veta mund t'i rezistojnë; një litar tresh nuk këputet aq shpejt.

Predikuesi 4:12

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

A je vetëm? Jetojmë në një botë që lidhet përmes teknologjisë, telefonave, mesazheve, videove dhe postimeve. E megjithatë, a jemi vërtet të lidhur me njëri-tjetrin? Çfarë bën për t'u lidhur me dikë? A kalon kohë cilësore me dikë, në mënyrë që të mësosh prej tij dhe të ndash me të dhuntitë, talentet dhe aftësitë e tua?

Mendo për një person gjatë kësaj jave me të cilin mund të kalosh pak kohë për t'u njohur, ballë për ballë. Perëndia nuk do që të jemi vetëm. Nëse do të donte, do të kishte bërë mjaftueshëm planetë që secili prej nesh të kishte një, kështu s'do të kishim nevojë të flisnim me asnjë, por Ai në bëri që të jemi të lidhur. Disa prej jush janë shumë të mirë për t'u lidhur me të tjerët. Ju pëlqen! Të tjerë preferojnë të rrinë vetëm. Të gjithë kanë nevojë për kohë me veten dhe shpeshherë hapësirë, por nuk mund ta jetosh jetën në izolim. Ke nevojë për të tjerët. Mendo për një person specifik, mund të jetë dikush në këtë klasë, dhe kalo pak kohë me të. Dhe ndërsa mendon të bësh këtë gjë, bëji vetes këto pyetje:

1. A di vetëm fakte dhe informacione të përgjithshme për njerëzit në jetën time? (P.sh., adresën, emailin, ditëlindjen etj.)

   Apo

2. I njoh vërtet ata?

FJALË KYÇ: Unik: të mos kesh të njjashëm apo të barabartë, i pakrahasueshëm

MENDIM KYÇ: Perëndia e bëri njeriun pjesën e veçantë dhe unike të krijimit të Tij.

Gjej dikë që mund ta njohësh pak më mirë këtë javë. Kalo kohë me të, pyete si mund të lutesh për të. Pyete si i ka shkuar java dhe bisedo pa peshën e rëndë dhe muret e larta që na pengojnë të kuptojmë se çfarë ndodh në jetën e të tjerëve. Perëndia nuk donte që Adami të ishte vetëm dhe Ai nuk do që edhe ne të qëndrojmë vetëm.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.5 mësuam se Perëndia e bëri njeriun pjesën e veçantë dhe unike të krijimit të Tij.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 2:7

Perëndia e bëri Adamin për të qenë unik. Ai ishte unik sepse nuk ishte aspak njësoj me asnjë krijesë tjetër. Vetëm Adami ishte krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, por ai ishte gjithashtu unik si person. Ai nuk ishte si Eva, si ti, apo si asnjë tjetër.

SHTJELLOJMË:

Cilat janë tri gjëra që të bëjnë unik? Çfarë të bën të ndryshëm nga çdokush tjetër në familjen tënde? Si e bëjnë më të mirë familjen tënde të gjitha këto karakteristika?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 2:18-20

Si plan i Perëndisë, qeniet njerëzore duhet të kenë marrëdhënie me njëra-tjetrën. Disa nga ne preferojnë të kalojnë më shumë kohë vetëm se disa të tjerë, por të gjithë ne kemi nevojë për marrëdhënie. Perëndia të ka formuar që të punosh më mirë kur je në marrëdhënie me njerëz të tjerë.

SHTJELLOJMË:

A të pëlqen të qëndrosh me grupe të mëdha njerëzish apo preferon të kalosh kohë vetëm me disa njerëz? Cilat janë disa nga të mirat që sjell marrëdhënia me njerëz të tjerë?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 2:21-22

Deri tani, në historinë që kemi studiuar në Bibël, kemi parë se Perëndisë i pëlqen t'i japë dhurata të mira Adamit. Në këto vargje na thuhet se Perëndia i solli këtë grua, një ndihmë Adamit, që ishte pothuajse si një dhuratë. Adami kishte një nevojë dhe Perëndia e plotësoi nevojën e tij përmes një qenie tjetër njerëzore.

SHTJELLOJMË:

A e ke parë ndonjëherë veten si mënyra që Perëndia ka përdorur për të plotësuar nevojat e njerëzve në jetën tënde? Si të përdor Perëndia për të plotësuar nevojat e të tjerëve? Kë ka përdorur Perëndia në jetën tënde për të plotësuar nevojat e tua?

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 2:23-25

Adami dhe Eva nuk do të ishin thjesht shokë. Marrëdhënia martesore është ndryshe nga të gjitha të tjerat. Ne mund të jemi miq dhe të ndihmojmë apo të ndihmohemi nga shumë njerëz, por mund të martohemi vetëm me një person.

SHTJELLOJMË:

Si mund të na ndihmojë dhe të na bëjë më të fortë martesa me një person tjetër që është plotësisht ndryshe nga ne? Nëse martesa na bën më të fortë, përse për disa është shumë e vështirë dhe shkakton kaq shumë dhimbje? (e dhënë: Lexo Zanafilla 3 për të gjetur burimin e të gjitha problemeve në martesë.)

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Atyre u pëlqen të flasin

Ndoshta studentëve të tu u pëlqen të flasin dhe shumicën e kohës e kalon duke u munduar t'i qetësosh dhe u kërkon të flasin me radhë. Ja diçka që mund të të ndihmojë. Merr një kronometër ose përdor kronometrin e telefonit për t'i dhënë secilit student një sasi të caktuar kohore për të ndarë një histori para se të fillojnë diskutimet. Kjo do t'i ndihmojë të tregojnë atë që kanë në mendje që të jenë gati në kohën e diskutimit. Gjithashtu i ndihmon të mendojnë para se të flasin sepse kanë vetëm 1 minutë kohë. Pastaj, pasi të fillojë diskutimi, nuk do të ketë më shpërqendrime dhe diskutimet do të kenë të bëjnë me materialin e mësimit. Studentët kanë nevojë për strukturë, por edhe për liri, që të mund të shprehin mendimet e tyre në një mënyrë të sigurt që nuk anashkalon diskutimin e grupit.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 1.6

SUNDIM

KAM GJËRA PËR TË BËRË

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 1:26

VARGU KYÇ:

Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëll-tyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqa-norët që zvarriten mbi dhe."

Zanafilla 1:26

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

DITËN E PËRSOSUR SHPESH E MENDOJMË KËSHTU TË SHTRIRË NË NJË PLAZH PA ASGJË PËR TË BËRË. Nuk ka problem nëse bëhet fjalë për pushime familjare apo thyerje të rutinës së përditshme. Kur mendojmë për konceptin e punës, shpesh kemi një pamje ndryshe nga ajo që Perëndia ka. Besoje ose jo, puna ka ekzistuar para rënies së njerëzimit. Perëndia i dha Adamit përgjegjësinë për t'i dhënë emër të gjitha kafshëve. Perëndia i dha njerëzimit përgjegjësinë e sundimit mbi të gjithë tokën. Ai i vendosi në kopsht dhe u kërkoi ta ruanin dhe të kujdeseshin për të. Perëndia na krijoi për të punuar. Ndonjëherë kjo punë vjen në forma të ndryshme dhe Perëndia e di që ne kemi nevojë për pushim (p.sh., shabati). Perëndia nuk na krijoi për të qenë skllevër, Ai na krijoi me një qëllim. Ai na krijoi për të bërë gjëra. Perëndia na krijoi për të punuar dhe ne duhet të kuptojmë se që nga fillimi puna ka qenë diçka e mirë. Puna nuk u krijua si një formë ndëshkimi për njerëzimin. Bërja e punës ishte pjesë e planit të Perëndisë, para se mëkati të hynte në botë. Që nga fillimi, Ai na krijoi për të qenë aktiv dhe për të bërë diçka, për të përmbushur planin dhe qëllimin e Tij. Çfarë pune ka planifikuar Ai për ty? Çfarë pune ka planifikuar Ai për studentët e tu?

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia e krijoi njeriun për të punuar që para rënies.
- Studentët do të dinë se Perëndia i dha njeriut përgjegjësinë për të sunduar në tokë.
- Studentët do të dinë se Perëndia ka një thirrje dhe qëllim për secilin prej nesh.

FJALË KYÇ: Thirrje: qëllimi që Perëndia ka për jetën tënde

MENDIM KYÇ: Perëndia e ka bërë gjithsecilin prej nesh për një qëllim specifik.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Një lugë plot me drithëra të sheqerosura (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 76, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Fushat dhe rrethinat (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 39, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Ky është qyteti ynë! Të sundosh do të thotë të jesh përgjegjës për diçka. Perëndia na ka dhënë tokën dhe përgjegjësi bashkë me të. Ka ardhur koha ta pastrojmë qytetin. Mblidhi studentët dhe dilni në qytet për të mbledhur mbeturinat apo gjëra të ricikluesshme. Një tjetër mënyrë për të treguar kujdes ndaj komunitetit është të blini llamba dhe bateri (kërkojini kishës të dhurojë për këtë) pastaj shkoni në shtëpitë e lagjes apo qytetit duke dhënë bateri për detektorë tymi dhe llamba për familjet. Mund të shohësh nëse zjarrfikësja vendase do të donte të bëhej pjesë e këtij projekti shërbese. Ky është komuniteti juaj. Pastrojeni, furnizojeni, ndizeni!

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave të është dashur të mendosh për llojin e karrierës që do të doje të provoje kur të rriteshe. Pastaj i keni shkruar në letër. Pas kësaj, ju është dashur të bëni një listë me njerëzit që respektoni dhe admironi, njerëz që i njihni personalisht, gjithashtu keni shënuar cila është karriera e tyre.

Kalo një kohë ku studentët ndajnë listën e tyre me njëri-tjetrin si një grup i madh. Pastaj përdor fjalitë e më-poshtme për të kaluar te mësimi.

1. Ajo që ne jemi si njerëz–identiteti ynë, karakteri ynë–nuk përcaktohet nga puna që bëjmë.

2. Të gjithë njerëzit janë krijuar për të punuar

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

VARGU KYÇ:

Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe."

Zanafilla 1:26

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 1: 26-30

PERËNDIA NA KRIJOI PËR TË PUNUAR.

Zoti Perëndi e mori pra njeriun dhe e futi në kopshtin e Edenit, me qëllim që ta punonte dhe ta ruante.

Zanafilla 2:15

Dhe Zoti Perëndi formoi nga dheu tërë kafshët e fushës dhe tërë zogjtë e qiellit dhe i çoi te njeriu për të parë si do t'i quante; dhe sido që njeriu t'i quante qeniet e gjalla, ai do të ishte emri i tyre.

Genesis 2:19

PERËNDIA NA DHA SUNDIM MBI TOKËN.

" ... Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe."

Zanafilla 1:26

PERËNDIA KA NJË THIRRJE PËR SECILIN PREJ NESH.

Ne në fakt jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to.

Efesianëve 2:10

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Për çfarë je përgjegjës? Ndoshta nuk zotëron shumë gjëra dhe shumë prej nevojave të tua i plotësojnë të rriturit, por si mund ta praktikosh përgjegjësinë për atë që Perëndia ka vendosur në jetën tënde? Ja disa pjesë ku mund të veprosh me bindje kur bëhet fjalë për sundimin.

1. Dhoma jote. Pastroje! Kujdesu për gjërat e tua. Mos lër dritat apo televizorin ndezur. Kujdesu për atë që të është dhënë.

2. Detyrat. Ato janë notat e tua. Merr përgjegjësi për to. Mos u tall në klasë! Bëji detyrat! Dorëzoji projektet në kohë. Kërko ndihmë në lëndët që ke nevojë.

3. Koha e lirë. Çfarë bën me kohën që nuk ke asnjë detyrim? Është shumë e lehtë të kalosh katër apo pesë orë në një lojë kompjuterike. Megjithatë, a mund ta kalosh këtë kohë duke ndihmuar të tjerët, duke larë enët? Duke hedhur mbeturinat? A mund të ndihmosh me pastrimin e shtëpisë ose me palosjen e rrobave dhe vendosjen e tyre në vend?

FJALË KYÇ:

Thirrje: qëllimi që Perëndia ka për jetën tënde

Këto janë aspekte të thjeshta me të cilat ti kalon një pjesë të madhe të ditës. Bëhu kujdestar i mirë i asaj që Perëndia të ka besuar. Është qëllimi i Perëndisë që ne të punojmë. Të qenët besnik në gjërat e vogla me të cilat Ai të ka bekuar do të ndihmojë të kuptosh atë që Ai do për ty dhe për jetën tënde.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.6 mësuam se Perëndia e ka krijuar secilin prej nesh për një qëllim specifik.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 2:15

Perëndia mund ta kishte krijuar kopshtin e Edenit që të vetëmbahej apo jo? Ai nuk kishte përse ta krijonte si një vend që kishte nevojë për përkujdesje. Ai e krijoi të gjithë universin bazuar në qëllimin e Tij që të ishte i përshtatshëm për të punuar njerëzit. Ai krijoi punën për Adamin, para se të krijonte Adamin

WORK IT OUT:

Çfarë pune ka përgatitur Perëndia për ty këtë javë? Si të ndihmon kryerja e punëve të tua që të kuptosh veten më mirë?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 1:26

Vër re se si sundimi i njeriut, pjesa e krijimit mbi të cilin Perëndia i dha autoritet, ishte i limituar në tokë. Ne nuk jemi në sundim të planetëve apo yjeve. Edhe në jetën tënde, ti je përgjegjës për disa gjëra dhe jo për disa të tjera.

SHTJELLOJMË:

Nga e di ti se për çfarë të ka bërë përgjegjës Perëndia dhe për çfarë jo? Si e shmang marrjen e përgjegjësive për gjëra që nuk mund t'i kontrollosh?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 1:27-28

Perëndia i dha Adamit dhe Evës tri detyra kryesore: Mbushni tokën (me njerëz të tjerë), nënshtrojeni tokën dhe sundoni mbi të. Të nënshtrosh tokën do të thotë ta mbash nën kontroll. Të sundosh mbi të do të thotë të marrësh përgjegjësi për autoritetin e dhënë, ose e thënë ndryshe, të mos shmangësh përgjegjësinë e punës.

SHTJELLOJMË:

Pse janë kaq të aftë njerëzit që të bëjnë sikur asgjë nuk është përgjegjësia e tyre apo faji i tyre? Për çfarë mund të marrësh përgjegjësi këtë javë?

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 1:29-30

Në Besëlidhjen e Re, Pali i thotë kishës se ata që nuk do të punojnë për të ofruar nuk do të ushqehen nga komuniteti (2 e Thesalonikasve 3:10). Edhe para mëkatit, njerëzit duhet të punonin për t'u ushqyer. Adami dhe Eva duhet të kujdeseshin për kopshtin, në mënyrë që të merrnin ushqim prej tij.

SHTJELLOJMË:

A bën ndonjë punë që të ndihmon të hash ushqim, ndoshta duke fituar para, duke ndihmuar në përgatitjen e tij, ose duke ndihmuar me pastrimin? Nëse nuk bën shumë, si mund të fillosh të ndihmosh pak më shumë?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Qetësia

Nëse ke drejtuar ndonjëherë një grup diskutimi, e di që vjen një moment kur ti bën një pyetje dhe dhoma bie në qetësi. Askush nuk përgjigjet. Heshtja është e dhimbshme. Ti e pyet veten: "A po kuptojnë ata?" ose "A thashë ndonjë gjë gabim?" Ndonjëherë e pyet veten nëse u intereson tema. Megjithatë, ti je përgatitur dhe je gati për këtë bisedë. Ata mund të mos jenë. Vetëm pse është qetësi, pasi ti bën një pyetje, nuk do të thotë se duhet të flasësh vetëm ti. Jepi kohë trurit të studentëve që të përpunojnë atë që kanë dëgjuar. Nëse është një pyetje e thellë, jepi 60 deri në 90 sekonda për ta menduar përgjigjen. Heshtja mund të nënkuptojë se ata po mendojnë për pyetjen që u është bërë. Jepi trurit të tyre hapësirë për të arritur aty ku je ti.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 1.7

ÇDO GJË ishte MIRË

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 1:31

VARGU KYÇ:

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

Zanafilla 1:31

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

ÇFARË E BËN DIÇKA TË MIRË? Kush e përcakton si të tillë? Zakonisht diçka konsiderohet e mirë nëse përmbush minimumin e kërkesave për të kaluar. Nëse do të shohim sistemin e vlerësimit të notave, shumica prej nesh janë rritur me këto: 10–shkëlqyer; 9.8–mirë; 7.6 – mesatare; 5–kaluese; 4–ngelëse. Kur Perëndia e krijoi botën, ajo ishte pa mëkat. Gjithçka ishte e përsosur. Gjithçka ishte shumë mirë. I përmbushte standardet e Perëndisë për t'u pranuar si e mirë. Mirësia e vërtetë është një standard i përcaktuar nga Perëndia. Për t'u konsideruar i mirë një person, ai duhet të jetë i përsosur, i patëmetë dhe pa faj. Kështu ishte bota në përfundim të krijimit. E gjithë bota ishte krijuar, Perëndia e pa dhe pohoi se ishte shumë mirë. Asgjë nuk ishte 'mjaftueshëm mirë'.

Perëndia nuk krijoi asgjë me notë kaluese. Gjithçka dhe çdo pjesë të krijimit të Tij, Ai e quajti të përsosur. Megjithatë, çfarë e bën diçka të mirë? Diçka është e mirë nëse e ka krijuar Perëndia. Mendimi i Perëndisë në lidhje me çfarë është e mirë, është standardi përfundimtar. Nuk ekziston një proces apelimi. Shpesh jemi shumë të ashpër me veten. E shohim veten në pasqyrë, shohim krijimin e Perëndisë dhe themi: "E mirë... kjo të duket e mirë Ty?" Ose shohim nga dritarja apo shohim gjëra në televizor dhe mendojmë sërish: "Si mund të jenë këto të mira?" Në fillim gjithçka ishte e mirë... pastaj diçka ndodhi. Mëkati erdhi në botë, por do të flasim më tepër për këtë në kapitullin e ardhshëm.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se mirësia e vërtetë është një standard i përcaktuar nga Perëndia.
- Studentët do të dinë se Ai e quajti çdo gjë të mirë.
- Studentët do të dinë se njerëzimi u krijua me qëllimin për t'i dhënë lavdi Perëndisë.

FJALË KYÇ: Mirësia e vërtetë: një standard i përcaktuar nga Perëndia

MENDIM KYÇ: Perëndia bëri çdo gjë dhe çdo gjë që Ai bëri ishte e mirë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Fjalëkryq (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 32, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Numrat (shih librin e lojrave AwanaYM Game Book, faqja 66, për të gjetur listen e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Sa e shijshme! Një tjetër rast kur e përdorim termin 'mirë' është pasi kemi ngrënë një vakt të ngrohtë. Pasi ke ngrënë një vakt të gatuar në shtëpi, ndihesh mirë. Ka njerëz në komunitetin tënd që nuk e dinë se nga do t'u vijë vakti i radhës. Ata kanë nevojë për ty! Shih nëse mund të lidhesh me një kuzhinë vendase ku mund t'i çosh studentët e tu që të ndihmojnë me përgatitjen e disa vakteve për të pastrehët. Ose mund t'i përgatisni vetë dhe me mbikëqyrjen e nevojshme mund t'i shpërndani. Një tjetër ide mund të jetë që të përgatisni një vakt në kishën tuaj ku çdokush mund të vijë dhe të ulet të hajë. Meqë ra fjala, mos u tregoni të kursyer me vaktet. Jepni më të mirën që mund të jepni! Përpiquni të jetë një eksperiencë shumë e mirë për ata që u shërbeni.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave keni pasur një veprimtari për të kryer. Duhet të përpiqeshit të hidhnit topa letrash në një kosh. Pastaj, bazuar në disa distanca, do të shënonit pikët. Thirr disa studentë për të treguar si shkoi.

Mund të bëni edhe një garë mes studentëve kundër drejtuesve dhe shihni se kush fiton. Pastaj transferoje bisedën duke kaluar në ndryshimin midis konceptit të diçkaje që është 'mjaftueshëm e mirë' dhe standardit të Perëndisë për përsosmërinë, nga librat e tyre të studentit.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGU KYÇ:

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

Zanafilla 1:31

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 1:31

PERËNDIA PËRCAKTON ÇFARË VËRTET ËSHTË E MIRË.

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

Zanafilla 1:31

PERËNDIA E KONSIDEROI ÇDO GJË TË MIRË.

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

Zanafilla 1:31

PERËNDIA NA KONSIDEROI NE TË MIRË.

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

Zanafilla 1:31

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Bota jonë është e mbushur me imazhe errësire, lufte, dhune, ligësie etj. Nëse ndezim televizorin mund të shohim me orë të tëra programe që na shfaqin errësirën e botës tonë. Ndonjëherë, nëse nuk jemi të kujdesshëm, vetëm këto gjëra mund të shohim. Por, a e dallon të bukurën? Gjithçka që Perëndia krijoi ishte e drejtë, e mirë, e përsosur. Ndonjëherë edhe kur nuk e kërkojmë, mund të dallojmë një grimcë të asaj përsosmërie. E shohim në një mirësjellje, kur falim dhe japim hir për dikë. E shohim në ngjyrat e bukura të një perëndimi. E shohim te gjërat e vogla dhe për pak çaste rindiejmë se gjithçka është në rregull. Gjithsesi, mbaron... nuk zgjat. Do të diskutojmë pse ndodh kështu në kapitullin e radhës, por këtë javë, kërkoju studentëve të kujtojnë një moment që i ka bërë të përjetojnë mirësinë e vërtetë të Perëndisë. Kërkoju disa prej tyre të ndajnë shkurtimisht.

FJALË KYÇ:

Mirësia vërtetë: një standard i përcaktuar nga Perëndia

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 1.7 mësuam se Perëndia ka krijuar gjithçka dhe se gjithçka Ai krijoi ishte e mirë.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 1:31

Nëse do të bëhej fjalë për një konkurs bukurie, nuk do të ishte e drejtë. Konkurrentët nuk mund të jenë edhe juria, por Perëndia është të dyja këto. Nëse Ai bën diçka, ajo gjë është e mirë. Nëse Ai e quan diçka të mirë, ajo është mirësi. Mirësia e vërtetë përcaktohet vetëm nga Perëndia dhe nga askush tjetër (Isaia 5:20).

SHTJELLOJMË:

A përpiqesh ndonjëherë të jesh edhe konkurrent, edhe juri? Kujt i beson që të të tregojë çfarë është e mirë dhe çfarë jo? Pse?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 2:9

Si njerëz të krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, kuptimin e së mirës e marrim nga Ai. Ai bëri pemë për Adamin, të cilat ishin të këndshme për t'u parë dhe të mira për t'u ngrënë. Përse Adamit iu dukën të këndshme? Atij iu dukën të këndshme sepse Perëndia i kishte bërë të mira për Adamin. Perëndia na ka dhënë gjithashtu aftësinë për të shijuar atë që Ai e quan shumë të mirë (Jakobi 1:17).

SHTJELLOJMË:

Nëse Perëndia të bëri ty shumë mirë sipas planit të Vet dhe bëri ushqim shumë të mirë që ti të hash, a mendon se Ai kënaqet kur sheh se ti po shijon krijimin e Tij shumë të mirë? Përse po ose jo?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 2:18

Pothuajse asnjëherë Bibla nuk e përdor fjalën nuk është mirë, përveçse në rastet kur flet për diçka që dikush e ka bërë gabim. Në këtë rast, fjala nuk është mirë, nuk i referohet mëkatit; këto fjalë këtu përdoren për ta bërë tokën një vend më të mirë për Adamin. Perëndia e dinte se Adamit i duhej një person tjetër që bota të ishte e plotë. Ne kemi nevojë për njerëzit e tjerë sepse Perëndia na ka modeluar për t'i bërë gjërat së bashku (1 e Korintasve 12:12).

SHTJELLOJMË:

Cilët janë njerëzit e tu të preferuar me të cilët do të punoje? Si do të ndryshonte puna jote nëse ata nuk do të ishin aty?

DITA 6

LEXO: ROMAKËVE 1:19-20

Perëndia do që krijimi që Ai vetë ka bërë, të mund ta njohë Atë. Ai do që ne të kuptojmë se sa i mirë është Ai, duke parë se sa i mirë është krijimi i Tij. Kur ne nuk pranojmë se Ai është Krijuesi i çdo gjëje të mirë, ne e refuzojmë Atë si Perëndi.

SHTJELLOJMË:

Çfarë na mëson bota rreth nesh për punën e Perëndisë? Nëse kjo është mënyra se si Zoti punon, atëherë si duhet të punosh ti?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Të stimulosh përparimin/ të furnizosh motorin

Nëse ke një korrëse bari, pastrues apo një lloj tjetër fshese elektrike, ti e di që duhet të ndezësh pompën e saj. Është një buton i vogël i kuq që e furnizon mekanizmin me karburant, e cila të rrotullohet kur heq kordonin. Ndonjëherë truri i studentëve ka nevojë të furnizohet. Ndoshta mund të përgatisësh një ose dy pyetje për ata para se të jetë takimi. Nëse studentët janë aktivë në teknologji mund t'u dërgosh një mesazh ku i shkruan pyetjet. Nëse kanë mediat sociale mund t'ua çosh atje pyetjet që të mund t'i mendojnë para se të vijnë në takim. Duke e bërë që para takimit këtë stimulim, u jep kohë studentëve që të përgatitem për një diskutim më të mirë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

PJESËT KRYESORE TË SHKRIMIT:
GJONI 1: 1 - 13;
ZANAFILLA 1: 1 - 31;
ZANAFILLA 2: 8 - 17, 21 - 25

VARGJET KYÇ:

Gjoni 1:1-3; Romakëve 4:17; Zanafilla 1:27; Jobi 38:4, 10-11; Marku 10:6; Zanafilla 1:26; Zanafilla 1:31

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

NË KAPITULLIN E PARË MËSUAM SE FJALA, JEZUSI, PERËNDIA, ËSHTË KRIJUESI I PAKRIJUAR. Ishte Ai që bëri gjithçka nga asgjëja. Perëndia nuk përdori asnjë material paraekzistues për të krijuar. Gjithçka në krijim u bë nga Perëndia që foli dhe krijoi. Gjithashtu mësuam se Ai bëri njerëzimin dhe se njerëzimi u bë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Më pas, Perëndia e vendosi Adamin në kopsht dhe i vendosi njerëzimit kufij. Ndërsa ishte në kopsht, Perëndia tha se nuk ishte mirë që Adami të ishte vetëm, prandaj i bëri një ndihmë të leverdishme për të. Perëndia krijoi Evën dhe të dy, edhe Adami edhe Eva, ishin krijesa e veçantë e Perëndisë. Mësuam se puna ka ekzistuar edhe para rënies së njerëzimit. Perëndia i dha Adamit punën e emërtimit të kafshëve dhe i dha njerëzimit përgjegjësinë për të sunduar mbi botën. Perëndia na thërret të bëjmë gjëra specifike për qëllimet e Tij. Së fundi, mësuam se gjithçka Ai bëri ishte e mirë dhe se standardi i vërtetë i së mirës përcaktohet nga Perëndia. Perëndia bëri gjithçka. Gjithçka ishte e përsosur, ashtu siç duhej dhe e mirë. Njerëzimi ecte me Perëndinë dhe kishte një marrëdhënie të përsosur me Të. Ishte vërtet parajsë. Ishte përkufizimi i vërtetë i së mrekullueshmes!

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të përsërisin shtatë mësimet e fundit.
- Studentët do të përsërisin vargjet, mendimet dhe fjalët kyç të shtatë mësimeve të fundit.
- Studentët do të përmbledhin shtatë mësimet e fundit në një përmbledhje të vetme.

FJALËT KYÇ: Zanafillë, Creatio ex nihilo, Imago Dei, Kufi, Unik, Thirrje, E mira e vërtetë

MENDIMET KYÇ: (Shih çdo mësim)

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•
•
•

SEKSIONI 2: LOJRA (NDËRVEPRIM)

KOHA _____

Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët kanë pasur lojëra të ndryshme. Shiko seksionin "Vlerësoje" dhe kërko një lojë të cilën studentët e kanë shijuar shumë dhe luajeni sërish. Nëse njëri nga projektet e shërbesës ka pasur më shumë ndikim, merrni pak kohë për të ndarë për të. Kërkoju studentëve të ndajnë një dëshmi se si ndikoi kjo eksperiencë te ta.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

KOHA _____

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim – Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët e tu kanë mësuar shumë për veprimet e Perëndisë si Krijues. Ata kanë mësuar disa fjalë kyç dhe disa vargje të njohur apo të rinj. Kërkoju studentëve ta fillojnë këtë përsëritje duke treguar si i ka prekur ky kapitull. Nëse grupi është i dhënë pas artit, mund t'i përmblidhni shtatë mësimet në një dramë apo skeç ku tregoni përmbledhjen e të shtatë mësimeve.

PLANIFIKOJE TI – MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

KOHA _____

MËSIMI 1.1

Vargu kyç: *Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë. (Gjoni 1:1-3)*

Fjalë kyç: Zanafilla: fillimi, krijimi ose burimi

Mendimi kyç: Fjala, Jezusi, Perëndia, është Krijuesi i pakrijuar.

MËSIMI 1.2

Vargu kyç: *(Siç është shkruar: "Unë të kam caktuar atin e shumë kombeve"), është ati i të gjithë neve para Perëndisë që ai besoi, i cili i jep jetë të vdekurve dhe thërret gjërat që nuk janë sikur të ishin. (Romakëve 4:17)*

Fjalë kyç: *Creatio ex nihilo.* Krijimi nga asgjëja

Mendimi kyç: Në krijim Perëndia bëri gjithçka nga asgjëja.

MËSIMI 1.3

Vargu kyç: *Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën. (Zanafilla 1:27).*

Fjalë kyç: *Imago Dei:* shëmbëlltyrë e Perëndisë

Mendimi kyç: Ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

MËSIMI 1.4

Vargu kyç: *Ku ishe kur unë hidhja themelet e tokës? Thuaje, në rast se ke aq zgjuarsi. Kur i caktova një kufi dhe i vendosa shufra hekuri dhe porta, dhe thashë: "Ti do të arrish deri këtu, por jo më tutje; këtu do të ndalen valët e tua krenare?" (Jobi 38:4, 10-11)*

Fjalë kyç: Kufi: diçka që tregon kufizim apo limit

Mendimi kyç: Perëndia i vuri kufij Adamit dhe Evës. Ai na ka vënë kufij ty edhe mua gjithashtu.

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

KOHA _____

MËSIMI 1.5

Vargu kyç: *Por në fillim të krijimit, Perëndia i bëri mash-kull e femër. (Mark 10:6)*

Fjalë kyç: Unik: të mos kesh të ngjashëm apo të barabartë, i pakrahasueshëm

Mendimi kyç: Perëndia e bëri njeriun pjesën e veçantë dhe unike të krijimit të Tij.

MËSIMI 1.6

Vargu kyç: *Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe." (Zanafilla 1:26)*

Fjalë kyç: Thirrje: qëllimi që Perëndia ka për jetën tënde

Mendimi kyç: Perëndia e ka bërë gjithsecilin prej nesh për një qëllim specifik.

MËSIMI 1.7

Vargu kyç: *Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë. (Zanafilla 1:31)*

Fjalë kyç: E mira e vërtetë: një standard i përcaktuar nga Perëndia

Mendimi kyç: Perëndia bëri çdo gjë, dhe çdo gjë që Ai bëri ishte e mirë.

SHËNIME:

FILLONI:

KOHA _____

- Cila gjë apo koncept të ka mbetur në mendje gjatë shtatë javëve të fundit?
- Përse është i rëndësishëm për ty ky koncept?

JAVA 1

LEXO: GJONI 1: 1-3

WORK IT OUT:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Çfarë rëndësie ka që Jezusi është Krijuesi i pakrijuar?

JAVA 2

LEXO: ROMAKËVE 4:17

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Pse është kaq e rëndësishme që Perëndia bëri gjithçka nga asgjëja?

JAVA 3

LEXO: ZANAFILLA 1:27

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Përse është kaq e rëndësishme të dimë se ne (njerëzit) jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë?

JAVA 4

LEXO: JOBI 38: 4, 10-11

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Përse na vuri kufi Perëndia dhe përse është kaq e rëndësishme që ne t'i dimë ato?

JAVA 5

LEXO: MARKU 10:6

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Si vazhdojmë ta dallojmë mënyrën unike me të cilën Perëndia ka krijuar gjithsecilin?

JAVA 6

LEXO: ZANAFILLA 1:26

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Çfarë ndryshimi sjell fakti që Perëndia e ka krijuar secilin prej nesh për një qëllim specifik?

JAVA 7

LEXO: ZANAFILLA 1:31

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Si ndikon në botën tënde përcaktimi që Perëndia jep për të mirën e vërtetë?

SEKSIONI 5: VLERËSOJE

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 2.1

KUNDËRSHTARI

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 3:1

VARGU KYÇ:

Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vurbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë.

1 e Pjetrit 5:8

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

SHUMICA E HISTORIVE EPIKE KANË NJË PERSONAZH NEGATIV. Personazhi negativ është antagonisti, dikush që sjell shkatërrim, vdekje, konflikt dhe ligësi në rrëfim. Historia e Perëndisë e ka një personazh të tillë, emri i tij është satan. Historia e satanit është tragjike. Ai ishte engjëlli më i bukur dhe më i shkëlqyer i Perëndisë, megjithatë nuk ishte i kënaqur me rolin e tij dhe deshi të ishte Perëndi. Kryengritja dhe rebelimi i tij kundër Perëndisë çuan në luftë. Në fund, ai dhe një e treta e engjëjve u ngritën kundër Perëndisë dhe nuk ndaluan para asgjëje duke sjellë vdekje, shkatërrim, konflikt dhe ligësi në botë. Satani, drejtuesi i tyre, është kundërshtari i njerëzimit. Te Gjoni 10:10 Jezusi thotë: *"Vjedhësi nuk vjen veçse për të vjedhur, për të vrarë e për të shkatërruar..."*

Dhe te 1 e Pjetrit 5:8, satani përshkruhet si një *luan vrumbullues që kërkon cilin të përpijë*. Ai është një gjahtar, grabitqari i shpirtrave. Satani na prezantohet në fillim të kapitullit 3 të Zanafillës. Një nga taktikat e tij më të vjetra është hutimi dhe gënjeshtra. Satani takohet me Evën dhe në dialogun me të, ai shtrembëron fjalët e Perëndisë dhe gënjen Evën. Satani është kundër Perëndisë, ai e do lavdinë për vete. Ai është përkufizimi i vërtetë i mëkatit dhe egoizmit. Ai nuk do të ndalet para asgjëje për të shkatërruar marrëdhënien midis Perëndisë dhe njerëzve. Satani është kundërshtari i njerëzimit. Ai na kundërshton dhe na sulmon.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dijnë kush është satani dhe do të mund të përshkruajnë prejardhjen e tij historike.
- Studentët do të njohin qëllimin e satanit dhe rolin e tij si kundërshtar i njerëzimit.
- Studentët do të njohin taktikat e satanit dhe ndërveprimin e tij me Evën te Zanafilla 3.

FJALË KYÇ: Kundërshtar: person, grup apo një forcë që kundërshton dhe sulmon

MENDIM KYÇ: Satani është kundërshtari i njerëzimit.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Alienët kundër grabitqarëve (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 6, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Topi sulmues (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 11, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Arushë dhe batanije. Ka shumë njerëz që përballen me kundërshtarë nga më të ndryshmit. Dhuna fizike është një realitet dhe ndodh edhe në shtëpitë tona. Ka vende ku gratë dhe fëmijët mund të shkojnë për të gjetur ndihmë nga një mjedis ku përjetojnë dhunë fizike. Këta njerëz kanë nevojë për një vend ku të qëndrojnë dhe të pushojnë, ndërsa marrin veten nga një situatë që u ka shkaktuar shumë dëme fizike dhe emocionale. Grupi yt mund të ndihmojë! Shumë prej këtyre shtëpive apo qendrave kanë nevojë për gjëra materiale që t'i ndihmojnë familjet që përballen me situata krizash. Ndoshta ti dhe studentët nuk do të mund të shkoni te këto qendra dhe të shërbeni si vullnetarë, por mund të gjeni një qendër me të cilën të bashkëpunoni. Kërkoju studentëve të mbledhin arusha, jorganë, batanije etj., dhe dhurojini te qendra me të cilën keni kontaktuar. Këto gjëra të thjeshta të përditshmërisë sonë mund të kenë ndikim të madh tek ata që kalojnë një kohë krize.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të bënin një listë me të gjitha dyshet e heronjve dhe personazheve negativë që u vinin në mendje. Mund të ishin personazhe librash, filmash apo çfarëdo burimi historik. Pastaj ata duhet të qarkonin tre ose katër dyshet e tyre të preferuara. Filloje kohën me grupin e madh duke i bërë pyetjet e mëposhtme.

1. Çfarë e bën një hero të mirë?

2. Çfarë e bën personazhin negativ të keq apo të lig?

3. Përse disa personazhe negativë janë më të frikshëm se të tjerët?

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vurbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë.

1 e Pjetrit 5:8

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:1

QË PREJ FILLIMIT TË KRIJIMIT, SATANI KA BËRË SKEMA KEQDASHËSE.

Por gjarpri ishte më dinaku ndër të gjitha bishat e fushave që Zoti Perëndi kishte krijuar, dhe i tha gruas: "A ka thënë me të vërtetë Perëndia: "Mos hani nga të gjitha pemët e kopshtit?"

Zanafilla 3:1

SATANI NA URREN.

Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë.

1 e Pjetrit 5:8

QËLLIMI I SATANIT ËSHTË TË NA SHKATËRROJË.

Vjedhësi nuk vjen veçse për të vjedhur, për të vrarë e për të shkatërruar; por unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.

Gjoni 10:10

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Një prej gjërave që të gjithë personat në këtë sallë kanë të përbashkët është se janë shënjestra të satanit. Ai është kundërshtari i gjithë njerëzimit. Askush nuk përjashtohet në gjuetinë e tij. Ai do të shkatërroje çdo marrëdhënie që njerëzimi ka me Perëndinë. Një prej shembujve më të fuqishëm të përballjes të tundimit është tundimi i Jezusit në shkretëtirë. Ai u përball me Satanin dhe të vërtetën e Fjalës së Perëndisë. Si mund t'i kujtojmë njëri-tjetrit të vërtetën e Fjalës së Perëndisë, kur përballemi me tundimin? Ja disa ide që mund të përdorësh për t'u kujtuar studentëve të vërtetën e Fjalës së Perëndisë kur përballen me taktikat dhe planet keqdashëse të kundërshtarit tonë, satanit.

1. **Krijo një faqe në mediat sociale ku studentët mund të postojnë kërkesat e tyre të lutjes.**

2. **Krijo "murin e së vërtetës", një vend ku mund të vendosni pjesë të Shkrimit ose të vërteta që mund t'i shohin sa herë vijnë për takimin me grupin.**

3. **Bëj gurë të së vërtetës. Mblidh gurë dhe gdhend në to një varg apo një fjalë që të ndihmon t'u kujtosh atyre të vërtetën e Perëndisë.**

4. **Partnerë lutjeje–ndaji në dyshe studentët dhe nxiti që të luten për njëri-tjetrin.**

FJALË KYÇ:

Kundërshtar: person, grup apo një forcë që kundërshton dhe sulmon

Këto janë gjëra të thjeshta për t'u bërë, por kemi nevojë të kujtojmë vazhdimisht të vërtetën e Perëndisë. Nëse nuk e dimë të vërtetën e Perëndisë, si do të njohim gënjeshtrat me të cilat kundërshtari ynë përpiqet të na ushqejë? Ndihmoji studentët të krijojnë këto zakone që do të kenë ndikim të madh në jetën e tyre.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.1 mësuam se satani është kundërshtari i njerëzimit.

DITA 3

LEXO: MATEU 4:1-2

Ndërsa lexojmë për tundimin, shiko se si djalli e përfshin Jezusin. E para, djalli është i limituar. Ai mund të jetë vetëm në një vend. Së dyti, ai pret derisa Jezusi të ishte i uritur dhe i dobët për ta tunduar. Djalli nuk mund të jetë kudo, edhe pse ka demonët e tij, ai nuk mund të krahasohet me Birin e Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

Kur ndihesh më i tunduar? Kur besimi yt është i fortë dhe Perëndia është afër? Apo kur je i lodhur dhe ke dyshime? Shpjegoje.

DITA 4

LEXO: MATEU 4:3-4

Satani e tundoi Jezusin për të provuar fuqinë e Tij. Jezusi nuk duhet t'i tregojë apo provojë askujt asgjë. Në të njëjtën mënyrë, djalli nuk e di se çfarë je ti i aftë të bësh, por as ti nuk ke pse i vërteton asgjë atij.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një kohë kur je tunduar. A u dobësove shpirtërisht sepse iu dorëzove tundimit apo frikës, në vend që të qëndroje i palëkundur në fjalët e Perëndisë? Shpjegoje.

DITA 5

LEXO: MATEU 4:5-7

A e dije që satani e njeh Shkrimin? Ai e ka mësuar shumë mirë që të mund ta shtrembërojë për qëllimet e veta. Është shumë e rëndësishme për ne që t'i mësojmë qartë Shkrimet (si Jezusi bëri) që të mund të kuptojmë gënjeshtrat e të ligut.

SHTJELLOJMË:

Sa mirë e njeh të vërtetën e Fjalës së Perëndisë? A ke mundur ndonjëherë t'i përdorësh të vërtetat e Fjalës së Perëndisë për të qëndruar kundër një tundimi shpirtëror? Përshkruaje eksperiencën tënde.

DITA 6

LEXO: MATEU 4:8-11

Djalli u largua kur Jezusi i tha të vërtetën. Satani preferon hijet dhe errësirën, jo dritën dhe të vërtetën. Kur ne nxjerrim të vërtetat e Fjalës së Perëndisë përballë gënjeshtrave të djallit, ai do të largohet (1 e Pjetrit 5:8).

SHTJELLOJMË:

Cilat janë disa gënjeshtra që ti i beson për veten? (Nuk të duan? Nuk je i rëndësishëm? Nuk je i çmuar për Perëndinë?) Cilat vargje mund të të ndihmojnë që t'i kundërshtosh këto gënjeshtra me të vërtetën e Perëndisë?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

I veçuar

Mund të ndodhë në grupin tënd që të gjithë (përfshirë edhe ti) nuk bien dakord me një student tjetër. Ndoshta ai thotë diçka që nuk është e vërtetë ose ka një përjetim besimi të ndryshëm. Mënyra si ti përballesh me këtë situatë është SHUMË e rëndësime. Një student nuk do të dojë më të vijë në takimin e grupit, nëse katër apo pesë studentë së bashku me drejtuesin e kundërshtojnë. Jemi shumë të shpejtë në korrigjimin e gabimeve, por nuk marrim kohë të dëgjojmë studentët dhe të kuptojmë çfarë duan të thonë dhe çfarë ndikimi ka prejardhja e tyre. Jepu studentëve mjaftueshëm kohë të ndajnë. Inkurajoji të mos hidhen direkt në kundërshtim ndaj të tjerëve, por mësoji të bëjnë pyetje jogjykuese. Studenti mund të jetë tërësisht gabim dhe këto gabime mund t'i ndreqësh më vonë, por grupi ka nevojë për një vend të sigurt.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 2.2

TUNDIMI

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 3:1-5

VARGU KYÇ:

Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.

1 e Korintasve 10:13

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

JAVËN E KALUAR PAMË ANTAGONISTIN KRYESOR, SATANIN. Folëm për historinë dhe taktikat e tij. Megjithatë, njërën taktikë ai e përdor vazhdimisht: tundimin. Çdokush e përjeton tundimin. Kur ishim të vegjël tundoheshim të merrnim karamelet te dollapi. Tundohemi të themi një gënjeshtër për të mbuluar të vërtetën, tundohemi të kalojmë disa limite morale për të përjetuar disa gjëra. Tundohemi të ndjekim rrugë që duken të drejta dhe të kënaqshme, por që në fund na çojnë në shkatërrim. Te Zanafilla 3 gjejmë dy personazhe, gjarpri dhe Eva. Ata kanë një bashkëbisedim rreth të vërtetës që Perëndia ka thënë. Nga ana e satanit, biseda është e shtrembëruar dhe e përgënjeshtruar. Duket sikur ai shqetësohet për Evën. Shpesh tundimi vjen miqësor në fillim, pastaj nxjerr kokën. Fara e gënjeshtrës është mbjellë. Ti dhe studentët e tu përballeni çdo ditë me tundimin. Tundimi është po aq i pranishëm sa ajri që thithim. Megjithatë, Perëndia nuk na largon nga tundimi. Ai dëshiron që ne të zgjedhim Atë dhe të besojmë të vërtetën e Tij për shkak të dashurisë që kemi për Të. Vër re si Ai ishte i pranishëm gjatë këtij bashkëbisedimi, megjithatë nuk ndërhyn. Ai nuk e ndal Evën dhe nuk e korrigjon gjarprin. Të gjithë, madje edhe Jezusi, e përjetojnë tundimin. Perëndia nuk do të na largojë nga tundimi, por Ai dëshiron që ne të mbështetemi tek e vërteta e Tij dhe të qëndrojmë fitimtar në mes të tundimit.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se satani e tundoi Evën duke vënë në dyshim fjalët specifike të Perëndisë.
- Studentët do të dinë se satani e tundoi Evën duke vënë në dyshim drejtësinë e Perëndisë.
- Studentët do të dinë se satani e tundoi Evën duke vënë në dyshim mirësinë e Perëndisë.

FJALË KYÇ: Tundim: një kohë/periudhë sprove

MENDIMI KYÇ: Të gjithë ne tundohemi.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojrat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Ruaju (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 114, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Gara me tri këmbë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 120, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Një vend pushimi. Ky është një projekt shërbese më i përshtatshëm për drejtuesit, por edhe studentët mund t'u shërbejnë miqve të tyre duke i ftuar. Tundimi është një nga ato temat shumë personale. Tundimi me të cilin përballemi, shpesh mund të mos vihet re dhe mund të ekzistojë vetëm në hapësirat sekrete të jetës sonë. Jepu studentëve mundësinë për të fituar besimin e njëritjetrit duke i ftuar në shtëpinë tënde, duke marrë me qira një hapësirë kampingu ose duke shkuar diku për pushime. Jepu një vend pushimi nga tundimet e përditshme dhe kaloje fundjavën duke u argëtuar, duke ndërtuar marrëdhënie, gjithashtu duke folur për disa nga tundimet e zakonshme me të cilat përballen studentët e tu. Jepu hapësirë për të folur që ju si drejtues të kuptoni se çfarë ndodh në jetën e tyre. Sigurohu të jetë një vend i sigurt, një ambient i ngrohtë dhe miqësor, dhe ndiq politikat e mbrojtjes së fëmijëve që ka kisha juaj.

PLANIFIKOJE TI - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDEAS —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të bënin një listë të tundimeve dhe mëkateve më të mëdha me të cilat përballen. Pastaj duhet të mendonin mëkatin me të cilin mundoheshin më shumë. Në varësi të afërsisë që kanë studentët me njëri-tjetrin, mund të ndani për to. Megjithatë është mirë që ta nisësh mësimin me një shembull të një tundimi që ti përjeton. Trego një histori nga vitet e tua të adoleshencës kur je përballur me një tundim. Kjo do t'i ndihmojë studentët të kuptojnë se çdokush, përfshirë edhe ty, tundohet.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.

1 e Korintasve 10:13

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:1-5

SATANI E TUNDOI EVËN DUKE VËNË NË DYSHIM FJALËT E PERËNDISË.

Por gjarpri ishte më dinaku ndër të gjitha bishat e fushave që Zoti Perëndi kishte krijuar, dhe i tha gruas: "A ka thënë me të vërtetë Perëndia: 'Mos hani nga të gjitha pemët e kopshtit?"

Zanafilla 3:1

SATANI E TUNDOI EVËN DUKE VËNË NË DYSHIM DREJTËSINË E PERËNDISË.

Atëherë gjarpri i tha gruas: "Ju s'keni për të vdekur aspakn."

Zanafilla 3:4

SATANI E TUNDOI EVËN DUKE VËNË NË DYSHIM MIRËSINË E PERËNDISË.

Por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen.

Zanafilla 3:5

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Të gjithë përballemi me tundime. Edhe vetë Jezusi u tundua, por nuk mëkatoi. Megjithatë Jezusi përdori fjalët e Perëndisë dhe të vërtetën që gjendej në to për t'u përballur me tundimet e djallit. Kërkoju studentëve të identifikojnë një fushë të jetës në të cilën tundohen më shumë. Pasi studentët të kenë pasur një mundësi për të ndarë, shkruaja të vërtetat e Perëndisë në letra të vogla që të mund t'i marrin me vete. Kështu do të kenë një kujtesë fizike të së vërtetës së Perëndisë ndërsa përballen me tundimin gjatë javës. Inkurajoji studentët t'i vendosin këto fletë në një hapësirë ku mund ta shohin çdo ditë (dollap, pasqyra e tualetit etj.). Gjëja e rëndësishme është të bëjmë atë që Jezusi bëri dhe t'u mësosh studentëve të përdorin Shkrimin kur përballen me tundime.

FJALË KYÇ:

Tundim: një kohë/periudhë sprove

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.2 mësuam se të gjithë tundohemi.

DITA 3

LEXO: JAKOBI 1:12

Është e vështirë të përballesh me sfida dhe tundime. I ndodhin kujtdo, i ndodhën edhe Jezusit (Mateu 4:1-11, Hebrenjve 4:15). Megjithatë, ato ose na japin mundësinë t'i besojmë më shumë Perëndisë, ose të largohemi prej Tij dhe të dorëzohemi para tundimit.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një rast kur ke këmbëngulur në marrëdhënien tënde me Perëndinë gjatë një periudhe të vështirë. A ishte e lehtë apo e vështirë? Si e përdori Perëndia atë kohë të jetës tënde për të të afruar më shumë pranë vetes së Tij?

DITA 4

LEXO: JAKOBI 1:13-14

Atëherë, nëse Perëndia nuk na tundon, kush e bën? Në rastin e Evës ishte gjarpri, por nuk na përmendet gjarpri apo satani në këtë varg. Ne, në fakt, nuk kemi nevojë për ndihmë në këtë pjesë! Ne vetë duam të mëkatojmë, tërhiqemi nga mëkati dhe i krijojmë mundësi vetes për t'u tunduar.

SHTJELLOJMË:

Përse mendon se disa të krishterë duan t'ia hedhin fajin satanit për dëshirën e tyre për të mëkatuar? A na ndihmon të kuptojmë se dëshira për mëkat lind nga brenda nesh dhe nuk vjen nga jashtë nesh? Si na ndihmon kjo gjë?

DITA 5

LEXO: JAKOBI 1:15

Kjo është një çështje e rëndësishme, të cilën ne jo gjithmonë e kuptojmë: Të ndihesh i tunduar për mëkat NUK është njësoj me të mëkatuarit. Të gjithë tundohen! Të gjithë ne kemi më shumë uri për disa mëkate të caktuara, por të kesh uri nuk është njësoj si të hash.

SHTJELLOJMË:

Përse mendon se ndihemi ndonjëherë fajtorë se tundohemi për mëkat dhe nuk kuptojmë se çdokush e kalon këtë gjë? Kur kjo ndodh, si përballemi ne me ato ndjenja? A i injorojmë? A i parashtrojmë te Perëndia? Shpjegoje.

DITA 6

LEXO: JAKOBI 1:16-17

Ky është ai mendimi i rrezikshëm që hap derën për shumë mëkate: Perëndia po përpiqet të më mbajë larg gjërave të mira. Mos e beso këtë.

SHTJELLOJMË:

Nëse Perëndia do të të japë dhurata të mira, përse të thotë të mos i bësh disa gjëra? A e beson vërtet se Perëndia do më të mirën tënde? Pse?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Dua pushim!

Ndonjëherë është mirë të bëjmë pushim nga drejtimi i diskutimeve. Shpesh grupet e diskutimit shkojnë mirë nëse herë pas here ndryshon ndihma thjeshtësuese e diskutimit. Ndoshta për rreth një muaj jepi mundësi çdo studenti të drejtojë grupin e diskutimit. Merr pjesë në diskutim, por lejoje studentin të drejtojë. Duke i dhënë çdo studenti një mundësi të tillë, mund t'u japësh një perspektivë që nuk e kanë. Lëri të përjetojnë vështirësinë e ruajtjes së përqendrimit të grupit etj. Kjo mund t'i bëjë të kuptojnë atë që ti bën. Kujto që edhe ti do të jesh pjesë e diskutimit dhe do ta ndihmosh grupin kur të ketë nevojë. Sigurohu që studenti që drejton të ketë mjaftueshëm kohë për t'u përgatitur.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
ZANAFILLA 3:4-7

VARGJET KYÇ:

Atëherë gjarpri i tha gruas: "Ju s'keni për të vdekur aspak; por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen."

Zanafilla 3:4-5

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

DUKET SE ËSHTË NJË PREJ TEMAVE MË TË ZAKONSHME TË KRISHTERIMIT, POR A E KUPTOJMË VËRTET ÇFARË DO TË THOTË? Për studentët, përcaktohet si diçka e keqe, mosbindje ndaj Perëndisë ose të mos qëllosh në shenjë. Por çfarë është vërtetë në thelb mëkati? Kur Adami dhe Eva mëkatuan në kopsht, çfarë po bënin vërtet? Çfarë donte gjarpri që ata të bënin? Po ta zhveshim nga të gjithë termat e përdorur për ta përcaktuar, mëkati është thjesht dëshira jonë për të qenë Perëndi. Kur ne mëkatojmë, duam atë që satani donte dhe atë me të cilën ai tundoi Evën. Ai do të ndahet nga ligjet dhe sistemet e Perëndisë. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë është të bëhesh vetë zot. Pastaj mund të krijosh sistemin tënd dhe të jetosh në pavarësi larg mbikëqyrjes apo sundimit të dikujt tjetër. A nuk është ky tundimi që i ofrohet Evës në kopsht? A nuk i ofron satani Evës iluzionin e një sistemi ku nuk e ka Perëndia kontrollin, por ajo? Është e rëndësishme që studentët tanë të kuptojnë çfarë është mëkati dhe se kur ne mëkatojmë, tregojmë dëshirën tonë për të pasur kontroll. Ne shprehim dëshirën tonë për të bërë rregullat dhe për të përcaktuar sistemin. Kur ne mëkatojmë, shprehim dëshirën tonë për të qenë Perëndi.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se mëkati është dëshira jonë për të qenë Perëndi.
- Studentët do të dinë se satani e tundoi Evën të jetonte një jetë të pavarur nga Perëndia.
- Studentët do të dinë se Adami dhe Eva e morën vetë vendimin për të mëkatuar.

FJALË KYÇ: Mëkati: dëshira jonë për të qenë Zot

KEY THOUGHT: Mëkati është dëshira jonë për të qenë Zot.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Bomba (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 20, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Le të bëjmë marrëveshje (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 58, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Kutia e veglave të studentëve. Ndonjëherë, të kërkuarit e ndihmës, mund të jetë sfidë për disa njerëz. Krenaria pengon. Na thuhet se duhet të mbajmë veten dhe shpesh nuk lejojmë që njerëzit të na ndihmojnë. Ja një ide për t'u shërbyer njerëzve në komunitetin tuaj. Kërkoju studentëve të rendisin të gjitha aftësitë që kanë. Disa nga studentët mund të korrin barin, të mbledhin gjethet, të lyejnë, të pastrojnë shtëpi, të kujdesen për fëmijët etj. Vendos lajmërime në komunitetin tënd që njerëzit të mund të telefonojnë dhe të kërkojnë ndihmë. Pastaj kërkoju studentëve që, nën mbikëqyrjen e një drejtuesi, t'u përgjigjen nevojave të komunitetit.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të krijonin diçka që sipas tyre përfaqësonte mëkatin. Disa mund të kenë vizatuar diçka ose të kenë marrë një fletë nga një revistë dhe e kanë ngjitur në librin e studentit. Filloje mësimin duke i pyetur nëse ndonjëri prej tyre dëshiron të ndajë atë që ka gjetur apo krijuar. Përfundoje duke treguar atë që ti ke menduar. Përdore këtë si mënyrë kalimi për në pjesën tjetër.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGJET KYÇ:

Atëherë gjarpri i tha gruas: "Ju s'keni për të vdekur aspak; por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen."

Zanafilla 3:4-5

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:4-7

MËKATI ËSHTË DËSHIRA JONË PËR TË QENË PERËNDI.

Por gjarpri ishte më dinaku ndër të gjitha bishat e fushave që Zoti Perëndi kishte krijuar, dhe i tha gruas: "A ka thënë me të vërtetë Perëndia: 'Mos hani nga të gjitha pemët e kopshtit?"

Zanafilla 3:1

MËKAT DO TË THOTË TË JETOSH NJË JETË TË PAVARUR NGA PERËNDIA.

Por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen.

Zanafilla 3:5

MËKATI ËSHTË NJË VENDIM QË E MARRIM VETË.

Dhe gruaja pa që pema ishte e mirë për t'u ngrënë, që ishte e këndshme për sytë dhe që pema ishte i dëshirueshme për ta bërë të zgjuar dikë; dhe ajo mori nga fryti i saj, e hëngri dhe i dha edhe burrit të saj që ishte me të, dhe hëngri edhe ai.

Zanafilla 3:6

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Le ta aplikojmë këtë! Kërkoju studentëve që, të gjithë përnjëherë, të mundohen të bindin njëri-tjetrin se ushqimi, filmi, skuadra apo banda e tyre e preferuar (zgjidh vetëm një temë) është më e mira. Shiko sa rrëmujë bëhet kur të gjithë bërtasin dhe insistojnë se preferenca e tyre është më e mira. Mëkati është dëshira jonë për të qenë Perëndi. Ne duam që të gjithë të bëjnë atë që duam ne. Ne duam që mendimet, ëndrrat dhe dëshirat e të gjithëve të jenë si tonat. Ne duam që të gjithë të interesohen për pozitën dhe mendimet tona. Kur ne mëkatojmë duam të jemi zot të vetes. Pas disa minutave kaos, jepi mundësinë gjithsecilit të shprehë këndvështrimin e vet për një minutë. Gjithsesi kësaj radhe vendos rregulla dhe lehtësoje ndërveprimin me studentët. Në fund pyeti studentët se cila nga aktivitetet ishte më ndihmues për ta. A ju duk aktiviteti me kaos, më i mirë apo kuptuan se kur kishte rregulla dhe rend ishte më e thjeshtë të dëgjonin dhe kuptonin njëri-tjetrin?

FJALË KYÇ:

Mëkati: dëshira jonë për të qenë Zot

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.3 mësuam se mëkati është dëshira jonë për të qenë Perëndi.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 3:4-5

Kur djalli u tha atyre: "nuk do të vdisni", në thelb po thoshte se ka një mundësi tjetër zgjedhjeje përveç mënyrës së Perëndisë. Kur tundohemi, mëkati duket gjithmonë shumë pozitiv: "Do të ndihesh mirë! Do të të pëlqejë shumë!" Gjithsesi këto premtime të rreme janë gjithmonë dritëshkurtër. Perëndia e sheh të keqen ashtu siç është.

SHTJELLOJMË:

Nëse mëkati do të dukej i keq (jo argëtues, lëndues, i lig), a do të kishte më shumë mundësi të mos e bëje? Çfarë do të ndodhte nëse ne do të fillonim ta shihnim mëkatin ashtu siç e sheh Perëndia? A ka ndonjë gjë në jetën tënde që duhet të fillosh ta shohësh ndryshe?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 3:6; 1 E GJONIT 2:16

A i vure re tri arsyet e Evës që e shtynë të mëkatonte kundër Perëndisë? Së pari, pema ishte e mirë për t'u ngrënë (dëshira e mishit), që do të thotë se do të kënaqte urinë e SAJ. Së dyti, fryti dukej i këndshëm (dëshira e syve), ajo gjykoi se fryti kënaqte syrin e SAJ. Së treti, fryti do ta bënte të zgjuar (krenaria mburravece), e thënë ndryshe, do të përmirësonte mendjen e SAJ. Mëkati vazhdon të na tërheqë edhe ne për të njëjtat arsye: në të ne jemi qendra!

SHTJELLOJMË:

Cilat mëkate janë më tërheqëse për ty? Njësoj si për Evën, si i plotëson mëkati dëshirat e tua egoiste?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 3:7

Pasoja e parë e mëkatit duket pak e çuditshme për ne. Përse nuk e dinin ata që ishin lakuriq? Ata ishin plotësisht të dëlirë, pa asnjë frikë se mund të ishte e papërshtatshme. E gjithë ajo dëlirësi u largua në vetëm një çast. Që nga ai moment e tutje, njerëzit filluan të ndienin se Perëndia nuk donte kurrë që ne ta njihnim: turpin.

SHTJELLOJMË:

Përse mendon se pasoja e parë e mëkatit ishte që Adami dhe Eva kuptuan lakuriqësinë e tyre? A ke ndjerë ndonjëherë turp për mëkatet e tua? Përshkruaj me fjalët e tua si e ke përjetuar turpin.

DITA 6

LEXO: ROMAKËVE 3:23

Perëndia e urren mëkatin. Ne u krijuam për të qenë me Të, por për shkak të mëkatit tonë nuk mund të jemi me Të (Romakëve 3:9-20). Kaq. Gjithsesi të gjithë mëkatojnë! Dhe e vetmja gjë që mbetet është vdekja e përjetshme, larg Tij përgjithmonë. Megjithatë, ti e di që historia nuk mbaron kështu. Perëndia bëri të mundur që mëkati të shlyhej, që ne të jemi me Të, të gjallë, përgjithmonë, në Krishtin dhe vetëm përmes Tij (Romakëve 3:21-31).

SHTJELLOJMË:

A na thotë mesazhi i Biblës që duhet të mos mëkatojmë më në mënyrë që Perëndia të na pranojë? Apo që Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm të na shpëtojë duke paguar çmimin për mëkatet tona? A është ripërtërirë marrëdhënia jote me Perëndinë, për shkak se ke vendosur besimin në Jezu Krishtin? Përshkruaj përjetimin tënd.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

A po dëgjon?

Ndonjëherë është e vështirë për studentët të transmetojnë atë që po përpiqen të thonë. Kjo pastaj çon në një situatë ku studentët nuk kanë vëmendje dhe ndërhyjnë në momentet kur flasin të tjerët. Kjo mund të jetë shpërqendruese dhe mosrespektuese. Inkurajoji studentët të praktikojnë aftësitë e të dëgjuarit duke përmbledhur atë që një student tjetër ka thënë. Shpesh studentët marrin pjesë vetëm kur veprimtaria i përfshin ata. Nëse nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në grup, nuk do të mund të ruajnë përqendrimin. Duke iu kërkuar të përmbledhin atë që një student tjetër ka dashur të thotë po i inkurajon të jenë aktivë në të dëgjuar duke shmangur kështu përfshirjen pasive. Është e rëndësishme që të gjithë në grup të kenë një mundësi për t'u dëgjuar dhe kuptuar.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 2.4

TË FSHIHESH NGA PERËNDIA

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 3:8-11

VARGU KYÇ:

Dhe nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakurią dhe të zbuluara para syve të Atij, të cilit ne do t'i japim llogari.

Hebrenjve 4:13

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

A TË KUJTOHET KUR ISHE I VOGËL DHE futeshe në telashe? E dije që kishe bërë diçka gabim. Ndoshta fshiheshe diku ose përpiqeshe të fshihje dëmin që të mos dukej. Kur bëjmë diçka të gabuar, kemi gjithnjë tendencën të largohemi dhe të fshihemi. Edhe Adami e Eva bënë të njëjtën gjë. Mëkati i tyre shkatërroi diçka. Diçka kishte ndryshuar, nuk shkonte mirë, diçka mungonte dhe reagimi ishte të largoheshin dhe të fshiheshin. Ata u fshehën nga Perëndia dhe pastaj bënë mbulesa për njëri-tjetrin. Efektet e mëkatit të tyre ishin kaq të rënda, saqë ata vrapuan për t'u fshehur nga Perëndia. Ata e dinin se kishin bërë diçka të gabuar. Diçka shumë e çmuar ishte thyer. Ndodh që ne përpiqemi të fshehim veten dhe mëkatin tonë nga Perëndia. Edhe në Shkrime ka raste kur njerëzit kanë vendosur të fshihen nga Perëndia. Jona, për shembull. Problemi i fshehjes nga Perëndia është se nuk mund ta bëjmë në të vërtetë. Askush nuk fshihet nga Perëndia. Megjithatë, edhe kur mëkatojmë, ne mund të shkojmë te Ai ose të ikim nga Ai. Adami dhe Eva kishin të njëjtën zgjedhje atë ditë në kopsht. Në vend që të shkonin te Perëndia dhe t'i besonin Atij, ata morën turpin e tyre dhe u fshehën nga Perëndia.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Adami dhe Eva u fshehën nga Perëndia për shkak të turpit të tyre.
- Studentët do të dinë se mund të mësojmë shumë nga veprimet e Adamit dhe Evës, dhe nga mënyra si ata iu përgjigjën Perëndisë.
- Studentët do të dinë se, edhe pse Adami dhe Eva vrapuan larg Perëndisë, Jezu Krishti vrapoi drejt nesh dhe rregulloi marrëdhënien e thyer me njerëzimin.

FJALË KYÇ: Turp: ndjenja e tmerrshme që vjen pasi ke bërë diçka të pandershme

MENDIM KYÇ: Adami dhe Eva ndjenë turp dhe u fshehën nga Perëndia pasi mëkatuan.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Përbindësh (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 62, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Lojë me xhupa (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 98, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Merr përgjegjësi! Kërkoju studentëve që nën mbikëqyrjen e drejtuesve të marrin përgjegjësi për një program të rregullt të kishës tënde. Mund të jetë mësimi i fëmijëve të dielave, shërbesa e fëmijëve ose një program specifik dhe kërkoju të drejtojnë lojrat duke u dhënë mundësinë drejtuesve të rritur të pushojnë. Luani lojëra argëtuese me fëmijët. Pastaj kërkoju studentëve t'u mësojnë fëmijëve një mësim që kanë marrë së fundmi në një mënyrë që fëmijët mund ta kuptojnë. Mund të jetë në formën e një drame, inskenimi ose diçka tjetër që tërheq vëmendjen e tyre. Në fund, studentët do t'u shërbejnë drejtuesve duke u mundësuar pak pushim. Gjithashtu do t'u shërbejnë fëmijëve duke iu mësuar të vërtetën e Fjalës së Perëndisë. Është përfitim për të dyja palët.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDEAS —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentëve u është dashur të gjejnë dy hapësira të ndryshme për të regjistruar mendimet e tyre. Duhet të shkonin në një vend të ngrohtë, tërheqës dhe plot dritë. Pastaj duhet të gjenin një vend të errët. Në të dyja rastet duhet të shënonin se si u ndjenë në të dy ambientet. Filloje mësimin duke ndarë përjetimin tënd në këto dy ambiente. Pastaj inkurajoji studentët të ndajnë. Nëse janë grup i madh, kërkoju studentëve të përmbledhin me një fjalë përjetimin e tyre (p.sh., errësirë, izolim, frikë, gëzim, ngrohtësi etj.).

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGU KYÇ:

Dhe nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara para syve të Atij, të cilit ne do t'i japim llogari.

Hebrenjve 4:13

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:8-11

PASI MËKATUAN, ADAMI DHE EVA VRAPUAN DHE U FSHEHËN NGA PERËNDIA.

Pastaj dëgjuan zërin e Zotit Perëndi që shëtiste në kopsht në flladin e ditës; dhe burri e gruaja e tij u fshehën nga prania e Zotit Perëndi midis pemëve të kopshtit.

Zanafilla 3:8

PASI MËKATUAN, PERËNDIA I KËRKOI.

Atëherë Zoti Perëndi thirri njeriun dhe i tha: "Ku je?"

Zanafilla 3:9

DUKE QENË SE NE MËKATOJMË, JEZU KRISHTI ERDHI TË NA SHPËTOJË.

Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne

Romakëve 5:8

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Shpesh luftojmë mes dy botëve. Jemi krijuar për t'u njohur. Megjithatë, ndonjëherë nuk duam që të tjerët të dinë se çfarë ndodh brenda nesh. Ne largohemi nga marrëdhëniet dhe njerëzit në të njëjtën mënyrë si Adami dhe Eva u larguan nga Perëndia dhe u fshehën prej Tij.

A ka ndonjë marrëdhënie, problem ose vështirësi nga e cila po largohesh?

A ka diçka që po e fsheh qëllimisht nga pjesëtarët e grupit?

Në çfarë mënyre po fshihesh nga Perëndia? A ka një aspekt të jetës tënde që shpreson që Ai të mos e vërë re?

Adami dhe Eva e dinin se kishin gabuar rëndë atë ditë në kopsht. Perëndia ishte pranë tyre, por ata zgjodhën të vraponin në drejtim të kundërt. Edhe sa kohë do të vazhdosh të vraposh në drejtimin tënd pa kuptuar se Perëndia është pikërisht aty duke të pritur? Ai nuk do që ti të jetosh i rrethuar nga kurthet e turpit tënd. Ai të do.

FJALË KYÇ:

Turp: ndjenja e tmerrshme që vjen pasi ke bërë diçka të pandershme

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.4 mësuam se Adami dhe Eva u turpëruan dhe u fshehën nga P
pasi mëkatuan..

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 3:8-9

Shumë kohë më parë, Adami dhe Eva ecnin në kopsht duke shijuar prezencën e Perëndisë. Pasi mëkatuan ata u fshehën prej Tij. Perëndia na jep gjithmonë mundësi që të kthehemi tek Ai e të jemi të sinqertë, të rrëfejmë mëkatet tona dhe të pranojmë se kemi gabuar. Ai e dinte ku ndodhej Adami, apo jo? Ai është Perëndi. Megjithatë, Ai i dha mundësinë Adamit t'i besonte Atij duke e shfaqur veten.

SHTJELLOJMË:

Ne priremi të injorojmë Perëndinë kur mëkatojmë, të fshehim zemrat prej Tij, të bëjmë sikur Ai nuk është aty. Sa herë je i sinqertë me Të pasi je penduar për zgjedhjen që ke bërë për mëkat?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 3:10-11

A nuk është e habitshme se sa të guximshëm jemi kur nuk i bindemi Perëndisë dhe sa frikacakë bëhemi kur na kërkon t'i themi pikërisht çfarë kemi bërë? Veprimet tona thonë: "Unë nuk kam nevojë për ty Perëndi, do bëj si dua vetë!" Megjithatë,qa pastaj gënjejmë dhe tregojmë gjysmë të vërteta si frikacakë që nuk duan të zbulohen.

SHTJELLOJMË:

Kur e dimë se kemi mëkatuar, përse është kaq e vështirë për ne të tregojmë çfarë kemi bërë dhe përse ishte e gabuar? Përse është kaq e rëndësishme për ne kjo gjë?

DITA 5

LEXO: ROMAKËVE 6:21-22

A ke kafshuar ndonjëherë një fryt të kalbur? Është vërtet një surprizë e neveritshme. Tani një pyetje e çuditshme: A e ke kafshuar për herë të dytë? Padyshim që jo. Në këto vargje, Pali pyet se përse do të kthehesim mbrapa te mëkati që na turpëroi dhe që na çoi në vdekje. Atyre që janë në Krishtin u është ofruar një fryt shumë më i mirë.

SHTJELLOJMË:

Pasi kemi përjetuar pasojat e dhimbshme të mëkatit, përfshirë fajin dhe turpin, përse ndonjëherë kthehemi te i njëjti mëkat?

DITA 6

LEXO: 1 E GJONIT 1:8-10

Mëkatet tona tashmë janë falur, për shkak të vdekjes së Jezusit në kryq. Njerëzit që mendojnë se janë të pastër, nuk u duket se kanë nevojë për dush. Kur ne kuptojmë fajin dhe turpin e mëkatit tonë ashtu si Adami dhe Eva, ne fillojmë të kuptojmë se kemi nevojë për falje.

SHTJELLOJMË:

A ia ke rrëfyer ndonjëherë mëkatet e tua Perëndisë? Apo dikujt tjetër? Si ndiheshe para? Po pas?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Rregullat bazë

Në shumicën e grupeve ka tre ose katër gjëra që zakonisht e devijojnë një diskutim. Ndoshta grupit tënd i pëlqen të nisë duke folur për përjashtimet ose e nisin diskutimin duke folur për gjëra që nuk ekzistojnë (p.sh., njëbrirëshit lela ose balena që ngasin autobusin e shkollës). Këto gjëra mund të marrin shumë nga koha e diskutimit. Bëj një marrëveshje me grupin që gjatë kohës së diskutimit nuk duhet t'i bëni këto gjëra. Vër disa rregulla bazë me të cilat të gjithë bien dakord që diskutimi të jetë i frytshëm dhe jo qesharak. Pastaj, kur të shohësh që njëri nga studentët po i rikthehet bisedave qesharake, kujtoji rregullat e vendosura.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 2.5

RRËNOJAT

VDEKJE, VUAJTJE DHE DHIMBJE

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ROMAKËVE 5:12-14

VARGU KYÇ:

Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan.

Romakëve 5:12

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

SHUMICA PREJ NESH KA PËRJETUAR NJË AKSIDENT ME MAKINË. Shumë kanë parë aksidente të ndodhin ndërsa kanë qenë në rrugë. Të gjithë kemi ngecur në trafik duke iu afruar shumë ngadalë skenës. Ngadalësojmë dhe kalojmë pranë rrënojave. Shohim lëngje që rrjedhin dhe derdhen. Shohim xhama të thyer, plastika dhe hekura të shtrembëruar. Kemi parë njerëz me fasha në plagë apo njerëz që i merr ambulanca. Mund të kemi parë edhe thasët e zinj në këto skena. Përjetime të tilla bëjnë që të ngadalësojmë, ndalojmë dhe të shqyrtojmë gjithçka. Ky mësim na paraqet rrënojat që shkaktuan Adami dhe Eva. Mëkati i tyre solli kaq shumë shkatërrim dhe e gjithë kjo thyerje është tejçuar te të gjithë ne. Vdekja hyri në botë. Marrëdhënia e thyer mes Perëndisë dhe njeriut pati ndikim të ndjeshëm në disa aspekte kyç të jetës. Për herë të parë, njeriu pati frikë. Njeriu luftoi me përgjegjësinë personale dhe ndershmërinë, teksa Perëndia u përball me ne. Martesat, miqësitë dhe marrëdhëniet familjare tani kanë probleme sepse mëkati ndau familjet dhe marrëdhëniet midis njerëzve. Dhimbja hyri në botën tonë. Puna që ne bëjmë do të jetë e vështirë dhe e rëndë. Pastaj çmimi që duhet të paguajë secili është vdekja. Vdekja, edhe ajo fizike edhe ajo shpirtërore, u bënë realitet. Mëkati shkatërroi gjithçka. Le të ngadalësojmë për të parë se çfarë ndodhi.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se mëkati transformoi të gjitha marrëdhëniet (me veten, të tjerët dhe me Perëndinë).
- Studentët do të dinë se mëkati solli dhimbje në botë.
- Studentët do të dinë se mëkati bëri që puna të ishte e mundimshme.
- Studentët do të dinë se mëkati shkakton vdekje fizike dhe shpirtërore.

FJALË KYÇ: : Rrënoja: mbetje apo copëza të diçkaje që është thyer

MENDIMI KYÇ: Mëkati shkaktoi shumë rrënoja për gjithë njerëzimin.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Hidh rrathët (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 103, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Operacioni i bananeve (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 15, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Shitje të zhurmshme. Shumë njerëz në kishën tënde ndryshojnë dhe përmirësojë sende dhe objekte në shtëpi çdo vit. Ti dhe studentët e tu mund të organizoni një shitje të zhurmshme (ose shitje në kopsht) ku njerëzit e kishës mund të dhurojnë sende për t'u shitur. Përdorini paratë si fond për një udhëtim misioni ose dhurojini në një organizatë që ndihmon njerëzit në nevojë të komunitetit. Ky është një projekt shumë i mirë që përfshin të gjithë kishën me mosha të ndryshme.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentëve duhet të bënin një listë të gjërave që Adami dhe Eva humbën në atë ditë fatkeqe në kopsht. Filloje mësimin duke ndarë listën tënde ose duke pyetur studentët. Pyeti se çfarë kanë shënuar në listën e tyre. Një ide e mirë mund të jetë t'u kërkosh studentëve të rilexojnë listën me pesë krijimet e preferuara te Zanafilla 1 nga mësimi 1.3 dhe pyeti se sa prej atyre krijimeve janë ndikuar nga mëkati.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan.

Romakëve 5:12

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:12-21, ROMAKËVE 5: 12-14

MËKATI SHKATËRROI TË GJITHA MARRËDHËNIET.

Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e vet, dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve.

Isaia 53:6

MËKATI SOLLI DHIMBJE DHE VDEKJE.

Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan.

Romakëve 5:12

MËKATI INFEKTOI GJITHÇKA DHE KËDO.

Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.

Romakëve 3:23

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Efektet e mëkatit janë tronditëse. Gjithçka ndryshoi për Adamin dhe Evën. Jetojmë në një botë ku marrëdhëniet e thyera janë të zakonshme. Mund të kesh probleme me marrëdhëniet brenda shtëpisë apo ndoshta ke probleme me miqësitë. E ke pyetur veten përse këto marrëdhënie janë ndonjëherë të vështira? Mëkati, si një virus, është shpërndarë në secilin prej këtyre aspekteve të jetës. Shkaktoi dëme, shkatërrim dhe solli dhimbje e vdekje në botë. A e sheh këtë rrënim në jetën tënde? A e sheh dëmin që mëkati i shkakton marrëdhënieve të tua? A e sheh nevojën tënde për Jezusin? Lexo pjesën e mëposhtme. Mund ta ktheni në këngë ose thjesht kërkoju studentëve të mendojnë rreth fjalëve. Rrënoja e mëkatit tonë ndryshoi gjithçka. Ne qëndrojmë të pafuqishëm në mes të rrënojës.

Rrënoja

Zot, jam i rrënuar. Ja bëra vetes.
Natyra ime vendosi të vepronte sipas dëshirës së vet.
Zemra ime tha se nuk kishte nevojë për ty.
Jeta ime mbeti bosh pa Ty.
Prandaj, ja ku jam Zot, qëndroj midis rrënojave.
Shoh dhimbjen, vdekjen dhe
problemet që nuk mund t'i zgjidh.
Shoh drejt teje Zot, që t'i ndreqësh këto rrënoja.
Do të vdes këtu. Kjo nuk mund të jetë jeta e vërtetë.

FJALË KYÇ:

Rrënoja: mbetje apo copëza të diçkaje që është thyer

A mund të më nxjerrësh?
A mund të restaurosh gjithçka?
Pastaj shoh Birin Tënd.
Ai erdhi për të ndrequr gjithçka.
Ai erdhi për të ndrequr marrëdhëniet.
Ai erdhi për të fituar mbi mëkatin dhe vdekjen.
Ai erdhi si kundërhelmi kundër
këtij infektimi prej mëkatit.

Ndaj, ja ku jam Zot; unë nuk mund të bëj asgjë.
Qëndroj midis rrënojave duke të kërkuar ty.
Më merr në krahët e tu. Më mbaj,
Derisa të jetë si më parë.
A mund të kthehemi në kopsht Zot?
A mund ta rikthesh gjithçka në gjendjen e
mëparshme?

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.5 mësuam se mëkati shkaktoi rrënoja të mëdha për njerëzimin.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 3:12-13

A je i mirë në lojën e fajësimit? Shumica prej nesh janë ekspertë. Mëkati na bëri frikacakë: "Perëndi, është faji i asaj gruas që krijove. Po të mos ishte për Ty dhe për atë, unë nuk do të kisha mëkatuar kurrë." Të përballesh me mëkatin do të thotë të marrim përgjegjësi për pjesën tonë të fajit.

SHTJELLOJMË:

A shqetësohesh ti kur të tjerët shmangin përgjegjësinë për mëkatin e tyre? Përse po ose jo? A shqetësohesh kur e bën edhe ti këtë gjë?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 3:14-15

Mallkimi i Perëndisë për gjarprin vjen në dy pjesë. Gjarpërinjtë do të zvarriteshin gjithmonë dhe do të hanin pluhurin e tokës. Gjarpri, satani, do të fillonte një betejë historike me gruan (njerëzimin) dhe me farën e gruas (në fund Krishti). Satani goditi një herë, por iu kthye shumë më keq.

SHTJELLOJMË:

A është djalli vërtet armiku yt? Çfarë do ai për ty? Si ndryshon nga ajo që Perëndia do për ty?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 3:16-18

Mallkimi i Adamit dhe Evës, dhe gjithë pasardhësve të tyre ishte dhimbje dhe mundim i madh. Për Evën ishte vështirësia në marrëdhënie dhe dhimbje në mbajtjen e fëmijëve. Për Adamin ishte detyra e përhershme e marrjes së ushqimit nga toka. Përgjithësisht puna e Adamit dhe Evës ndryshoi nga pjesëmarrja me gëzim në planin e Perëndisë në një zvarritje të gjatë dhe të lodhshme.

SHTJELLOJMË:

A e ke parë këtë mallkim në jetët e burrave dhe grave që njeh?

DITA 6

READ:GENESIS 3:19-21

Deklarata e fundit e Perëndisë ishte që Adami dhe Eva, dhe të gjithë pas tyre, do të vdisnin dhe dhe trupat do të dekompozoheshin përsëri në pluhur. Pa mëkat nuk do të kishte asnjë vdekje. Kurrë. Për shkak të mëkatit, vdekje. Mëkati sjell gjithmonë vdekje. Gjithmonë (Jakobi 1:14-15).

SHTJELLOJMË:

A ke dëgjuar ndonjëherë dikë që e ka përshkruar vdekjen si pjesë të natyrshme e jetës? A ka kuptim kjo gjë pasi lexove këtë pasazh? Shpjegoje.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Gati për të folur?

Ndonjëherë, pavarësisht sa përgatitesh dhe mendon se je për një diskutim, gjërat nuk shkojnë mirë. Edhe pse dëshiron të ruash kohën e diskutimin, nëse studentët nuk janë gati nuk mund t'i detyrosh të bëjnë diskutime të thella. Nëse ke një grup të rrëmujshëm, dil jashtë dhe bëj disa lojëra me top. Digjni ca energji. Ndonjëherë do të duhet ta shtysh një diskutim grupi në mënyrë që studentët të mund të kuptojnë më mirë informacionin. Mëso si t'i kuptosh studentët e tu. Një drejtues i mirë diskutimesh i njeh studentët e vet dhe duhet ta kuptojë kur duhet bërë një diskutim dhe kur duhet shtyrë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit



PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 3:13-24

VARGU KYÇ:

Ishit në atë kohë pa Krishtin, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë.

Efesianëve 2:12

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

A TË KANË DËBUAR NDONJËHERË NGA NDONJË VEND? Ndoshta kur ke qenë i vogël ke hyrë në pronën e dikujt, pa leje, dhe të kanë kërkuar të largohesh? Ose ndoshta ke qenë fëmijë vërtet i prapë dhe të kanë përjashtuar nga shkolla. Të kërkohet të largohesh dhe nuk mund të kthehesh më. Këtë po përjetojnë edhe Adami me Evën. Një nga pasojat e mëkatit të tyre ishte dëbimi nga kopshti. Ky kopsht përfaqëson vendin ku ndodhet prezenca e Perëndisë. Ai ishte i pranishëm në kopsht me Adamin dhe Evën. Perëndia nuk e toleron mëkatin në praninë e Tij. Perëndia e urren mëkatin. Prandaj, mëkati duhet hequr dhe për shkak të mëkatit të Adamit dhe Evës, u krijua një ndarje mes Perëndisë dhe njeriut. Dëbimi i tyre nga kopshti ishte gjithashtu ndarja e tyre fizike nga Ai. Perëndia vazhdoi të ndërvepronte me njeriun, por sipas kushteve të Tij. Njeriu nuk kishte të drejtën e një marrëdhënie me Të siç e kishte në kopsht. Imagjino sa e tmerrshme ishte ajo ditë. Imagjino bukurinë e kopshtit. Imagjino si ishte të jetoje mes përsosmërisë. Perëndia vetë ishte ATJE! Dhe tani, ata do dëboheshin prej andej dhe që nga ajo ditë qëndrimi me Të do të ishte vetëm kujtim. Mëkati është një problem serioz. Perëndia e merr shumë seriozisht mëkatin. E lexojmë këtë histori dhe mendojmë: "Hë se nuk është edhe aq keq." Megjithatë, e vërteta është se ishte shumë keq. Perëndia kishte çdo të drejtë t'i hiqte nga kopshti. Perëndia ka çdo të drejtë të heqë mëkatin nga prania e Tij dhe Ai dëshiron që mëkati të hiqet edhe nga ne.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Adami dhe Eva u dëbuan nga kopshti për shkak të mëkatit të tyre.
- Studentët do të dinë se kopshti ishte vendi ku gjendej prania e Perëndisë dhe mëkati nuk mund të qëndrojë në prani të Perëndisë.
- Studentët do të dinë se mëkati na ndan nga Perëndia.

FJALË KYÇ: Ndarje: një vend, vijë apo pikë ndarje

MENDIMI KYÇ: Mëkati shkakton ndarje nga Perëndia.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Zjarrfikës (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 41, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Kujdestari (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 24, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Përjashtuar. Njerëzit e pastrehë janë një problem i çdo komuniteti. Mund të themi se Adami dhe Eva ishin të pastrehët e parë në histori. Rehatia, ngrohtësia dhe mikpritja nuk ishin më. Ata duhet të mbulonin lakuriqësinë dhe turpin e tyre. Perëndia krijoi projektin e parë ndihmues. Ai bëri veshje/mbulesa për ta. Çdo natë ka të pastrehë që mbushin rrugët, që jetojnë nën ura ose flenë në kuti kartoni. Nën mbikëqyrjen e një drejtuesi, kërkoji studentëve të mbledhin pallto të ngrohta dhe t'i shpërndajnë para se të vijë dimri. Mbushni një fugon dhe shkoni nëpër qytet, në vendet që e dinin se ka të pastrehë dhe shpërndani palltot. Mund të jepni edhe më shumë se vetëm pallto. Mund të jepni ushqim ose pije. Këta njerëz janë përzënë nga shtëpitë e tyre për një arsye. Jepu ngrohtësinë dhe dashurinë e Krishtit përmes një gjëje kaq të thjeshtë si palltot që do t'i mbajnë ngrohtë apo një vakt për t'u ngopur, një veprim mirëdashje për t'ju kujtuar se Jezusi i do akoma.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDEAS —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të krijonin diçka që jep idenë e ndarjes. Luaj një lojë ose kërkoji studentëve të ndajnë krijimet e tyre për të filluar mësimin me grupin e madh.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Ishit në atë kohë pa Krishtin, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë.

Efesianëve 2:12

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 3:13-4:1

MËKATI DËBOI ADAMIN DHE EVËN NGA KOPSHTI.

Prandaj Zoti Perëndi e dëboi njeriun nga kopshti i Edenit, me qëllim, që të punonte tokën nga e cila kishte dalë.

Zanafilla 3:23

MËKATI NUK MUND TË QËNDROJË NË PRANI TË PERËNDISË.

Ti i ke sytë tepër të pastër për të parë të keqen dhe nuk e shikon dot paudhësinë. Pse rri dhe shikon ata që veprojnë me hile, dhe hesht kur i ligu gllabëron atë që është më i drejtë se ai.

Habakkuku 1:13

MËKATI NA NDAN NGA PERËNDIA.

Por paudhësitë tuaja kanë shkaktuar një ndarje midis jush dhe Perëndisë tuaj, dhe mëkatet tuaja kanë bërë të fshihet fytyra e tij prej jush, që të mos ju dëgjojë më.

Isaia 59:2

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Perëndia dëshiron që ne të jemi të pastër dhe të shenjtë. Ai do që marrëdhënia jonë me Të, të jetë siç ishte në kopsht; e përsosur. Bëj aktivitetin e mëposhtëm për t'i treguar studentëve sa i vështirë është mëkati dhe përse duhet hequr.

Lista e mjeteve: një gotë uji transparente e mbushur me ujë, ngjyrues i zi ushqimi.

Mblidhi studentët rreth gotës së mbushur me ujë. Thuaji se kjo gotë përfaqëson jetën tonë para rënies së njeriut. Pastaj hidh një ose dy pika nga ngjyruesi i ushqimit në gotë. Lëri studentët të shohin si boja shpërndahet në ujë. Nga ana vizuale, duket fantastike. Ndërsa ngjyruesi shpërndahet, në pak kohë mbulon gjithë gotën. Tani kërkoju studentëve ta ndajnë ngjyruesin nga uji. Askush nuk është në gjendje ta bëjë. Pyeti studentët nëse ndonjëri prej tyre do ta pinte këtë ujë të zi. Me shumë mundësi, askush. Do të përjashtohej nga grupi. Do të nxirrej jashtë. Uji nuk është më i pastër. Nuk mund të pihet më. Ja çfarë i bën mëkati jetës sonë. Njollos ngadalë siç ndodhi me bojën e zezë derisa të ketë mbuluar çdo cep. Perëndia nuk e do mëkatin në praninë e Tij po aq sa ne nuk duam të pimë ujin e zi.

FJALË KYÇ:

Ndarje: një vend, vijë apo pikë ndarjeje

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.6 mësuam se mëkati shkaktoi ndarjen nga Perëndia.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 3:22

Plani i Perëndisë për njerëzimin nuk e lejonte kurrë që ne të jetonim përjetësisht në mëkat. Ashtu si Adami, ne e njohim të keqen, mëkatin, duke marrë pjesë në të. Plani i Perëndisë ishte të bënte të mundur shlyerjen dhe heqjen e mëkatit para se të na lejonte të jetonim në përjetësi (Efesianëve 1:3-10).

SHTJELLOJMË:

Përse ishte një vepër mëshire e Perëndisë largimi i Adamit dhe Evës nga kopshti? Si do të ndiheshe nëse do të ishe i ndarë nga Perëndia, por do të ishe i detyruar të jetoje përgjithmonë në mëkat?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 3:23-24

Siç e kemi thënë, Bibla nuk e paraqet historinë e kopshtit të Edenit si një metaforë apo analogji. Bibla e thotë qartë se kopshti ishte një vend i vërtetë, në një kohë të vërtetë, me engjëj të vërtetë që ruanin hyrjen e tij. Ne besojmë se ndarja që Adami dhe Eva përjetuan për shkak të mëkatit është ngjarje historike, jo diçka e trilluar, siç janë fabulat ose mitet.

SHTJELLOJMË:

Ndërsa ka vende në botë që nuk i ke parë, a të ndihmon të diturit se Edeni është një vend i vërtetë për të besuar se Shkrimi është i vërtetë? Pse ndodh kjo?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 4:1

Eva i jep merita Perëndisë që e ndihmoi në lindjen e saj të vështirë. Ajo i jep meritat Atij për mrekullinë e jetës. Adami dhe Eva u ndanë shpirtërisht dhe fizikisht nga Perëndia, megjithëse ata e kuptonin se Perëndia ende siguron për njerëzit edhe në jetët tona shqetësuese. Ai ende na do dhe na jep dhurata të mira secilit prej nesh (Jakobi 1:17).

SHTJELLOJMË:

Cilat janë disa nga dhuratat e mira që Perëndia u ka dhënë të gjithë njerëzve mëkatarë në tokë? Cilat janë disa nga dhuratat e mira që Perëndia siguron për ty?

DITA 6

LEXO: ROMAKËVE 8:22-25

Njerëzimi nuk është i vetmi që ndjen dhimbjen e ndarjes sonë nga Perëndia. Edhe pjesa tjetër e krijimit bërë prej Tij lëngon gjithashtu për largimin nga Perëndia dhe ndjen peshën e mëkatit, por ne jemi shpëtuar prej shpresës. Për ata që janë në Krishtin, Fryma sjell paqe, kënaqësi dhe gëzim tani, por lëngimi nuk do të ndalojë derisa të shohim Atin përballë.

SHTJELLOJMË:

Cilat janë disa nga gjërat që tregojnë se i gjithë krijimi përjeton dhimbjen e mëkatit tonë? Nëse dhimbja dhe shqetësimi është realiteti ynë i tanishëm, cilat janë premtimet e gjërave për të cilat shpresojnë ata që janë në Krishtin?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Rreth i plotë

Pa ndihmën e një drejtuesi, diskutimet janë vetëm biseda pa mbarim ku secili mbron mendimin e vet. Duhet diçka që e mban bisedën në lëvizje ose e mbyll kur është e nevojshme. Puno që biseda me studentët të jetë rreth i plotë. Ata janë ekspert në ndryshimin e drejtimit të bisedës kështu që ti duhet t'i rikthesh te pika kryesore. Mos ki frikë ta përmbyllësh bisedën ose t'i ridrejtosh studentët te pika kryesore. Kjo do t'u tregojë atyre se të intereson diskutimi dhe kujdesesh për të.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje—**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 2.7

PERDHJA E GJAKUT

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
HEBRENJVE 9:11-28

VARGU KYÇ:

Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

Hebrenjve 9:22

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

NË MËSIMET E KALUARA, HISTORIA NUK KA PASUR SHUMË LAJME TË MIRA. Adami dhe Eva donin të ishin si Perëndia dhe zgjodhën të mëkatonin. Ata u fshehën nga Perëndia dhe shkuan larg Tij, në vend që të shkonin drejt Tij. Mëkati i tyre shkaktoi shumë rrënoja duke sjellë dhimbje e vdekje në botë. Pastaj u dëbuan nga kopshti. A ka diçka që mund ta rregullojë këtë? A ka diçka që mund të sigurojë falje për shkeljen e mëkatit? Fjala e Perëndisë na thotë se gjaku mund ta bëjë këtë. Te Hebrenjve 9:22 thuhet: "*...dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë*". Fjala 'shlyerje', shpesh e përkthyer 'falje', do të thotë " të të hiqet një borxh, shkelje apo detyrim". Pra, pa derdhjen e gjakut nuk mund të çlirohemi nga shkelja e mëkatit tonë, kërkohet gjak. Perëndia, në kopsht, nisi sistemin e sakrificës. Ai mori një kafshë dhe e vrau për të bërë mbulesa për Adamin dhe Evën. Përveç këtij momenti, ka edhe raste të tjera në Shkrim ku kërkohet gjaku për shlyerjen e mëkatit. Gjatë pashkës së parë, gjaku duhej vënë në shtalkat e dyerve që vdekja të kalonte tutje pa hyrë brenda. Jezu Krishti vdiq në kryq dhe derdhi gjakun e Tij të përsosur si shpagim për mëkatet tona. Kështu, marrim shlyerjen për mëkatet tona sepse gjaku i Tij u derdh mbi ne.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se kemi nevojë që diçka të na largojë nga rrëmuja e mëkatit.
- Studentët do të dinë se Perëndia vrau një kafshë për të bërë mbulesa për Adamin dhe Evën.
- Studentët do të dinë se nuk mund të ketë falje të mëkat-eve pa derdhjen e gjakut.

FJALË KYÇ: Shlyerje: çlirimi nga një borxh, ndëshkim apo detyrim

MENDIMI KYÇ: Që të falen mëkatet, duhet të derdhet gjak.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Betejë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 17, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Foto Op (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 69, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Dhurimi i gjakut. Gjaku është jetësor për vazhdimin e jetës. Shpesh, në komunitetin tonë nuk ka mjaftueshëm gjak për doktorët apo punonjësit e ndihmës së parë. Kontakto me Kryqin e Kuq apo një spital të afërt dhe kërkoji kishës të dhurojë gjak për komunitetin. Studentët vendosi si vullnetarë. Ata mund të ndihmojnë me pritjen e dhuruesve, dhënien e lëngjeve pas dhurimit të gjakut, ose të ndihmojnë me pastrimin para dhe pas. Gjithashtu kërkoji një përfaqësuesi të Kryqit të Kuq të shpjegojë sa i rëndësishëm është gjaku dhe se si ndihma e tyre si vullnetarë do të ketë shumë ndikim në komunitet.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të bënin një listë me gjërat që njerëzit e tjerë bëjnë për ta dhe cilët janë ata njerëz. Pastaj studentët duhet të mendonin për mamanë ose dikë tjetër që kujdeset më shpesh për ta. Sa gjëra bëjnë të tjerët për këtë person që duket se kujdeset për të gjithë? Ndajini në grup. Zgjerojini listat që të përfshijnë edhe ata njerëz në familjen e kishës që duket se u shërbejnë shumë të tjerëve, por nuk marrin shumë shërbim në këmbim.

PLANIFIKOJE TI — MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

Hebrenjve 9:22

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: HEBRENJVE 9: 11-28

MËKATI KËRKON SAKRIFICË.

Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.

Romakëve 6:23

PERËNDIA SAKRIFIKOI PËR NE.

Pastaj Zoti Perëndi i bëri Adamit dhe gruas së tij tunika prej lëkure dhe i veshi.

Zanafilla 3:21

FALJA KËRKON NJË SAKRIFICË GJAKU.

Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

Hebrenjve 9:22

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Imagjino sikur dikush të rrëmbente një prej të afërmve të tu të preferuar. Nga çfarë do të hiqje dorë për ta kthyer? Bëj një listë të gjërave që do të jepje (hiqje dorë).

Shembuj: telefoni, bicikleta, instrumenti etj.

A do të jepje një të afërm tjetër apo dikë që e do vërtet?

Me shumë mundësi, shumica do të thotë jo. Megjithatë kur bëhej fjalë për ne, Perëndia sakrifikoi Birin e Tij të vetëm. Ai e dërgoi Birin e Tij të vetëm si sakrifica për mëkatet tona. Ai nuk dërgoi diçka tjetër. Sakrifica është diçka që ne jo gjithmonë e kuptojmë plotësisht. Kur bëhet fjalë për dashurinë që Perëndia ka për ne, Ai dha më të mirën e Tij për të na çliruar nga detyrimi i mëkatit tonë. Ai nuk hoqi dorë nga diçka e parëndësishme për ne. Ai dha gjithçka!

FJALË KYÇ:

Shlyerje: çlirimi nga një borxh, ndëshkim apo detyrim

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 2.7 mësuam se për t'u shlyer mëkatet duhet derdhur gjak.

DITA 3

LEXO: HEBRENJVE 9:23

Nën ligjin e Besëlidhjes së Vjetër gjithçka që përfshihej në sakrificën për mëkat duhej pastruar me gjak. Kjo do të thotë se të gjitha tendat, vazot, njerëzit etj., duhej të 'pastroheshin' përmes spërkatjes me gjakun e besëlidhjes së Perëndisë me Izraelin. Gjithçka ishte infektuar sepse kishte qenë në kontakt me njerëz mëkatarë.

SHTJELLOJMË:

A mund të imagjinosh sa shumë gjak kafshësh do të kishe parë të derdhej po të kishte qenë izraelit? A mendon se kjo gjë do të të bënte të ndiheshe më i pastër shpirtërisht, duke ditur se gjaku u derdh për mëkatet e tua? Shpjegoje.

DITA 4

LEXO: HEBRENJVE 9:24-25

Krishti ishte edhe prifti, edhe sakrifica. Nën Ligjin e Besëlidhjes së Vjetër, kryeprifti hynte në vendin shumë të shenjtë të tempullit një herë në vit për të ofruar gjakun e kafshëve si sakrificë për mëkatin e Izraelit. Gjithsesi kjo nuk ishte zgjidhje e përhershme. Jezusi hyri në prezencën e Perëndisë për ne, duke dhënë vetë jetën e Tij si zëvendësim, duke paguar atë që ne i detyroheshin me gjakun e Tij. Jezusi doli para Perëndisë si sakrifica e përhershme.

SHTJELLOJMË:

A e ke menduar çfarë do të kishte ndodhur nëse Jezusi nuk do të kishte zënë vendin tënd? Përse je mirënjohës për sakrificën që Ai bëri për ty?

DITA 5

LEXO: HEBRENJVE 9:26

Nëse Jezusit do t'i duhej të vdiste vazhdimisht për çdo mëkat, ose nëse do t'i duhej të vdiste çdo vit për të gjitha mëkatet e kryera atë vit atëherë vuajtja dhe vdekja e Tij nuk do të kishin fund. Bibla është e qartë: Një herë mjaftoi për të gjitha. Gjaku i pafaj i Jezusit e largoi mëkatin përgjithmonë për ata që besojnë në Të.

SHTJELLOJMË:

A mëkaton akoma ti? Si ndikon në jetën tënde të krishterë të diturit se je falur për çdo herë që ke mëkatuar përmes gjakut të Krishtit?

DITA 6

LEXO: HEBRENJVE 9:27-28

YOLO (vetëm një jetë kemi) nuk është thjesht një filozofi e keqe për jetën siç thonë shumë njerëz, por është edhe e gabuar. Ti nuk jeton vetëm një herë. Në një farë mënyre, jeton dy herë. Megjithatë, siç thotë edhe ky varg, ti vdes vetëm një herë. Pas vdekjes tënde vjen gjykimi yt i përjetshëm. Kur Krishti të rikthehet, Ai do të vijë për të mbledhur të gjithë ata që e presin dhe atëherë Ai do të drejtësojë gjithçka.

SHTJELLOJMË:

Duke qenë se gjykimi i Perëndisë vjen pas vdekjes sonë, sa e rëndësishme është që të mbulohemi nga gjaku i Jezusit për mëkatet tona? Çfarë do të ndodhte në ditën e gjykimit, nëse nuk do të ishim të mbuluar nga gjaku i Tij?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

A je dakord?

Nëse ke një grup të qetë, pyeti studentët nëse janë dakord me atë që thonë të tjerët në grup. Pastaj pyeti pse bien dakord me ta. Ndonjëherë studentët rrinë në qetësi, por shumë rrallë të gjithë janë në një mendje në lidhje me një temë specifike. Inkurajoji studentët të ndihen të lirshëm nëse duan të diskutojnë dhe sfidojnë njëri-tjetrin, duke qenë respektues ndaj njëri-tjetrit, gjithashtu duke i pyetur studentët nëse janë dakord për të dhënë mundësinë të përfshish në bisedë studentë që zakonisht nuk e ngrenë dorën dhe nuk marrin pjesë në bisedë. Ndonjëherë bisedat më të mira janë ato që përfshijnë shumë këndvështrime.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Kapitulli Dy: Përsëritje//Rënia

PJESËT KRYESORE TË SHKRIMIT: ZANAFILLA 3:1; ZANAFILLA 3:1-5; ZANAFILLA 3:4-7; ZANAFILLA 3:8-11; ROMAKËVE 5:12-14; ZANAFILLA 3:13-24; HEBRENJVE 9:11-28

VARGJET KYÇ:

1 e Pjetrit 5: 8; 1 e Korintasve 10:13; Zanafilla 3: 4 – 5; Hebrenjve 4:13; Romakëve 5:12; Efesianëve 2:12; Hebrenjve 9:22

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

GJITHÇKA KA SHKUAR KEQ! Në kapitullin e parë kaluam shtatë javë duke folur për fuqinë, mrekullinë dhe madhështinë e Perëndisë përmes veprës së Tij të krijimit. Ai bëri gjithçka dhe e bëri shumë mirë. Ishte e përsosur. Pastaj çdo gjë u shkatërrua. Nga maja e malit përjetuam errësirën e luginës. Zbuluam se njerëzimi ishte shënjestruar që nga fillimi dhe satani, kundërshtari ynë, po thurte planin e tij për ta rrëzuar. Satani e tundoi Evën duke i ofruar gjithë mirësinë e Perëndisë, por në një jetë të pavarur nga Ai. Pastaj Adami dhe Eva zgjodhën të ishin zot të vetes dhe morën vendimet e tyre. Ata hëngrën nga pema e ndaluar dhe sytë e tyre u hapën. Ata panë turpin e tyre dhe qëndruan lakuriq para botës. Perëndia i kërkoi ndërsa ata fshiheshin nga Ai. Pastaj panë pasojat e mëkatit të tyre. Vdekja dhe dhimbja hynë në botë. Marrëdhëniet u dobësuan, u thyen dhe u mbuluan me njollën e egoizmit. Frika filloi të infektonte gjithçka. Pastaj, si të mos ishte mjaftueshëm keq, Adami dhe Eva u dëbuan nga kopshti. Mëkati nuk mund të qëndrojë në praninë e Perëndisë. Ata nuk mund të riktheheshin kurrë më në gjendjen e mëparshme. Duhet të kishte ndonjë mënyrë për t'i rikthyer gjërat siç ishin. Perëndia hapi një rrugë. Përmes derdhjes së gjakut mund të ketë falje për mëkatet.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të përsërisin shtatë mësimet e fundit.
- Studentët do të përsërisin vargjet, mendimet dhe fjalët kyç të shtatë mësimeve të fundit.
- Studentët do të përmbledhin shtatë mësimet e fundit në një përmbledhje të vetme.

FJALËT KYÇ: Kundërshtar, tundim, mëkat, turp, rrënoja, ndarje, shlyerje

MENDIMET KYÇ: (Shih çdo mësim)

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJRA (NDËRVEPRIM)

Gjatë shtatë javëve të fundit studentët kanë pasur lojëra të ndryshme. Shiko seksionin 'Vlerësoje' dhe kërko një lojë, të cilën studentët e kanë shijuar shumë dhe luajeni sërish. Nëse njëri nga projektet e shërbesës ka pasur më shumë ndikim, merrni pak kohë për të ndarë për të. Kërkoju studentëve të ndajnë një dëshmi se si ndikoi te ta kjo eksperiencë.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët e tu kanë mësuar shumë për rënien e njeriut. Ata kanë mësuar disa fjalë kyç dhe disa vargje të njohur apo të rinj. Kërkoju studentëve ta fillojnë këtë përsëritje duke treguar se si i ka prekur ky kapitull. Nëse grupi është i dhënë pas artit mund t'i përmblidhni shtatë mësimet në një dramë apo skeç ku tregoni përmbledhjen e të shtatë mësimeve.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

MËSIMI 2.1

Vargu kyç: *Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vurbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë. (1 e Pjetrit 5:8)*

Fjalë kyç: Kundërshtar: person, grup apo një forcë që kundërshton dhe sulmon

Mendimi kyç: Në mësimin 2.1 mësuam se satani është kundërshtari i njerëzimit.

MËSIMI 2.2

Vargu kyç: *Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni. (1 e Korintasve 10:13)*

Fjalë kyç: Tundim: një kohë/periudhë sprove

Mendimi kyç: Në mësimin 2.2 mësuam se të gjithë ne tundohemid.

MËSIMI 2.3

Vargu kyç: *Atëherë gjarpri i tha gruas: "Ju s'keni për të vdekur aspak; por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen" (Zanafilla 3:4-5)*

Fjalë kyç: Mëkati: dëshira jonë për të qenë Zot

Mendimi kyç: Në mësimin 2.3 mësuam se mëkati është dëshira jonë për të qenë Zot.

MËSIMI 2.4

Vargu kyç: *Dhe nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara para syve të Atij, të cilit ne do t'i japim llogari. (Hebrenjve 4:13)*

Fjalë kyç: Turp: ndjenja e tmerrshme që vjen pasi ke bërë diçka të pandershme

Mendimi kyç: Në mësimin 2.4 mësuam se Adami dhe Eva ndjenë turp dhe u fshehën nga Perëndia pasi mëkatuan.

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

MËSIMI 2.5

Vargu kyç: *Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan. (Romakëve 5:12)*

Fjalë kyç: Rrënoja: mbetje apo copëza të diçkaje që është thyer

Mendimi kyç: Në mësimin 2.5 mësuam se mëkati shkaktoi shumë rrënoja për gjithë njerëzimin.

MËSIMI 2.6

Vargu kyç *Ishit në atë kohë pa Krishtin, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë. (Efesianëve 2:12)*

Fjalë kyç: Ndarje: një vend, vijë apo pikë ndarjeje

Mendimi kyç: Në mësimin 2.6 mësuam se mëkati shkakton ndarje nga Perëndia.

MËSIMI 2.7

Vargu kyç: *Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë. (Hebrenjve 9:22)*

Fjalë kyç: Shlyerje: çlirimi nga një borxh, ndëshkim apo detyrim

Mendimi kyç: Në mësimin 2.7 mësuam se që të falen mëkatet duhet të derdhet gjak.

SHËNIME:

FILLONI:

- Cila gjë apo koncept të ka mbetur në mendje gjatë shtatë javëve të fundit?
- Përse është i rëndësishëm për ty ky koncept?

JAVA 1

LEXO: 1 E PJETRIT 5:8

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Përse është e rëndësishme të dimë se satani është kundërshtari?

JAVA 2

LEXO: 1 E KORINTASVE 10:13

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Pse është e rëndësishme të dimë se të gjithë kalojmë periudha sprovash?

JAVA 3

LEXO: ZANAFILLA 3: 4-5

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- A bie dakord dhe ti se mëkati është dëshira jonë për të qenë Perëndi? Nëse po, përse është ide e gabuar?

JAVA 4

LEXO: HEBRENJVE 4:13

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Përse u fshehën nga Perëndia Adami dhe Eva? A fshihesh ti nga Perëndia?

JAVA 5

LEXO: ROMAKËVE 5:12

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Si ndikon në jetën tënde dhe personave përreth teje rënia e njerëzimit?

JAVA 6

LEXO: EFESIANËVE 2:12

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Si e shkakton mëkati ndarjen nga Perëndia? A ndihesh i ndarë nga Ai?

JAVA 7

LEXO: HEBRENJVE 9:22

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Gjaku i kujt është bërë shlyerje për mëkatet e tua? Çfarë apo kujt po i beson?

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 3.1

NOEU

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 6-8

VARGU KYÇ:

"Ata erdhën te Noeu në arkë, dy nga dy, prej çdo mishi që ka frymë jete."

Zanafilla 7:15

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

PAS RËNIES, LIGËSIA E NJERIUT U PËRHAP SI NJË STUHI SHIU. Vdekja, dhimbja dhe thyerja e marrëdhënieve u bënë pjesë e thellë e jetës së njeriut. Ishim drejt një rruge vetëshkatërruese. Frika, errësira dhe ligësia rriteshin në fuqi. MEGJITHATË, Perëndia kishte një plan. Ai do të gjykonte botën dhe do të shfaroste këdo përveç Noeut dhe familjes së tij. Perëndia shkon te Noeu dhe i thotë se do të shkatërrojë tokën. Noeu dhe familja e tij ndërmarrin këtë thirrje kaq të madhe për të ndërtuar një objekt që do të mbante dy nga çdo lloj i kafshëve bashkë me Noeun dhe familjen e tij. Ky është një moment i rëndësishëm në historinë e Perëndisë. Perëndia do të shpëtojë një copëz të njerëzimit. Noeu dhe familja do të kursehen nga fatkeqësia që pritet të vijë. Për dekada të tëra, Noeu ndërton me besnikëri arkën. Pastaj vjen përmbytja, një përmbytje kaq shkatërruese saqë pas përfundimit të saj, Perëndia do të premtonte se nuk do ta shkatërronte kurrë më botën në atë mënyrë. Të gjithë hyjnë në arkë: kafshët, Noeu dhe familja e tij. Pastaj dera mbyllet. Dera e arkës ishte gjigande. Nuk mund të mbyllej përmes fuqisë njerëzore. Pasi hynë brenda, Perëndia mbylli derën e arkës. Në mënyrë simbolike, Perëndia ia mbylli derën njerëzimit në atë moment. Shpëtimi ishte brenda arkës. Dera ishte e hapur, por krenaria e mbajti njeriun jashtë sepse ishin të kënaqur me njohurinë e vet. Atë ditë, Perëndia e shpëtoi Noeun dhe familjen e tij. Që prej fillimit, Perëndisë i ka interesuar shpëtimi i njeriut. Dera është e hapur. Jezusi thotë: ...
"Unë jam udha, e vërteta dhe jeta. Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje." (Gjoni 14:6).

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia ishte i pakënaqur me ligësinë dhe natyrën mëkatare të njeriut.
- Studentët do të dinë se Perëndia kishte në plan të shpëtonte njerëzimin nga gjykimi që do të vinte përmes përmbytjes globale.
- Studentët do të dinë se Perëndia donte të shpëtonte një pjesë të njerëzimit dhe krijimit.

FJALË KYÇ: I shpëtuar: i ruajtur nga rreziku apo vdekja

MENDIMI KYÇ: Noeu ndërtoi një arkë, të projektuar nga Perëndia, si mënyra e vetme për të shpëtuar njerëzimin. Po ashtu, Jezusi është e vetmja mënyrë për t'u shpëtuar.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Për peshkim (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 45, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Porcupine (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 75, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Ujë, ujë kudo. Në varësi të vendndodhjes tuaj, kjo periudhë duhet të ketë shumë dëborë. Mblidhi studentët dhe ndihmoni në pastrimin e disa rrugëve në komunitetin tuaj. Nëse gjendeni në një pjesë më të ngrohtë të botës, atëherë shkoni për të larë dritaret e shtëpive në komunitetin tuaj. Sigurohu të mbikëqyrësh studentët ndërsa zhvilloni aktivitetin.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të vizatonin ose projektonin një objekt që do të shpëtonte njerëzimin nga një shkatërrim që pritet të vijë. Pra, në thelb, duhet të projektonin arkën e tyre. Nise mësimin duke i kërkuar studentëve të ndajnë projektet e tyre. Bëji pyetje rreth tyre. Ndaj edhe projektin tënd.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Ata erdhën te Noeu në arkë, dy nga dy, prej çdo mishi që ka frymë jete.

Zanafilla 7:15

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 6-8

PERËNDIA PA LIGËSINË E NJERËZIMIT.

Dhe tani Zoti pa që ligësia e njerëzve ishte e madhe mbi tokë dhe që tërë synimet e mendimeve të zemrës së tyre nuk ishin gjë tjetër veçse e keqja në çdo kohë. Dhe Zoti u pendua që kishte krijuar njeriun mbi tokë dhe u brengos për këtë në zemër të vet.

Zanafilla 6:5-6

PERËNDIA E GJYKOI LIGËSINË E NJERËZIMIT.

Dhe ja, unë vet kam për të sjellë përmbytjen e ujërave mbi tokë, për të shkatërruar nën qiellin çdo mish që ka shenjë jete; çdo gjë që ndodhet mbi tokën ka për të vdekur.

Zanafilla 6:7

Dhe ja, unë vetë kam për të sjellë përmbytjen e ujërave mbi tokë, për të shkatërruar nën qiell çdo mish që ka frymë jete; çdo gjë mbi tokë ka për të vdekur.

Zanafilla 6:17

PERËNDIA KURSEU NJERËZIMIN NGA SHKATËRRIMI I PLOTË.

Por unë do të caktoj besëlidhjen time me ty dhe ti do të futesh në arkën: ti, fëmijët e tu, gruaja jote dhe gratë e bijve të tu. Dhe nga çdo gjë që jeton prej çdo lloj mishi fut në arkë dy nga çdo lloj, për t'i ruajtur me vete gjallë bashkë me ty; dhe të jenë mashkull dhe femër. Nga zogjtë, nga bagëtia dhe të gjithë rrëshqanorët e tokës sipas llojit të tyre, dy nga çdo lloj do të vijnë te ti, që të ruhen gjallë. Dhe merr për vete nga çdo ushqim që hahet, grumbulloje dhe ruaje, në mënyrë që të shërbejë si ushqim për ty dhe për ata". Dhe Noeu veproi ashtu, bëri pikërisht të gjitha ato që Perëndia i kishte urdhëruar.

Zanafilla 6:18-22

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Perëndia e kurseu dhe e shpëtoi Noeun dhe familjen e tij nga kjo katastrofë e madhe. Nuk kishte përse ta bënte, por, *Noeu gjeti hir në sytë e Zotit... Noeu ishte njeri i drejtë... dhe ai eci me Perëndinë (Zanafilla 6: 8–9).*

Perëndia përdori një grup të vogël njerëzish për të ndryshuar botën. Të gjithë ne mund të gjejmë paraardhjen tonë (me shumë vështirësi) te një prej bijve të Noeut. Shiko sa i fuqishëm mund të jetë një grup njerëzish që ecin në besnikëri me Perëndinë. Perëndia shpëtoi një pjesë të vogël të botës përmes Noeut dhe familjes së tij. Çfarë mendon se mund të bëjë Ai me ty dhe miqtë e tu? A mendon se Perëndia mund të të përdorë për të ndryshuar familjen, shkollën dhe botën? Perëndisë i pëlqen të përdorë grupe të vogla për të ndryshuar botën. (P.sh., Noeu dhe familja e tij, Danieli dhe miqtë e tij, dishepujt, kishat e hershme.) Noeu iu përgjigj Perëndisë me besnikëri në bindje. Ai ishte i gatshëm dhe i mësueshëm para Perëndisë. Perëndia e përdori në mënyrë të fuqishme. Si mund të të përdorë ty Perëndia për lavdinë e Tij?

FJALË KYÇ:

I shpëtuar: I ruajtur nga rreziku apo vdekja

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.1 mësuam se Noeu ndërtoi një arkë, të projektuar nga Perëndia, si mënyra e vetme për të shpëtuar njerëzimin. Po ashtu, Jezusi është e vetmja mënyrë për të shpëtuar.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 6:5

Shkrimi thotë se ZOTI pa që ligësia e njerëzve mbi tokë ishte e madhe... Perëndia sheh gjithçka që ne bëjmë. Çdo veprim, fjalë apo mendim është i zbuluar para Tij. Perëndia nuk kapet në befasi nga asgjë që ne bëjmë (Psalmi 69:5).

SHTJELLOJMË:

A ke menduar ndonjëherë për faktin se Perëndia sheh gjithçka që ne bëjmë? Si ndikon në zgjedhjet e tua të përditshme njohja e faktit se Ai di gjithçka?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 6:6-7

Shpesh e mendojmë Perëndinë si dikë të ftohtë e të largët nga jeta jonë. E mendojmë si një burrë të vjetër të ulur mbi një mal, që nuk ka shumë ndjenja. Megjithatë, ky mendim është shumë larg së vërtetës. Vetë Perëndia i krijoi ndjenjat dhe emocionet. Nuk janë gjëra të lehta apo të thjeshta. Ndjenjat janë projektuar për të qenë mënyra si ne ndajmë dhe shprehim atë që ndodh brenda nesh. Edhe Perëndia ka ndjenja (Gjoni 3:16, Psalmi 11:5, Zanafilla 19:16, Isaia 62:5).

SHTJELLOJMË:

A të kujtohet ndonjë rast kur ke qenë vërtet i lënduar? Nëse po, si ndikoi te ti ajo gjë? A ka ndonjë gjë në jetën tënde që mund të ketë lënduar zemrën e Perëndisë? Shpjego.

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 6:8

Veprimet, mendimet, ndjenja etj... janë të gjitha të rëndësishme. Ato tregojnë thelbin e asaj që ne jemi. Noeu gjeti hir në sytë e Perëndisë. Gjithsesi kujto, Perëndia sheh shumë më tepër se çfarë ka nga jashtë. Ai sheh gjithashtu zemrën. Në një botë tërësisht të ligë ishte një njeri që e njihte Perëndinë dhe ecte me Të (Hebrenjve 11:7).

SHTJELLOJMË:

A do të të përshkruanin miqtë e tu si dikush që e njeh Perëndinë dhe e përjeton prezencën e Tij çdo ditë? A është besimi diçka me të cilën hasesh vetëm disa herë në javë? Si e di ti këtë?

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 6:15-18

Perëndia i dha Noeut udhëzime shumë specifike. Ai i dha Noeut plane specifike për ndërtimin e asaj arke. Pastaj Perëndia bëri një besëlidhje me Noeun. Një besëlidhje është një premtim i thellë midis dy ose më shumë njerëzve. Perëndia i bëri këto besëlidhje me njerëzit përgjatë gjithë historisë. Ai i tha Noeut dhe familjes së tij të hynin në arkë. Noeu e dinte se çfarë po afrohej. Ai i besoi Perëndisë dhe hyri në arkë.

SHTJELLOJMË:

A mendon se Perëndia është i besueshëm? Noeu bëri një hap besimi kur besoi në premtimet e Perëndisë, edhe kur besoi në besëlidhje, edhe kur ndërtoi arkën. A ka ndonjë hap besimi që ti mund të marrësh sot?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Ata janë si llastik

Si drejtues i një grupi diskutimi, je në pozitë shumë të mirë për të ndikuar në jetën e studentëve të tu. Mos ki frikë t'i sfidosh. Nëse një student jep një përgjigje, pyete: "Ku e mësove këtë?" Mos ki frikë t'i pyesësh: "Pse?". Vazhdo t'i ushtrosh në artikulimin e besimit të tyre përmes fjalëve. Është e lehtë të përsërisësh atë që dikush tjetër beson. Përpiqu t'i ndihmosh të ndihen të sigurt në fjalët që thonë. Megjithatë, ki kujdes të mos ushtrosh shumë presion, sepse si rezultat mund të dëmtosh shpirtin e tyre. Është njësoj si të tërheqësh një llastik. Mund ta bësh sepse prandaj është i tillë, por nuk mund ta tërheqësh shumë sepse mund të këputet.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 3.2

ABRAHAMI DHE ISAKU

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: ZANAFILLA 22

VARGJET KYÇ:

Atëherë Abrahami ngriti sytë dhe shikoi; dhe ja prapa tij një dash i zënë për brirësh në një kaçube. Kështu Abrahami shkoi, mori dashin e tij dhe e ofroi si sakrificë në vend të të birit. Dhe Abrahami e quajti këtë vend Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: "Do të furnizohet mali i Zotit."

Zanafilla 22:13-14

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

KY DUHET TË JETË NJË PREJ UDHËTIMEVE MË TË DHIMBSHME TË TË GJITHA KOHËRAVE. Kanë kaluar shumë vite që nga arka e Noeut. Popullsia mbi tokë është rritur dhe shumëfishuar. Perëndia e gjykoi botën përmes një përmbytje globale, por mëkati vazhdoi të qëndronte dhe të qelbëzohej mbi tokë. Në librin e Zanafillës ndodh një ndryshim. Historia fokusohej te bota si e tërë dhe tani Perëndia do të përqendrohet në një person të veçantë. Emri i tij është Abraham. Perëndia do t'i bëjë një premtim Abrahamit, Ai do ta bekojë. Perëndia do ta bëjë emrin e tij të madh. Ai do të nxjerrë një komb të madh prej Abrahamit dhe të gjitha familjet e tokës do të bekohen prej tij. Për Abrahamin është lajm i mrekullueshëm, por ka vetëm një problem. Ai është pak i vjetër. Abrahami ishte 75 vjeç kur ai dhe gruaja e tij, Sara, u larguan nga Harani dhe shkuan në një tokë që Perëndia do t'ua tregonte. Si mundet një 75 vjeçar të bëjë një komb të madh? Pastaj, 25 vite më vonë, Perëndia i tha Abrahamit se gruaja e tij, 90 vjeçare, do të kishte një djalë. Abrahamit iu duk kaq qesharake sa ra përtokë nga të qeshurat, por Perëndia kishte folur. Kështu Abrahami dhe Sara patën një djalë të quajtur Isak. Pastaj te Zanafilla 22, Perëndia do t'i kërkojë Abrahamit që të sakrifikojë birin e tij shumë vite pas lindjes së tij. Kjo ishte një provë për Abrahamin në të cilën shohim besnikërinë dhe besimin në marrëdhënien që Abrahami ka me Perëndinë. Ai ofron birin e tij të vetëm dhe Perëndia ndërhyn në të njëjtin vend ku më vonë do të ndërtohej tempulli. Perëndia siguron një sakrificë për Abrahamin.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia i kërkoi Abrahamit të ofronte birin e tij të vetëm, Isakun, si sakrificë për Perëndinë.
- Studentët do të dinë se Abrahami i bindet me besnikëri kërkesës së Perëndisë.
- Studentët do të dinë se Perëndia e ndalon Abrahamin dhe siguron sakrificën për të.

FJALË KYÇ: Sakrificë: humbja e diçkaje shumë të vlefshme për hir të diçkaje që konsiderohet të ketë më shumë vlerë

MENDIMI KYÇ: Perëndia siguroi sakrificën për Abrahamin në vend të birit të tij Isakut. Perëndia siguroi një sakrificë për njerëzimin duke dërguar Birin e Tij të vetëm, Jezusin.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Mos qesh (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 35, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Loja e djathit (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 30, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Koha jote. Si student, ata nuk kanë shumë para vetë. Disa prej tyre mund të vishen me rroba të mira, mund të kenë telefona të mirë dhe të kenë pamjen e një njeriu të pasur, por në të vërtetë dikush tjetër ua ka blerë ato gjëra. Gjëja më e çmueshme që studentët e tu mund të japin është koha e tyre. Sfidoji studentët të kalojnë një pjesë të ditës duke u përqendruar te dikush tjetër, përveç vetes. Pjesën më të madhe të ditës e kanë të zënë me veprimtari që, në pjesën më të madhe, u shërbejnë vetëm atyre. Sfidoji të mendojnë: Kujt mund t'i shërbej sot? Si mund të përdor kohën time për të përmirësuar jetën e dikujt tjetër? Si mund të sakrifikoj burimin tim më të çmuar, kohën time? Është shumë e fisshme të përpiqesh të përmirësosh veten, por gëzimi i vërtetë kultivohet duke kaluar pjesën më të madhe të ditëve të tua duke përmirësuar jetën e dikujt tjetër. Sakrifikoje tani atë kohë sepse do ta kthejnë kokën pas disa vite më vonë dhe do të shohin se kishin vërtetë shumë kohës.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të përshkruanin me detaje momentin kur u është dashur të heqin dorë nga diçka që e kanë dashur vërtet. Jepu pak kohë studentëve të ndajnë. Fokusohu në faktin përse ishte aq e vështirë të hiqej dorë nga ajo gjë. Mund të bëni edhe një listë të emocioneve të zakonshme që të gjithë kanë përjetuar kur u është kërkuar të heqin dorë nga diçka. Pastaj drejtoje mësimin te Abrahami dhe kërkesa që i bëri Perëndia për të hequr dorë nga gjëja më e çmuar për të, biri i tij.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGJET KYÇ:

Atëherë Abrahami ngriti sytë dhe shikoi; dhe ja prapa tij një dash i zënë për brirësh në një kaçube. Kështu Abrahami shkoi, mori dashin e tij dhe e ofroi si sakrificë në vend të të birit. Dhe Abrahami e quajti këtë vend Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: "Do të furnizohet mali i Zotit."

Zanafilla 22:13-14

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZANAFILLA 22

PERËNDIA I KËRKOI ABRAHAMIT TË SAKRIFIKONTE BIRIN E TIJ TË VETËM.

Mbas këtyre gjërave Perëndia e vuri në provë Abrahamin dhe i tha: "Abraham!" Ai u përgjigj: "Ja ku jam." Dhe Perëndia tha: "Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm, atë që ti do, Isakun, shko në vendin e Moriahve dhe sakrifikoje në një nga malet që do të të tregoj."

Zanafilla 22:1-2

ABRAHAMI IU BIND PERËNDISË ME BESNIKËRI.

Kështu Abrahami u ngrit herët në mëngjes, i vuri samarin gomarit, mori me vete dy shërbyes dhe të birin Isak dhe çau dru për sakrificën; pastaj u nis drejt vendit ku i kishte thënë Perëndia të shkonte.

Zanafilla 22:3

PERËNDIA E SIGUROI VETË SAKRIFICËN.

Pastaj Abrahami shtriu dorën dhe mori thikën për të vrarë të birin. Por Engjëlli i Zotit thirri nga qielli dhe i tha: "Abraham, Abraham!" Ai u përgjigj: "Ja ku jam." Engjëlli i tha: "Mos e zgjat dorën kundër djalit dhe mos i bëj asnjë të keqe. Tani e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd, të vetmin bir që ke." Atëherë Abrahami ngriti sytë dhe shikoi; dhe ja prapa tij një dash i zënë për brirësh në një kaçube. Kështu Abrahami shkoi, mori dashin e tij dhe e ofroi si sakrificë në vend të të birit.

Zanafilla 22:10-13

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

APLIKIMI

Abrahamit iu kërkua të hiqte dorë nga biri i tij i vetëm. Perëndia i kërkoi t'i dorëzonte gjënë më të çmuar dhe pastaj ta sakrifikonte në altar. Ka shumë mësime të rëndësishme në këtë histori që mund të aplikohen në jetën tonë. Ja disa gjëra për t'u menduar këtë javë. Zgjidh një pikë aplikimi dhe shtjelloje me studentët e tu.

1. Bekimet e Perëndisë nuk janë kurrë një zëvendësim për vetë Perëndinë. Perëndia bekoi Abrahamin dhe Sarën me një bir, Isakun, në pleqërinë e tyre. Megjithatë, Perëndia dëshiron të sundojë dhe mbretërojë në vendin e parë të jetës tënde gjithashtu. Mos ngatërro kurrë adhurimin e bekimeve të Perëndisë me adhurimin e vetë Perëndisë. Abrahami u vu në prove atë ditë, iu kërkua të hiqte dorë nga biri i tij. Perëndia e dinte se ç'do të bënte, por ndoshta Ai donte që Abrahami të shihte se sa e thellë ishte dashuria e tij për Perëndinë, jo thjesht për bekimin e Tij.

2. Perëndia i bën një kërkesë Abrahamit dhe ai nuk ngurron të veprojë. Zanafilla 22:3 thotë: Abrahami u ngrit herët në mëngjes, i vuri samarin gomarit… Perëndia i kërkoi Abrahamit të bënte diçka dhe ai veproi. Ai nuk u vonua një javë. Nuk u lut për muaj të tërë. Perëndia i kërkoi

FJALË KYÇ: Sakrificë: humbja e diçkaje shumë të vlefshme për hir të diçkaje që konsiderohet të ketë më shumë vlerë

MENDIMI KYÇ: Perëndia siguroi sakrificën për Abrahamin në vend të birit të tij Isakut. Perëndia siguroi një sakrificë për njerëzimin duke dërguar Birin e Tij të vetëm, Jezusin.

të bënte diçka dhe me besnikëri ai bëri atë që iu urdhërua. A ka diçka që Perëndia qartësisht të ka urdhëruar të bësh dhe ti ende pret pa bërë asgjë? A po pret pafundësisht kur në fakt duhet të veprosh? A ka nevoja përreth teje për të cilat mund të bësh diçka por ti je duke pritur që drejtuesi të të shtyjë në veprim?

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.2 mësuam që Perëndia siguroi sakrificën për Abrahamin në vend të birit të tij të vetëm, Isakut. Perëndia siguroi një sakrificë për njerëzimin duke dërguar Birin e Tij të vetëm, Jezusin.

DITA 3

LEXO: ZANAFILLA 22:1-5

Perëndia e thërret Abrahamin në emër. Abrahami nuk i fshihet Perëndisë sepse ka besim tek Ai (Jakobi 2:23). Perëndia e urdhëron atë të bëjë një sakrificë, madje një sakrificë shumë personale. Ai i kërkon Abrahamit të sakrifikojë birin e tij të vetëm. Ditën tjetër, Abrahami u ngrit, preu dru për ofertën dhe bëri gati gomarin.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një situatë ku ke menduar se Perëndia të ka kërkuar të bësh diçka për Të. Sa kohë u mendove për atë që Perëndia të kërkoi të bëje? A ishte e lehtë apo e vështirë t'i bindeshe Perëndisë atëherë?

DITA 4

LEXO: ZANAFILLA 22: 6-8

Abrahami dhe Isaku ngjisin malin. Isaku vë në dukje diçka të rëndësishme: "Hëm, babi... ku është sakrifica?" Vër re se si përgjigjet Abrahami: ... "Perëndia do të sigurojë vetë qengjin për sakrificën..." Perëndia i kishte kërkuar të ofronte birin e tij. Megjithatë, Abrahami shpreh besimin në sigurimin e Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një kohë kur ke pasur nevojë për sigurimin e Perëndisë. A e ke të vështirë të besosh në gjërat që nuk mund t'i shohësh apo t'i prekësh? A e ke të thjeshtë t'i besosh Perëndisë, pavarësisht rrethanave?

DITA 5

LEXO: ZANAFILLA 22:9-14

Abrahami e donte shumë birin e tij (Zanafilla 22:2), megjithatë nuk e refuzoi kërkesën e Perëndisë. Ai e lidhi fizikisht djalin e tij, e vendosi në altar dhe mori thikën. Po bëhej gati të vriste me thikë djalin e tij mbi një altar. Abrahami është plotësisht i përkushtuar në atë që Perëndia i ka kërkuar të bëjë. Pastaj gjithçka ndalet. Perëndia thotë: "Mos e zgjat dorën kundër djalit." Çfarë çlirimi! Atë ditë Perëndia pa se Abrahami kishte frikë (respektonte) Perëndinë dhe siguroi një sakrificë në vend të tij.

SHTJELLOJMË:

Cila është gjëja që do më shumë se gjithçka tjetër? A e ke pyetur ndonjëherë veten nëse Perëndia mendon se ti e do atë gjë më shumë se Atë? A do të ishe i gatshëm të ndaheshe nga ajo gjë nëse Perëndia do të ta kërkonte? Shpjegoje.

DITA 6

LEXO: ZANAFILLA 22:15-18

Pasi kishte parë besimin e Abrahamit, Perëndia e bekoi Abrahamin për besnikërinë e tij në bindje. Ai bën një premtim të madh, një besëlidhje, me Abrahamin. Bekimi, askund në Shkrim, nuk vjen para bindjes. Bekimi vjen gjithmonë pas bindjes.

SHTJELLOJMË:

A po pret që Perëndia të të bekojë pa u bindur më parë? Ashtu si me Abrahamin, a mendon se Perëndia do që të shohë nëse Ai është më i rëndësishmi në jetën tënde? Shpjegoje.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Përsërite!

Është e rëndësishme të përsërisësh. Shpeshherë duam të përfundojmë mësimin dhe të kalojmë te tjetri. Pa përsëritje, nuk i kujtojmë apo rifreskojmë dot mësimet e mëparshme. Merr pak kohë për të përsëritur mësimin që ka pasur ndikim te studentët e tu. Ndoshta ka një mënyrë për të lidhur pyetjet e diskutimit të sotëm me një mësim të një kapitulli tjetër. Meqenëse mësimi i kësaj jave përqendrohet te sakrifica ndoshta mund ta lidhësh me mësimin 1.7 ku Perëndia vrau dhe sakrifikoi kafshën e parë për të bërë veshje për Adamin dhe Evën. Përpiqu gjithmonë të bësh lidhje të tilla për studentët. Bëje zakon përsëritjen e mësimeve të kaluara. Vetëm se e keni diskutuar nuk do të thotë që do t'u mbetet në mendje. Provo ide të reja dhe krijuese që fëmijëve t'u mbesë në mendje mësimi.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 3.3

MOISIU

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: EKSODI 6:2-13

VARGU KYÇ:

Prandaj u thuaj bijve të Izraelit: "Unë jam Zoti; do t'ju heq nga punët e rënda që ju kanë imponuar Egjiptasit, do t'ju çliroj nga skllavërimi i tyre dhe do t'ju çliroj me krah të shtrirë dhe ndëshkime të mëdha.

Eksodi 6:6

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

SHUMË VITE TË TJERA DO TË KALOJNË. Besëlidhja e Perëndisë me Abrahamin qëndron akoma, edhe pse jeta do të marrë një kthesë të tmerrshme për izraelitët, Perëndia nuk i harron kurrë premtimet e Tij. Izraelitët përfundojnë në Egjipt falë një njeriu të quajtur Jozef. Megjithatë, vite më vonë, pas kalimit të disa faraonëve, izraelitët janë rritur në numër. Egjiptasit duhet të bënin diçka me këtë numër në rritje përndryshe mund të mos ishin në gjendje t'i kontrollonin më. I futën në punë, i detyruan të punonin si skllevër duke ndërtuar tempuj dhe çfarëdo gjëje tjetër që donin egjiptasit. Izraelitët ishin të lidhur dhe punonin derisa u dëmtohej kurrizi. Ata luteshin dhe i kërkonin Perëndisë t'i çlironte nga duart e egjiptasve. Perëndia dëgjoi thirrjet e tyre dhe nuk i harroi kurrë premtimet që i kishte bërë Abrahamit. Ai do të ngrinte Moisiun, levit nga lindja dhe princ i Egjiptit përmes adoptimit. Ai u rrit në pallatin mbretëror dhe u largua më pas sepse vrau një egjiptas që kishte abuzuar me një skllav izraelit. Perëndia e thirri në shkretëtirë dhe e përdori Moisiun për të çliruar izraelitët nga skllavëria e Egjiptit. Në të njëjtën mënyrë, Jezusi erdhi në tokë për ta çliruar të gjithë njerëzimin nga skllavëria e mëkatit. Ashtu si Moisiu ishte sigurimi i Perëndisë për çlirimin nga skllavëria e Egjiptit, po ashtu Jezusi është sigurimi i Perëndisë për çlirimin e njerëzimit nga skllavëria e mëkatit.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se izraelitët u lidhën dhe skllavëruan nga egjiptasit.
- Studentët do të dinë se izraelitët pritën për një çlirim nga prangat e skllavërisë.
- Studentët do të dinë se Perëndia ngriti Moisiun për të çliruar izraelitët nga skllavëria e Egjiptit.

FJALË KYÇ: Çlirim: Të qenët shpëtuar nga shtypja

MENDIMI KYÇ: Moisiu ishte mjeti që Perëndia përdori për të çliruar popullin e Tij nga skllavëria e Egjiptit. Perëndia gjithashtu dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të na çlironte nga skllavëria e mëkatit.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Shtypje e tubit (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 55, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Gur, letër, gërshërë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 77, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Skllavëria jeton akoma. Trafikimi njerëzor është ai që ne quajmë skllavëri moderne. Vetëm se nuk e shohim skllavërinë çdo ditë, nuk do të thotë se ajo nuk praktikohet ende sot. Në disa kultura ka familje që jetojnë në tuba betoni që blihen me këste te një pronar toke, i cili kërkon pagesë të plotë përmes punës së krahut. Ky tub kushton aq shumë saqë personi nuk do të mund ta shlyejë kurrë, kështu atij apo asaj i duhet të punojë, të skllavërohet, gjithë jetën. Ka edhe shumë forma të tjera të tmerrshme skllavërie në botë. Trafikimi seksual i njerëzve është problem në shumë shtete, përfshirë edhe në vendin tonë. Në disa vende mund të kushtojë edhe vetëm 70 dollarë për të çliruar dikë nga skllavëria seksuale. A mund të çlirojnë studentët e tu dikë nga skllavëria njerëzore? A mund të përkushtohen studentët e tu në ngritjen e fondeve dhe ndërgjegjësimin për këto kauza? Jezusi erdhi për të na çliruar. Si mund ta luftojnë studentët e tu skllavërinë dhe të plotësojnë disa nevoja të vërteta në jetët e këtyre njerëzve të vërtetë? Kërkoni në internet për organizata që luftojnë trafikimin njerëzor dhe përpiquni të bashkëpunoni me një prej tyre.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të bënin një listë me 10 gjërat më ngjitëse në shtëpinë e tyre. Përdore këtë si një prezantim për mësimin e grupit të madh dhe, duke marrë disa objekte ngjitëse, fto pesë deri në shtatë nga studentët që të provojnë listën tënde me 10 gjërat ngjitëse. Shih se cili objekt u duket më ngjitës. Kjo mund të jetë diçka shumë argëtuese,por edhe e rrëmujshme. Pastaj përdor idenë e objekteve ngjitëse për të kaluar në mësimin duke bërë krahasimin se si edhe izraelitët ishin të ngjitur (ngecur) në skllavërinë e Egjiptit.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

VARGU KYÇ:

Prandaj u thuaj bijve të Izraelit: "Unë jam Zoti; do t'ju heq nga punët e rënda që ju kanë imponuar Egjiptasit, do t'ju çliroj nga skllavërimi i tyre dhe do t'ju çliroj me krah të shtrirë dhe ndëshkime të mëdha.

Eksodi 6:6

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: EKSODI 6: 2-13

IZRAELITËT ISHIN SKLLEVËR NË EGJIPT.

Dhe bijtë e Izraelit qenë frytdhënës, u shumëzuan fort dhe u bënë të shumtë, u bënë jashtëzakonisht të fortë; dhe vendi u mbush me ta.

Exodus 1:7-11

IZRAELITËT KISHIN NEVOJË PËR NJË ÇLIRIMTAR.

Por ndodhi që, mbas një kohe të gjatë vdiq mbreti i Egjiptit, dhe bijtë e Izraelit rënkonin për shkak të skllavërisë; ata bërtitën dhe britma e tyre për shkak të skllavërisë u ngjit deri tek Perëndia. Kështu Perëndia dëgjoi rënkimin e tyre, dhe Perëndisë iu kujtua besëlidhja që kishte përfunduar me Abrahamin, me Isakun dhe me Jakobin.

Eksodi 2:23-24

PERËNDIA PËRDORI MOISIUN PËR TË ÇLIRUAR IZRAELITËT.

Dhe tani, ja britma e bijve të Izraelit ka arritur deri tek unë, dhe kam parë gjithashtu se si Egjiptasit i shtypin. Prandaj eja dhe unë do të të dërgoj te Faraoni me qëllim që ta nxjerrësh popullin tim, bijtë e Izraelit, nga Egjipti.

Eksodi 3:9-10

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Që nga dita kur lindim, ne jemi skllevër të mëkatit tonë. Mëkati na bën të gjithëve skllevër. Mëkati dëshiron të jetë zot i vetes dhe kërkon që të gjithë t'i shërbejnë. Mëkati na mbërthen dhe na mban të lidhur me zinxhirë të hekurt që peshojnë dhe mbysin jetën tonë. Edhe ne, ashtu si izraelitët, kemi nevojë për një çlirues. Për ne, Ai është Jezusi. Jezusi erdhi në këtë botë për të thyer skllavërinë e mëkatit tonë. Ai erdhi për të na çliruar nga lidhjet që mëkati ka vënë në jetën tonë. Jezusi na fton të jetojmë në liri dhe në të vërtetën. A e ke pranuar ti ftesën e Tij? A ke kërkuar ndihmë nga Perëndia ashtu siç bënë izraelitët? A e sheh nevojën tënde për t'u çliruar nga skllavëria e mëkatit? Jezusi është këtu dhe është i gatshëm të të falë dhe të të japë një jetë të re në liri. Pra, ku je ti tani? A ke ngecur në zinxhirët e mëkatit tënd? Apo po jeton në lirinë e vërtetë që gjendet vetëm në Jezu Krishtin?

FJALË KYÇ:

Çlirim: Të qenët shpëtuar nga shtypja

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.3 mësuam se Moisiu ishte instrumenti që Perëndia përdori për të çliruar popullin e Tij nga skllavëria e mëkatit. Perëndia gjithashtu dërgoi Birin e tij, Jezusin, për të na çliruar nga skllavëria e mëkatit.

DITA 3

LEXO: EKSODI 6: 2-3

Kur bëhet fjalë për Biblën, emrat kanë shumë rëndësi. Në botën e sotme ne kemi titujt e punës që nënkuptojnë rëndësi. Megjithatë, në kohën biblike, kishte shumë rëndësi kush ishte babai yt, kë njihte ai dhe si njihej ai. Emrat kanë shumë rëndësi edhe për Perëndinë. Perëndisë i intereson si përfaqësohet emri i Tij. Tregon për atë që Ai është dhe atë që Ai mund të bëjë.

SHTJELLOJMË:

Çdo emër ka një kuptim. Zbulo çfarë kuptimi ka emri yt dhe shkruaje më poshtë (emri dhe mbiemri). Si do të ndiheshe nëse dikush do të të thërriste ndryshe dhe jo me emrin tënd të vërtetë? A ka rëndësi si të quajnë? Shpjegoje.

DITA 4

LEXO: EKSODI 6:4-5

Të kujtosh gjërat është një pjesë e rëndësishme e jetës. A ke pasur ndonjë rast me familjen kur keni treguar histori që fillojnë me: "A të kujtohet kur...?" Të njëjtën gjë po bën Perëndia në këtë pasazh. Ai po thotë: "A të kujtohet kur i bëra këtë premtim Abrahamit. Po... unë nuk e kam harruar." Perëndia i mban premtimet (Psalmi 145:13).

SHTJELLOJMË:

Me të njëjtin koncept të të kujtuarit, përshkruaj një rast kur Perëndia erdhi në jetën tënde dhe të ndihmoi. Si e ka treguar veten se është besnik?

DITA 5

LEXO: EKSODI 6:6-7

Perëndia thotë gjëra shumë ngushëlluese në këto vargje. Ai thotë: "Do t'ju marr si popullin tim dhe unë do të jem Perëndia juaj... (v.7) Këto janë fjalë vërtet ngushëlluese për një popull të thyer dhe të pashpresë. Kur Perëndia na çliron, Ai jo vetëm vepron dhe pastaj na harron sërish, Ai qëndron me ne sepse ne jemi të Tijtë.

SHTJELLOJMË:

A mund të përshkruash një rast kur ke qenë i lënduar dhe dikush ka ardhur me një fjalë inkurajuese? Si je ndierë pasi ke dëgjuar ato fjalë? A ndien se ke disa njerëz në jetën tënde që mund t'i inkurajosh? Nëse po, kë?

DITA 6

LEXO: EKSODI 6:8

Edhe kur gjërat nuk janë mirë, Perëndia është në kontroll. Gjithçka po shkon sipas planit të Perëndisë. Asgjë, as dhimbja, skllavëria, mëkati apo vuajtja nuk mund të ndryshojnë qëllimet apo premtimet e Perëndisë. Perëndia do të përmbushë premtimin që i bëri Abrahamit dhe do të çlirojë izraelitët nga skllavëria e do t'i çojë në tokën e premtuar.

SHTJELLOJMË:

A mendon se skllavëria e mëkatit tënd është më e fuqishme se premtimi i Perëndisë për të të çliruar prej tij? A mendon se po mbahesh më fort pas gënjeshtrave të mëkatit tënd apo pas të vërtetës së Perëndisë? Shpjego.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Nuk më intereson fare

Ndoshta ke disa studentë në grupin tënd që nuk u intereson fare grupi i diskutimit. Ata ulen, flasin me shokët, madje bëhen shpërqendrim në disa raste. Gjej mënyra për t'i përfshirë në diskutim në fillim, në vend që t'i injoroni apo t'i dënoni. Mund të jetë ide e mirë të kaloni pak kohë me këta studentë edhe jashtë grupit për të zbuluar çfarë ndodh në jetën e tyre. Kjo do të thotë se duhet të përpiqesh pak më shumë me ta, por në fund do të marrësh shpërblimin për kohën e investuar, sepse ajo mund të bëjë ndryshimin në marrëdhënien tuaj. Mos i lër pas dore fëmijët që duket se nuk u intereson. Në fund, ata mund të bëhen studentët e tu më të mirë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj—**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Name	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 3.4

DAVID

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
2 E SAMUELIT 7:8-16

VARGU KYÇ:

Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

Isaia 9:7

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

PAS MOISIUT, BIJTË E IZRAELIT ARRITËN NË TOKËN E PREMTUAR pas shumë viteve endjeje në shkretëtirë pas eksodit në Egjipt. Izraelitët hynë në një kohë ku gjykatësit sundonin, mbronin dhe kthenin bijtë e Izraelit nga zinxhirët e mëkatit. Megjithatë, gjykatësit vinin dhe iknin. Njerëzit lodheshin, mërziteshin dhe donin të kishin një mbret si të gjithë vendet e tjera. Perëndia i paralajmëroi se çfarë mund t'u bënte një mbret. Perëndia u dha paralajmërime të qarta, megjithatë ata përsëri donin të ecnin në mënyrën e tyre. Samueli, një profet vajosi një mbret për të sunduar mbi ta. Emri i mbretit ishte Saul. Ai ishte i gjatë, zeshkan dhe i pashëm. Nga shpatullat dhe koka qëndronte mbi të gjithë të tjerët. Ai filloi mirë, por nuk përfundoi mirë. Si të gjithë ne, ai donte të vepronte sipas dëshirës së vet. Nuk donte të ndiqte mënyrën e Perëndisë. Prandaj, për shkak të mosbindjes së tij, mbretëria iu hoq dhe vdiq si një sundues me paranoja që ndoqi zemrën e vet. Pavarësisht gjithë kësaj Perëndia ka një plan. Ai do ta përdorë Samuelin për të vajosur një mbret tjetër. Jo atë që ka pamjen e një mbreti, por dikë që është sipas zemrës së Tij. Perëndia zgjodhi një bari të vogël, kuqalash, më të voglin e familjes, për të qenë mbret. Ai do t'i bëjë një premtim të rëndësishëm edhe Davidit. Ai i thotë se mbretëria e tij do të jetë e qëndrueshme përjetë. Sot, pikërisht tani, Jezusi është i ulur në fronin e Davidit. Të dy prindërit e Jezusit, Maria dhe Jozefi, kanë prejardhjen nga shtëpia e Davidit. Ai ka autoritet të plotë dhe të drejtën për t'u ulur në fronin e Davidit. Sundimi dhe mbretërimi i Jezusit do të zgjasë përgjithmonë.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Izraeli donte një mbret për të sunduar vendin.
- Studentët do të dinë se Sauli u emërua mbret, por sundimi i tij nuk zgjati.
- Studentët do të dinë se Davidi u vajos mbret dhe froni i tij u bë i qëndrueshëm në përjetësi.

FJALË KYÇ: Mbretëri: një shtet apo qeveri që ka një mbret apo mbretëreshë në krye

MENDIM KYÇ: Froni i Davidit do të jetë i qëndrueshëm përjetë. Jezu Krishti është Mbret i Mbretërve që sundon dhe mbretëron në fronin e Davidit.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojrat dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Analizë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 8, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Cracker Stacker (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 31, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Mbretër dhe Mbretëresha. Sunduesit, mbretërit, kryeministrat dhe president kanë punë të rëndësishme. Kërkoju studentëve të bëjnë një listë me njerëzit me më shumë ndikim në botë në ditët e sotme (1 e Timoteut 2:2). Çdo person me ndikim caktojeni në një datë specifike dhe lutuni për të në atë ditë. Sfidoji studentët të luten për sunduesit tanë dhe për ata që kanë ndikim në jetën dhe kulturën tonë. Kush lutet për sportistët dhe të famshmit? Kush lutet për muzikantët dhe artistët që ndikojnë në atë që bota dëgjon sot? Bëhuni një grup që nuk lutet vetëm për veten dhe kishën, por një grup që lutet për ata që janë larg Perëndisë dhe ata që kanë nevojë për mençurinë e Perëndisë çdo ditë. Kaloni kohë si grup duke u lutur për çështje të nivelit global.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të përshkruanin, vizatonin apo të krijonin imazhin e një mbreti apo mbretëreshe të përsosur dhe të listonin cilësitë (atributet) që i bëjnë ato mbretër apo mbretëresha të mëdha. Përdore këtë kohë si avantazh për grupin. Drejtohu nga mësimi i ditës duke u kërkuar studentëve të ndajnë krijimet dhe vëzhgimet e tyre. Përdori gjetjet e të gjithë studentëve për të krijuar sunduesin më të mirë. Pastaj bëj një listë tjetër dhe shih se sa prej atyre atributeve të sunduesit janë të ngjashme me ato të Jezu Krishtit.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

Isaia 9:7

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: 2 E SAMUELIT 7:8-16

IZRAELI DONTE NJË MBRET.

Megjithatë populli nuk deshi t'i dëgjojë fjalët e Samuelit dhe tha: "Jo, do të kemi një mbret mbi ne. Kështu do të jemi edhe ne si gjithë kombet; mbreti ynë do të na qeverisë, do të na dalë në krye dhe do të luftojë në betejat tona." Samueli i dëgjoi tërë fjalët e popullit dhe ia tregoi Zotit. Zoti i tha Samuelit: "Dëgjoje kërkesën e tyre dhe cakto një mbret mbi ta." Atëherë Samueli u tha njerëzve të Izraelit: "Secili të kthehet në qytetin e tij."

1 e Samuelit 8:19-22

SAULI U BË MBRET (POR NUK ZGJATI.)

"Unë jam penduar që e kam bërë Saulin mbret, sepse ai është larguar nga unë dhe nuk ka zbatuar urdhrat e mia." Samueli u trishtua dhe i klithi tërë natën Zotit.

1 e Samuelit 15:11

DAVIDI U BË MBRET (DHE FRONI I TIJ ËSHTË I QËNDRUESHËM PËRJETË.)

Atëherë Samueli mori bririn e vajit dhe e vajosi para vëllezërve të tij; që nga ajo ditë Fryma e Zotit zbriti te Davidi. Pastaj Samueli u ngrit dhe shkoi në Ramah.

1 e Samuelit 16:13

Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

Isaia 9:7

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Që apo çfarë po ndjek? Para kujt përulesh? Ndoshta para askujt. Epo, jo tamam. Të gjithë përulen para diçkaje apo dikujt. Shumë prej nesh kemi diçka në jetën tonë që na kontrollon, prej të cilës duket se nuk heqim dot dorë. Në këtë mësim, kemi mundësinë të shohim dy mbretër tërësisht të ndryshëm; të dy mëkatarë që kanë nevojë për hirin e Perëndisë, por ata sunduan në mënyra shumë të ndryshme. Fjala e Perëndisë thotë se në fund u bë çështje e zemrës. Sauli kishte pamjen e një mbreti. Ai kishte të gjitha mjetet e jashtme që shoqëria thotë se na duhen për të qenë të suksesshëm, por nuk përfundoi mirë. Por ZOTI i tha Samuelit: *"Mos ia shiko as pamjen as shtatëgjatësinë, sepse unë e kam refuzuar, sepse Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën." (1 e Samuelit 16:7)*. Zemra ka më shumë rëndësi për Perëndinë. Shih përgjatë gjithë Shkrimit dhe do të gjesh vazhdimisht se ajo që Ai kërkon së pari është qëllimi dhe qëndrimi i zemrës. Sauli zgjodhi të ndjekë, adhurojë dhe kënaqë veten e tij. Davidi donte gjërat e Perëndisë. Davidi përshkruhet si një njeri sipas zemrës së Perëndisë sepse ai donte dhe ndiqte gjërat që Perëndia donte. Nuk do të ketë kurrë fund për fronin e Davidit. Tani Jezusi është ulur në fronin e tij. Ai sundon dhe mbretëron e na ka paraqitur një grimcë të sundimit të përjetshëm në jetën e Davidit. Davidi kishte fajet dhe problemet e tij në familje, por ai dëshironte gjërat e Perëndisë dhe jetonte për t'i shërbyer Atij dhe jo vetes.

FJALË KYÇ:

Mbretëri: një shtet apo qeveri që ka një mbret apo mbretëreshë në krye

Pyetje reflektuese:

Kujt i përngjan jeta jote? Saulit apo Davidit?

Çfarë ka më shumë rëndësi, ajo që njerëzit shohin jashtë apo ajo që ndodhet brenda një personi?

Kur ndjek një sundues, drejtues apo një person me ndikim, a mendon ndonjëherë se që po ndjek ai? Si ndikon kjo në vendimin tënd për ta ndjekur?

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.4 mësuam se froni i Davidit do të jetë i qëndrueshëm përjetë. Jezu Krishti është Mbret i Mbretërve që sundon dhe mbretëron në fronin e Davidit.

DITA 3

LEXO: 2 E SAMUELIT 7:8-9

Perëndia po punon në jetën tonë, Ai është Sovran. Kjo do të thotë se Ai është në kontroll të gjithçkaje që na ndodh, e mirë apo e keqe. Në jetën e Davidit, Perëndia i mësoi atij gjëra kur kujdesej për delet që e përgatitën për pozicionin e fuqisë dhe autoritetit si mbret i Izraelit.

SHTJELLOJMË:

Si e ka përdorur Perëndia të shkuarën tënde për të të përgatitur për jetën tënde tani? Si po i përdor Perëndia rrethanat e tua të tanishme për të të përgatitur për të ardhmen?

DITA 4

LEXO: 2 E SAMUELIT 7:10-11

Perëndia është mbrojtës. Megjithatë, Ai nuk do të ndalojë asgjë që mund të na ndihmojë të bëhemi më tepër si Biri i Tij, Jezus. Kjo do të thotë se herë pas here do të ketë dhimbje dhe vuajtje. Përgjatë Shkrimit, Perëndia ka dëshiruar gjithmonë të na kthejë te vetja. Ai do që ne të jemi të sigurt brenda mbrojtjes së Tij. Ai dëshiron të kemi një vend ku mund të pushojmë në Të.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një vend ku ndihesh i sigurt. Çfarë të bën të ndihesh i sigurt në atë vend? A mendon se prezenca e Perëndisë është një vend i sigurt? Përse po ose jo?

DITA 5

LEXO: 2 E SAMUELIT 7:12-13

Plani i Perëndisë është të vazhdojë pasardhjen e mbretërisë së Davidit. Në këtë pasazh, Ai premton se do ta bëjë. Perëndia tregon histori të jashtëzakonshme. Ai ka një plan edhe për historinë tënde.

SHTJELLOJMË:

Për çfarë do ta pyesësh Perëndinë në lidhje me jetën tënde dhe përse pikërisht atë gjë? A të duket sikur plani i Perëndisë është një mister i vazhdueshëm apo është i thjeshtë për t'u kuptuar? A e ke pyetur ndonjëherë Perëndinë cili është plani i Tij për jetën tënde?

DITA 6

LEXO: 2 E SAMUELIT 7:13-16

Mbretëria e Perëndisë nuk i përngjan asnjë mbretërie të kësaj bote. Është plotësisht ndryshe. Gjithçka e saj e bën të pakrahasueshme me çdo lloj fuqie, qeverisje apo autoriteti me të cilin përballemi. Mbretërimi dhe sundimi që ka bazohen në dashurinë e Tij për popullin e Tij, por më e rëndësishmja, mbretëria e Perëndisë do të zgjasë përgjithmonë.

SHTJELLOJMË:

A gëzohesh që mbretëria e Perëndisë nuk do të ketë kurrë fund? Pse? Kush duhet të mësojë këtë javë për këtë mbretëri që nuk do të mbarojë kurrë?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Lutja ka rëndësi!

Kalo pak kohë në lutje për grupin tënd të diskutimit. Duket si gjëja më e thjeshtë për t'u bërë, por shpesh kthehet në gjënë që nënvlerësojmë më shumë. Merr pak kohë, qëndro vetëm dhe çoji para Atit jetët e studentëve të tu. Filloje dhe përfundoje kohën e diskutimit me lutje. Bëje lutjen qendrën e kohës së diskutimit në grupin tënd. Është e rëndësishme të diskutohen pyetjet, por sigurohu të kalosh kohë në lutje dhe t'i çosh para Atit jetët e studentëve të tu. Investimi që ti bën gjatë kësaj kohe në lutje do të ketë ndikim të madh në mënyrën si lidhesh me studentët e tu. Me kalimin e kohës do të kuptosh se si qëndrimi i zemrës tënde ndaj tyre do të ndryshojë dhe do t'i shohësh më shumë me sytë e Perëndisë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite—**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSMI 3.5

EMANUEL

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: GJONI 1:9-17

VARGJET KYÇ:

Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit.

Gjoni 1:14, 17

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

KOHA KALON ME MBRETËR QË JETOJNË, SUNDOJNË DHE VDESIN. Nga skllavërimi në njëqind vite heshtje, linja e fronit të Davidit ka mbetur e pacënuar. Premtimet e Perëndisë nuk thyhen kurrë. Froni i Davidit u bë i qëndrueshëm përjetë dhe Jezu Krishti ka ardhur për të sunduar dhe mbretëruar. Perëndia do të bëjë diçka që do të sjellë ndryshimin në botë. Ai u bë njëri prej nesh. Ai u bë njeri dhe banoi ndër ne, lindi në një vend ku flinin kafshët nga dy njerëz që nuk njiheshin nga askush. Ai erdhi të kërkonte dhe të shpëtonte të humburit, erdhi të bëhej pjesë e jetës sonë dhe të përmbyste botën. Krishti ka ardhur! Ai është Emanuel, Perëndia me ne! Ai erdhi me një mision, të vdiste për ne. Ai lindi për të vdekur. Dashuria dhe pasioni i tij për ne, krijimin e Tij, ishte aq e fortë saqë la mënjanë madhështinë e qiellit dhe jetoi në një qytet në breg të lumit, në një provincë të parëndësishme të perandorisë romake. Përse? Që të ishte me ne. Që të mund të mblidhte popullin e Tij pranë Vetes. Që të prekte dhe shëronte ata që lëngonin. Që t'i kthente shikimin të verbërve. Që të sfidonte çalimin shpirtëror të drejtuesve fetarë që donin të adhuronin vetëm veten e tyre. Ai erdhi të ushqente njerëz që po vdisnin nga uria shpirtërore me vetë Fjalë ne Perëndisë. Ai erdhi të ngjitej në kryqet tona. Ai erdhi të gjakosej dhe të vdiste për mëkatet tona. Ai erdhi që të merrte mbi veten gjithë zemërimin e Perëndisë për mëkatet tona. Perëndia me ne. Ai erdhi të na jepte dhuratë më të madhe: Veten e Tij.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se pasardhja e Davidit mbeti e paprekur përgjatë historisë.
- Studentët do të dinë se Jezusi është nga pasardhja dhe shtëpia e Davidit.
- Studentët do të dinë se Perëndia u bë mish dhe banoi ndër ne.

FJALË KYÇ: Emanuel: Perëndia me ne

MENDIM KYÇ: Jezusi u bë mish dhe banoi ndër ne.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Ruaj linjën (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 48, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Shpejtësi Jenga (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 91, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Krishtlindje. Perëndia erdhi për të qenë me ne. Ajo ka të bëjë me zbritjen e Perëndisë në tokë dhe bërjen e Tij mish në mënyrë që të vdiste për ne. Ai na dha dhuratën më të madhe: Veten. Pavarësisht në cilën kohë të vitit jemi, mblidhi studentët dhe planifiko një bekim Krishtlindjeje për familjet misionare në kishën tënde. Kërkoju studentëve të kontaktojnë misionarët dhe kërkoju listat e dëshirave të tyre. Pastaj organizo studentët dhe bashkëpuno me kishën që t'i dërgoni objektet e listës te misionarët. Ky është një projekt i thjeshtë shërbese, por mund të ketë një ndikim të madh në jetët e atyre që po shpërndajnë ungjillin e Jezu Krishtit nëpër kombe. Kjo është një mundësi e madhe për të inkurajuar dhe falënderuar misionarët për atë që ata bëjnë. Studentët e tu do të përfitojnë shumë përmes krijimit të marrëdhënieve me këta burra dhe gra të Perëndisë.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të bënin një listë me 10 dhuratat më të mira që ke marrë ndonjëherë. Pastaj janë pyetur se cila është dhurata më e mirë që kanë marrë. Mund ta fillosh mësimin duke i dhënë mundësinë secilit të ndajë listën e tij. Mund të bësh edhe diçka më shumë duke i blerë një dhuratë të vogël secilit në grup, një dhuratë që përçon mesazhin se Krishti erdhi të banojë mes nesh dhe vdiq për ne.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGJET KYÇ:

Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit.

Gjoni 1:14, 17

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: GJONI 1:9-17

PERËNDIA MBROI PASARDHJEN E DAVIDIT.

Shih Mateu 1:1–16 .

JEZUSI ËSHTË PASARDHËS I DREJTPËRDREJTË I DAVIDIT.

Jakobit i lindi Jozefi, bashkëshorti i Marisë, nga e cila lindi Jezusi, që quhet Krisht. Kështu të gjithë brezat nga Abrahami deri te Davidi bëhen katërmbëdhjetë breza; dhe, nga Davidi deri te internimi në Babiloni, katërmbëdhjetë breza; dhe, nga internimi në Babiloni deri te Krishti, katërmbëdhjetë breza.

Mateu 1:16-17

PERËNDIA U BË NJERI DHE BANOI NDËR NE.

Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit

Gjoni 1:14, 17

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Perëndia u bë njëri prej nesh. Krijuesi i universit dhe gjithçkaje në të (përfshirë ty) është me ne. Çdo ditë të jetës tënde, Perëndia është aty me ty. Perëndia erdhi në këtë botë dhe Ai e di ç'do të thotë të jesh i lodhur. Ai e di ç'do të thotë të kesh miq që nuk besojnë në ty. Ai e do ç'do të thotë të jesh i uritur. Ai e di ç'do të thotë të jesh i zemëruar me këtë botë të ngurtësuar shpirtërisht. Ai e di sa shumë të do. Perëndia na dha dhuratën më të madhe nga të gjitha: Veten. Çfarë ndryshimi sjell në jetën tënde të dish se Perëndia është me ty? Mendo për këto pyetje.

1. Si duhet ta jetoj çdo ditë kur kuptoj se Perëndia është me mua?

2. Kush duhet ta dijë se Perëndia është me ne? A ka ndonjë person në jetën tënde që duhet të dijë për Emanuelin?

3. A beson se Perëndia mund t'i kuptojë rrethanat dhe përjetimet e tua më mirë nga ç 'mendon ti? Përse?

FJALË KYÇ:

Emanuel: Perëndia me ne

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.5 mësuam se Jezusi u bë mish dhe banoi ndër ne.

DITA 3

LEXO: GJONI 1:9

Jezusi vjen në botë. Ai nuk është me pushime, nuk po bën shëtitje dhe po takohet me njerëz të rastësishëm. Ai është këtu me një mision. Ai u bë mish dhe banoi ndër ne.

SHTJELLOJMË:

A je ndjerë ndonjëherë sikur Jezusi nuk e kupton atë që ti po kalon? Cilat aspekte të jetës sonë i mbajmë larg Perëndisë sepse mendojmë se Ai nuk do të kuptojë?

DITA 4

LEXO: GJONI 1: 10-11

Ndonjëherë raca njerëzore është eksperte në të qëndruarit në padije. Disa prisnin që Mesia të vinte si mbret, luftëtar, politikan, filozof apo udhëheqës, por e kishim gabim. Ai erdhi si shërbëtor. Ai nuk erdhi për të tërhequr vëmendje mbi veten e Tij, por për ta drejtuar vëmendjen tek Ati. Efektet e rrënimit vazhdonin dhe ne ishim aq larg Tij saqë nuk e kuptuam kur Ai erdhi.

SHTJELLOJMË:

A ka kaq shumë hapësirë midis teje dhe Perëndisë saqë kur Ai shfaqet në jetën tënde ti nuk e kupton? A po pret që Perëndia të jetë Ai që ti do të jetë dhe nuk po e njeh për atë që Ai vërtet është? Shpjego.

DITA 5

LEXO: GJONI 1: 12-14

Perëndia me ne! Perëndia e di si është jeta. Ai e krijoi atë. Ai të krijoi ty. Ai e jetoi jetën dhe e jetoi me ty çdo ditë. Ai erdhi për të vuajtur me ty, për të qenë pranë teje, pavarësisht se çfarë ti kalon. Ai erdhi për të të shpëtuar dhe për të të bërë pjesë të familjes së Tij sepse Ai të do më shumë nga sa ti mund të kuptosh.

SHTJELLOJMË:

A mund të përshkruash një rast kur të është dukur se dikush (prind apo mik) nuk e ka kuptuar se çfarë po kaloje? Shpjegoje. A është ngushëllues për ty fakti që Krishti jetoi një jetë të vërtetë, me situata dhe probleme të vërteta?

DITA 6

LEXO: GJONI 1: 15-16

A e ke ndonjëherë atë ndjesinë e boshllëkut një ditë pas Krishtlindjes? Është pak depresionuese. Nuk ka më biskota, hiqet pema me zbukurimet, të gjitha dhuratat janë hapur. Duhet të presësh edhe 365 ditë të tjera deri vitin tjetër. Kur bëhet fjalë për Jezusin, Ai nuk është me ne vetëm një moment dhe pastaj zhduket, por është gjithmonë me ne. Jezusi është bekimi më i madh që na ka dhënë Perëndia. Është një bekim që nuk mbar-on kurrë dhe nuk ka nevojë për zëvendësim. Ai është gjithmonë dhe përjetë me ne.

SHTJELLOJMË:

Si ka qenë Jezusi një bekim për ty? Përshkruaj si Perëndia ka ndryshuar jetën tënde. Si i je përgjigjur bekimit të Perëndisë në jetën tënde?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Ji me ta

Në çfarë mënyrë qëndron pranë studentëve të tu? A të shohin vetëm në kishë dhe në takimin e grupit, kaq? Jepu mundësinë të qëndrojnë me ty dhe të kalojnë kohë edhe jashtë kohës specifike të grupit. Jezusi zgjodhi disa djem dhe kaloi tri vite me ta. Ftoji studentët në shtëpinë tënde. Jepu mundësinë të shohin jetën tënde të transformuar. Bëni gjëra të ndryshme bashkë. Vizitoni vende të ndryshme. Gjeni një aventurë apo projekt që mund të zhvilloni dhe ndërkohë bëni dhe diskutimin e grupit atje. Atyre u duhet një vend ku mund të bëjnë pyetje për jetën dhe do të përfitojnë duke parë si e jeton ti jetën. Dishepujt kanë një vend në rreshtin e parë ndaj një transformimi total. Jepu edhe studentëve të tu një vend në rreshtin e parë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 3.6

Krishti

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: LUKA 23:26-49

VARGU KYÇ:

Për këtë arsye ai është ndërmjetësi i Besëlidhjes së re që, me anë të vdekjes që u bë për shpërblimin e shkeljeve që u kryen gjatë Besëlidhjes së parë, të thirrurit të marrin premtimin e trashëgimisë së amshuar.

Hebrenjve 9:15

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

ME SHUMË MUNDËSI, KY ËSHTË MËSIMI MË I RËNDËSISHËM I TË GJITHË LIBRIT. Perëndia ka bërë besëlidhjen e Tij me Noeun, Abrahamin, Moisiun dhe Davidin. Tani Ai do të bëjë një besëlidhje të re. Jezu Krishti erdhi në këtë botë për të qenë Emanuel, Perëndia me ne. Ai është Mbreti që lindi për të vdekur. Por, përse Jezusi? Çfarë ka kaq të veçantë Ai? Ai është i përsosur! Prandaj është kaq i veçantë. Ai është Biri i vetëm i Perëndisë. Përsosmëria e Krishtit e bën sakrificën të përhershme. A të kujtohet që në mësimin 2.7 folëm për sistemin e sakrificave? Mësuam se pa derdhjen e gjakut nuk mund të ketë falje për mëkatet. Izraelitët duhet të bënin sakrifica për shlyerjen e mëkateve të kombit për një vit të plotë. Megjithatë, vit pas viti nevojitej përsëritja e sakrificave dhe Krishti e përfundoi në kryq. Një sakrificë e përsosur për mëkatet e njerëzimit. Jezusi do të vuante dhe do të vdiste mbi një kryq romak. Kryqi është instrumenti i përsosur për torturë dhe vdekje. I gjithë zemërimi i Perëndisë u derdh mbi Të. Pasi vuajti orë të tëra i gozhduar në atë pemë, Krishti tha fjalët e fundit dhe më të rëndësishmet: *U krye!* Çfarë u krye? Jezusi është Shpëtimtari i njerëzimit. Ai është sakrifica e përsosur e Perëndisë. Ai është Çliruesi i Madh. Ai është Mbreti i Mbretërve. Ai është Emanuel, Perëndia me ne. Ai është Krishti!

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Jezusi është i Vajosuri i Perëndisë.
- Studentët do të dinë se Jezusi është Shpëtimtari i premtuar.
- Studentët do të dinë se Jezusi është sakrifica e përsosur për mëkatet tona.

FJALË KYÇ: Krishti: I Vajosuri

MENDIM KYÇ: Jezusi është Krishti, i Vajosuri i Perëndisë, i Cili heq mëkatin e njerëzimit. Ai është Shpëtimtari i premtuar, sakrifica e përsosur për mëkatet tona.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Gara e bluzave (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 97, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Laji flokët (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 113, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Ungjilli. Jezu Krishti erdhi dhe vdiq për ty. Ai u varros dhe u ngrit pas tri ditësh. Njerëzit duhet ta dinë këtë lajm të mirë. Një nga arsyet kryesore që studentët nuk e ndajnë besimin e tyre me të tjerët është sepse nuk kanë mjaftueshëm praktikë për këtë gjë. Nuk është pjesë e përditshmërisë së tyre. Është diçka e këndshme, por mbetet në kategorinë e gjërave që do të bëjnë më vonë. Mblidhi studentët dhe lëri të praktikojnë ndarjen e ungjillit me njëri-tjetrin. Trajnoi që të ndajnë ungjillin dhe përcakto një kohë dhe vend ku mund ta ndajnë atë. Çoji në një qendër të afërt tregtare. Mbikëqyri me drejtues të tjerë, por jepu mundësinë të ndajnë besimin e tyre dhe të ndajnë lajmin e mirë të asaj që Jezusi ka bërë për ta. Duke iu dhënë atyre më shumë mundësi për ta bërë këtë gjë do të ndihmojë në krijimin e themelit dhe pritshmërisë për atë që duhet të bëjnë kur të rriten.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të blinin diçka të pavlerë nga prindërit e tyre. Kërkoju studentëve ta ndajnë me grupin. Ndaj edhe ti (gjej diçka të pavlerë) dhe përdore si prezantim për mënyrën si Krishti erdhi në botë. Ai pagoi çmimin për mëkatet tona, na bleu kur ishim në mëkat dhe të padashur.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGU KYÇ:

Për këtë arsye, ai është ndërmjetësi i Besëlidhjes së re që, me anë të vdekjes që u bë për shpërblimin e shkeljeve që u kryen gjatë Besëlidhjes së parë, të thirrurit të marrin premtimin e trashëgimisë së amshuar.

Hebrenjve 9:15

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: LUKA 22:39-23:49

JEZUSI ËSHTË I VAJOSURI I PERËNDISË.

Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë. Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies së tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij, mbasi e bëri vetë pastrimin nga mëkatet tona, u ul në të djathtën e Madhërisë në vendet e larta.

Hebrenjve 1:1-3

JEZUSI ËSHTË SHPËTIMTARI I PREMTUAR.

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes.

Isaia 9:6

JEZUSI ËSHTË SAKRIFICA E PËRSOSUR.

Hyri një herë e përgjithmonë në shenjtërore, jo me gjakun e cjepve dhe të viçave, por me gjakun e vet, dhe fitoi një shpëtim të amshuar.

Hebrenjve 9:12

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Cila është përgjigjja jote? Efesianëve 2:8–9 thotë: "*Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush.*" Cila është përgjigjja jote ndaj faktit që Jezu Krishti vdiq për mëkatet e tua? A do të përulesh para Mbretit të Mbretërve dhe do t'i besosh Atij për shpëtim? Apo do të vazhdosh t'i besosh vetes dhe burimeve të tua? Jeta e Jezusit në tokë ishte e përsosur dhe derdhja e gjakut të Tij për ty ishte e përhershme. A do t'i besosh Atij?

Ndoshta ke besuar në Jezusin dhe ky nuk është lajm i ri për ty. Si po shkon vërtet? A po i beson vërtet Atij apo je kthyer në zakonet e vjetra? A e kujton momentin e shpëtimit? A të duket ungjilli diçka e vjetër dhe e mërzitshme? A të duket si një kujtim i vjetër shlyerja e mëkateve të tua? Nëse është kështu, kalo pak kohë vetëm me Perëndinë. Zbulo çfarë po ndjek vërtet zemra jote.

Dhe së fundi, ndoshta je shumë i zjarrtë për Jezu Krishtin. Asgjë nuk ka ndryshuar që nga dita që Ai të gjeti. Kush duhet të dëgjojë lajmin e mirë se çmimi për mëkatet tona është paguar plotësisht? Bëj një listë me personat që duhet ta dëgjojnë patjetër ungjillin. Sfidoje veten të ndash më shumë për Krishtin, jo vetëm me njerëzit që njeh. Të gjithë kanë nevojë të dëgjojnë lajmin e mirë të ungjillit. SHKO!

FJALË KYÇ:

Krishti: I Vajosuri

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.6 mësuam se Jezusi është Krishti, i Vajosuri i Perëndisë, Ai që heq mëkatin e botës. Ai është Shpëtimtari i premtuar, sakrifica e përsosur për mëkatet tona.

DITA 3

LEXO: ISAIA 53: 2-3

Njerëzimi ka pëlqyer gjithmonë të ndjekë prirjet/tendencat. Na pëlqen të ndjekim njerëz dhe gjëra që duken mirë, por nuk marrim kohë për të vlerësuar thelbin e tyre. Jezusi nuk shikonte pamjen dhe dukjen e jashtme. Asgjë në pamjen e Tij nuk na nxit ta ndjekim Atë në egoizëm.

SHTJELLOJMË:

A e ndjek ndonjëherë Perëndinë vetëm për shkak të asaj që Ai mund të bëjë për ty? Apo ke një marrëdhënie me Të që është më e thellë se thjesht çfarë Ai bën? Shpjego.

DITA 4

LEXO: ISAIA 53:4-6

Krishti përjetoi ndëshkimin e plotë për mëkatet tona, një ndëshkim që duhet ta vuanim ne. ...ai mbante sëmundjet tona dhe kishte marrë përsipër dhembjet tona... Krishti i largoi të gjitha. Të gjithë ne kemi devijuar. Secili prej nesh ka mëkatuar dhe është privuar (Romakëve 3:23), dhe kemi nevojë për Jezusin.

SHTJELLOJMË:

A ka ndonjë mëkat në jetën tënde pas të cilit po mbahesh, megjithëse Krishti ka vdekur për të? Si ndihesh kur kujton faktin se Krishti ka hequr gjithë mëkatin tënd?

DITA 5

LEXO: ISAIA 53:7-8

Jezusi shkoi në kryq me dëshirën e vet. Nuk na tregohet që Ai të ketë kundërshtuar gozhdimin apo të jetë përpjekur të shpëtojë veten në takimet e Tij me Herodin, Pilatin apo priftërinjtë. Qëllimi i Tij i plotë ishte të përmbushte misionin e Tij. Qëndrimi i Tij ishte bindje pa egoizëm.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj një rast kur ke dashur të bësh gjënë e duhur, por qëndrimi yt nuk ka qenë i drejtë. A ndikon qëndrimi yt në veprimet e tua? Shpjego.

DITA 6

READ: ISAIAH 53:9-11

Ishte plani i Perëndisë të dërgonte Birin e Tij të vetëm për të vdekur në vendin tonë. Ai ishte plotësisht i pafajshëm, nuk kishte bërë asgjë të gabuar. Krishti vdiq që ne të drejtësohemi me Perëndinë. Vuajtja e Tij nuk ishte më kot, kishte një qëllim shumë të bukur: të na rikthente në gjendjen e fillimit.

SHTJELLOJMË:

A je drejtësuar me Perëndinë për shkak të besimit në Jezu Krishtin? Përshkruaj si është marrëdhënia jote me Krishtin. A ecën çdo ditë me Perëndinë? Apo thjesht takohesh rastësisht me Të akoma?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Përfshihu

Ndonjëherë, një drejtues diskutimi mund të bëhet shumë pasiv. Pa dyshim, studentët do të thonë gjëra që janë herezi. Kur kjo të ndodhë, duhet të përfshihesh pa lënduar kurajën e treguar nga studenti për të dhënë mendimin e tij. Pjesë e të qenët drejtues i një grupi diskutimi do të thotë të dish çfarë të bësh. Sigurohu të kesh kuptuar mirë pikat kyç doktrinarë, para se të bëhesh pjesë e grupit. Nëse nuk e di diçka, kërkoji përgjigje pastorit. Përndryshe do ta gjesh veten në situata ku studentët thonë gjëra të gabuara dhe nuk do të dish të ndreqësh mendimet e tyre. Sigurohu të jesh i përgatitur dhe gati për t'u përfshirë në diskutim. Mos qëndro në heshtje duke lexuar thjesht skenarin.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 3.7

RINGJALLJA

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: LUKA 24:1-12

VARGJET KYÇ:

Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve.

1 e Korintasve 15:3-4

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

NËSE JEZUSI THJESHT JETOI NJË JETË TË MIRË DHE VDIQ SI NJË MARTIR FETAR, ATËHERË KJO DO TË ISHTE NJË HISTORI TRAGJIKE. Nëse ringjallja nuk do të kishte ndodhur kurrë, atëherë gjithçka në lidhje me krishterimin është harxhim kohe. Por NDODHI! Tri ditë më vonë, Jezu Krishti u ngrit nga vdekja. Pas vdekjes së Tij, Jezusi ishte shtrirë në varr të huaj. Një gur gjigand u vendos para hyrjes së varrit për ta mbyllur, por guri u zhvendos. Dy prej miqve të Jezusit erdhën ta lyenin me erëza trupin e Tij. Ata vunë re që guri ishte zhvendosur dhe engjëjt i përshëndetën duke i lajmëruar se Jezusi nuk është i vdekur, por Ai është i gjallë! Jezusi është i gjallë!

Kjo nuk është një histori tragjike, por një shpallje e fuqishme e shpresës për botën. Emanuel, i Vajosuri i Perëndisë shpëtoi njerëzimin dhe tashmë mposhti vdekjen dhe mëkatin përgjithmonë. Jemi shpëtuar, në Krishtin, jemi çliruar! Në Krishtin mund të përjetojmë plotësinë e jetës. Perëndia ka fituar! Ai ka shfaqur planin e Tij të shpengimit përgjatë historisë. Nga Noeu te Davidi, Perëndia ka pasur gjithmonë në plan të na shpëtojë, të na çlirojë dhe të na rikthejë tek Ai.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Jezusi u vendos në një varr të huaj.
- Studentët do të dinë se Jezusi mposhti vdekjen dhe mëkatin kur u ngrit nga varri.
- Studentët do të dinë se për shkak të ringjalljes tashmë njeriu mund të rivendosë marrëdhënien me Perëndinë.

FJALË KYÇ: Shpengim: riblerja e diçkaje që kishte humbur, duke paguar shpërblimin e kërkuar.

MENDIM KYÇ: Jezusi u ngrit nga varri fitimtar.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Përgatitu (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 83, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Të shkojmë te banka (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 99, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Kohë me të moshuarit. Bëj një vizitë me studentët e tu në një azil për të moshuarit. Kaloni kohë me ta dhe luani lojëra. Inkurajoji studentët të çmojnë kohën që kalojnë duke u shërbyer atyre që janë më të moshuar. Thuaji studentëve t'u kërkojnë atyre t'u tregojnë histori apo t'u japin këshilla të mençura. Këto investime në kohë do të bëjnë që studentët të kuptojnë vlerën e çdo faze të jetës dhe gjithashtu do të inkurajojë ata që janë më të moshuar.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të tregonin historinë e tyre të preferuar të rikthimit të personazhit kryesor dhe përse ishte kjo historia e preferuar. Ndaj edhe ti tënden.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGJET KYÇ:

Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve.

1 e Korintasve 15:3-4

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: LUKA 24:1-2

JEZUSI U VARROS.

Tani ishte një burrë me emër Jozef, që ishte anëtar i sinedrit, njeri i drejtë dhe i mirë; ai nuk kishte miratuar vendimin dhe veprimin e të tjerëve. Ai ishte nga Arimatea, qytet i Judesë dhe priste edhe ai mbretërinë e Perëndisë. Ai iu paraqit Pilatit dhe kërkoi trupin e Jezusit. Dhe, pasi e zbriti poshtë nga kryqi, e mbështolli në një çarçaf dhe e vuri në një varr të gërmuar në shkëmb, ku ende nuk ishte varrosur asnjeri.

Luka 23:50-53

JEZUSI U NGRIT NGA VDEKJA.

Ne, pra, u varrosëm me të me anë të pagëzimit në vdekje, që, ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim në risinë e jetës. Sepse, nëse u bashkuam me Krishtin në një vdekje të ngjashme me të tijën, do të jemi edhe e ringjalljes së tij, duke ditur këtë: se njeriu ynë i vjetër u kryqëzua me të, që trupi i mëkatit mund të jetë anuluar dhe që ne të mos i shërbejmë më mëkatit. Në fakt, ai që ka vdekur është shfajësuar nga mëkati.

Tani nëse vdiqëm me Krishtin, ne besojmë gjithashtu që do të jetojmë me të, duke ditur se Krishti, që u ringjall prej së vdekurish, nuk vdes më; vdekja s'ka më pushtet mbi të. Sepse në atë që vdiq, vdiq për mëkatin një herë e për gjithmonë; por në atë që rron, rron për Perëndinë. Kështu edhe ju, konsideroheni veten të vdekur për mëkatin, por të gjallë për Perëndinë, në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Romakëve 6:4-11

JEZUSI FITON! PO ASHTU DHE NE)

Qoftë bekuar Perëndia edhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, i cili me anë të mëshirës së tij të madhe na rilindi për një shpresë të gjallë me anë të ringjalljes së Jezu Krishtit prej së vdekurish, për një trashëgim të paprishshëm, të panjollë dhe të pafishkur, që është ruajtur në qiejt për ju, që nga fuqia e Perëndisë me anë të besimit jeni të ruajtur, për shpëtimin gati për t'u zbuluar në kohët e fundit.

1 e Pjetrit 1:3-5

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Uau! Çfarë gjëje të mrekullueshme dhe të pabesueshme ka bërë Perëndia për ne! Si mund të mos e adhurojmë Atë? Si aplikim të fundit për këtë mësim, organizo një kohë adhurimi me studentët e tu. Mund të marrësh grupin e adhurimit apo vetëm një person me kitarë. Jepu studentëve një mundësi për të shprehur atë që ndjejnë për Perëndinë dhe për ta adhuruar për atë që Ai ka bërë. Bëje dhe ti këtë gjë! Adhuroje Atë! Sepse Jezusi, IiVajosuri i Perëndisë nuk është i vdekur, Ai është i GJALLË!

FJALË KYÇ:

Shpengim: riblerja e diçkaje që kishte humbur, duke paguar shpërblimin e kërkuar.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 3.7 mësuam se Jezusi u ngrit fitimtar nga varri.

DITA 3

LEXO: GJONI 20: 1-7

Jezusi nuk është më. Maria Magdalena vrapon te Simon Pjetri dhe i tregon atij se varri është bosh. Jezusi nuk ishte aty. Dishepujt vrapuan te varri. Ato donin ta shihnin varrin bosh me sytë e tyre. Të gjitha provat ishin aty, mbulesat e varrimit ishin aty, por gjëja më e rëndësishme ishte mbulesa që ishte rreth kokës së Jezusit, e palosur mirë dhe e ndarë nga gjithçka tjetër.

SHTJELLOJMË:

A e beson se ringjallja ndodhi? Pse po ose jo? Dishepujt vrapuan te varri për të parë. Ku po vrapon ti për të gjetur përgjigjet?

DITA 4

LEXO: GJONI 20:8-10

Dishepulli tjetër shkon te varri. Shkrimi thotë se ai pa dhe besoi. Ata ende nuk e kishin kuptuar nga Shkrimi se Jezusi duhej të ngrihej prej së vdekuri. Ka periudha në jetën tonë kur nuk i kemi të gjitha përgjigjet. Kur bëhet fjalë për jetët tona shpirtërore, ne mund të besojmë, por jo të kuptojmë plotësisht se çfarë ndodh (Gjoni 20:29).

SHTJELLOJMË:

A duhet të shoqërohet gjithmonë besimi me kuptim të plotë të asaj që Perëndia bën? Çfarë je i gatshëm të pranosh dhe besosh pa marrë shpjegim të plotë nga Perëndia?

DITA 5

LEXO: GJONI 20:11-16

Maria ishte te varri duke qarë dhe e mbushur me hidhërim. Pastaj Jezusi u shfaq, por Maria nuk e njohu. Shiko, ne e kemi shumë problem ta njohim Krishtin kur zemrat tona janë të përqendruara në rrethanat përreth nesh. Shumë njerëz ishin aq të hidhëruar nga vdekja e tmerrshme e Jezusit dhe nga vajtimi për Të, saqë nuk e kuptuan kur u ngrit nga varri.

SHTJELLOJMË:

A je përqendruar më shumë te rrethanat e jetës tënde se sa te ajo që Perëndia ka premtuar në Fjalën e Tij? Përshkruaj një rast kur je përqendruar tek e vërteta e Fjalës së Perëndisë dhe jo te problemet apo vështirësitë.

DITA 6

LEXO: GJONI 20:17-18

Maria po mbahej te Jezusi me gjithçka kishte, aq shumë saqë Jezusi i tha të mos e prekte. Jezusi kishte një mision për Marinë. Jezusi ka një mision të ngjashëm, edhe për ty.

SHTJELLOJMË:

Shkruaj emrin e një personi që duhet të dëgjojë këtë javë lajmin e mirë të vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së Jezusit. Si mendon t'i flasësh për Jezusin këtë javë?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Nuk gjej dot kohën

Studentët i kanë orët e tyre të mbushura plot. Nëse disa vijnë në grup dhe nuk janë përgatitur, inkurajoje grupin të kalojë një kohë agjërimi. Agjërimi është praktika e të qëndruarit pa ushqim për disa ditë, për ta përqendruar mendjen te Perëndia, lutje apo një praktikë specifike shpirtërore që nderon Perëndinë. Studentët e tu mund të agjërojnë edhe nga teknologjia, media sociale, televizori etj., pra, nga çdo gjë që rrëmben kohën e tyre. Bëje këtë si grup me studentët e tu. Nëse i sfidon të kalojnë më shumë kohë me Perëndinë, sfidoje edhe veten. Koha për Perëndinë nuk krijohet vetë. Ti (edhe ata) duhet të bëni zgjedhje për ta bërë atë marrëdhënie prioritet.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Kapitulli Tre: Përsëritje//Shpengimi

PJESËT KRYESORE TË SHKRIMIT: ZANAFILLA 6-8, ZANAFILLA 22; EKSODI 6:2-13; 2 E SAMUELIT 7:8-16; GJONI 1:9-17; LUKA 23:26-49; LUKA 24:1-12

VARGJET KYÇ: *Zanafilla 7:15; Zanafilla 22:13–14; Eksodi 6:6; Isaia 9:7; Gjoni 1:14, 17; Hebrenjve 9:15; 1 e Korintasve 15:3–4*

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

NË KAPITULLIN E DYTË GJITHÇKA SHKOI KEQ! Njeriu shkatërroi marrëdhënien e përsosur që Perëndia kishte krijuar. Si mund të kthehemi në gjendjen e mëparshme? Perëndia ka një plan. Te Noeu, ne pamë se Perëndia shpëtoi një mbetje të vogël të njerëzve nga përmbytja globale dhe nga gjykimi i Tij për mëkatin dhe ligësinë e njerëzve. Tek Abrahami pamë njeriun që Perëndia përdori për të bekuar gjithë kombet e tokës. Perëndia i kërkoi të ofronte birin e tij të vetëm si sakrificë. Abrahami u bind me besnikëri dhe Perëndia nuk lejoi që ai të vriste birin e tij, Isakun, por siguroi një sakrificë në vend të tij. Perëndia dha Birin e Tij të vetëm si sakrifica përfundimtare për mëkatet tona. Te Moisiu, Perëndia përdori këtë njeri për të nxjerrë popullin e Tij nga skllavëria e mëkatit. Perëndia përdori vdekjen e Jezusit për të na çliruar nga zinxhirët dhe skllavëria e mëkatit. Te Davidi pamë një grimcë të pamjes së sundimit dhe mbretërimit të Krishtit. Froni i Davidit do të zgjasë përgjithmonë dhe tashmë Krishti është ulur në atë fron. Pastaj diçka e madhe ndodhi. Perëndia erdhi të jetonte me ne. Ai erdhi të ishte Emanuel, Perëndia me ne. Ai lindi për të vdekur, Krishti vdiq për mëkatet tona në kryq. I gjithë zemërimi i Perëndisë ra mbi Të. Mund të ishte vetëm Jezusi sepse Ai është i përsosur, që do të thotë se pagesa për mëkatet tona do të jetë e përhershme. Me vdekjen e Tij...U krye! Pastaj vjen pjesa më e bukur e historisë, Jezusi nuk është i vdekur si të gjithë drejtuesit e tjerë fetarë të historisë. Ai është i gjallë! Ai u ngrit nga varri tri ditë më vonë, duke mposhtur mëkatin dhe vdekjen. Jezusi na ka çliruar. Ai na ribleu! Jezusi ka fituar!

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të përsërisin shtatë mësimet e fundit.
- Studentët do të përsërisin vargjet, mendimet dhe fjalët kyç të shtatë mësimeve të fundit.
- Studentët do të përmbledhin shtatë mësimet e fundit në një përmbledhje të vetme.

FJALËT KYÇ: Shpëtuar, sakrificë, çlirim, mbretëri, Emanuel, Krishti, shpengim

MENDIMET KYÇ: (Shih çdo mësim)

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Gjatë shtatë javëve të fundit studentët kanë pasur lojëra të ndryshme. Shiko seksionin 'Vlerësoje' dhe kërko një lojë të cilën studentët e kanë shijuar shumë dhe luajeni sërish. Nëse njëri nga projektet e shërbesës ka pasur më shumë ndikim, merrni pak kohë për të ndarë për të. Kërkoju studentëve të ndajnë një dëshmi se si ndikoi te ta kjo eksperiencë.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët e tu kanë mësuar shumë për shpengimin e njeriut. Ata kanë mësuar disa fjalë kyç dhe disa vargje të njohur apo të rinj. Kërkoju studentëve ta fillojnë këtë përsëritje duke treguar se si i ka prekur ky kapitull. Nëse grupi është i dhënë pas artit mund t'i përmblidhni shtatë mësimet në një dramë apo skeç ku tregoni përmbledhjen e të shtatë mësimeve.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

MËSIMI 3.1

Vargu kyç: *Ata erdhën te Noeu në arkë, dy nga dy, prej çdo mishi që ka frymë jete. (Zanafilla 7:15)*

Fjalë kyç: I shpëtuar: ruajtur nga rreziku apo vdekja

Mendimi kyç: Noeu ndërtoi një arkë të projektuar nga Perëndia, si mënyra e vetme për të shpëtuar njerëzimin. Po ashtu, Jezusi është e vetmja mënyrë për t'u shpëtuar.

MËSIMI 3.2

Vargu kyç: *Atëherë Abrahami ngriti sytë dhe shikoi; dhe ja prapa tij një dash i zënë për brirësh në një kaçube. Kështu Abrahami shkoi, mori dashin e tij dhe e ofroi si sakrificë në vend të të birit. Dhe Abrahami e quajti këtë vend Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: "Do të furnizohet mali i Zotit". (Zanafilla 22:13-14)*

Fjalë kyç: Sakrificë: humbja e diçkaje shumë të vlefshme për hir të diçkaje që konsiderohet të ketë më shumë vlerë.

Mendimi kyç: Perëndia siguroi sakrificën për Abrahamin në vend të birit të tij Isakut. Perëndia siguroi një sakrificë për njerëzimin duke dërguar Birin e Tij të vetëm, Jezusin.

MËSIMI 3.3

Vargu kyç: *Prandaj u thuaj bijve të Izraelit: "Unë jam Zoti; do t'ju heq nga punët e rënda që ju kanë imponuar Egjiptasit, do t'ju çliroj nga skllavërimi i tyre dhe do t'ju çliroj me krah të shtrirë dhe ndëshkime të mëdha. (Eksodi 6:6)*

Fjalë kyç: I shpëtuar: ruajtur nga rreziku apo vdekja.

Mendimi kyç: Noeu ndërtoi një arkë të projektuar nga Perëndia, si mënyra e vetme për të shpëtuar njerëzimin. Po ashtu, Jezusi është e vetmja mënyrë për t'u shpëtuar.

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

•

•

•

MËSIMI 3.4

Vargu kyç: *Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive. (Isaia 9:7)*

Fjalë kyç: Mbretëri: një shtet apo qeveri që ka një mbret apo mbretëreshë në krye.

Mendimi kyç: Froni i Davidit do të jetë i qëndrueshëm përjetë. Jezu Krishti është Mbret i Mbretërve që sundon dhe mbretëron në fronin e Davidit.

MËSIMI 3.5

Vargu kyç: *Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit. (Gjoni 1:14, 17)*

Fjalë kyç: Emanuel: Perëndia me ne

Mendimi kyç: Jezusi u bë mish dhe banoi ndër ne.

MËSIMI 3.6

Vargu kyç: *Për këtë arsye, ai është ndërmjetësi i Besëlidhjes së re që, me anë të vdekjes që u bë për shpërblimin e shkeljeve që u kryen gjatë Besëlidhjes së parë, të thirrurit të marrin premtimin e trashëgimisë së amshuar. (Hebrenjve 9:15)*

Fjalë kyç: Krishti: I Vajosuri

Mendimi kyç: Jezusi është Krishti, i Vajosuri i Perëndisë, që heq mëkatin e njerëzimit. Ai është Shpëtimtari i premtuar, sakrifica e përsosur për mëkatet tona.

MËSIMI 3.7

Vargu kyç: *Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve. (1 e Korintasve 15: 3-4)*

Fjalë kyç: Shpengim: riblerja e diçkaje që kishte humbur, duke paguar shpërblimin e kërkuar.

Mendimi kyç: Jezusi u ngrit nga varri fitimtar.

SHËNIME:

FILLONI:

- Cila gjë apo koncept të ka mbetur në mendje gjatë shtatë javëve të fundit?
- Përse është i rëndësishëm për ty ky koncept?

JAVA 1

LEXO: ZANAFILLA 7:15

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Përse është e rëndësishme të dimë se Perëndia e mbylli derën e arkës? Çfarë kuptimi ka ky fakt?

JAVA 2

LEXO: ZANAFILLA 22: 13-14

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Ku ngjason historia e Abrahamit dhe Isakut me atë të Perëndisë Atë dhe Jezu Krishtit?

JAVA 3

LEXO: EKSODI 6:6

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Si na çliroi Jezusi nga mëkatet tona?

JAVA 4

LEXO: ISAIA 9:7

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Përse është e rëndësishme që Jezusi është ulur në fronin e Davidit? Çfarë kuptimi ka ky fakt?

JAVA 5

LEXO: GJONI 1:14, 17

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Çfarë ndryshimi sjell fakti që Perëndia erdhi të banonte me ne?

JAVA 6

LEXO: HEBRENJVE 9:15

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· Përse duhet të vdiste Jezusi? Përse nuk mund të ishte dikush tjetër?

JAVA 7

LEXO: 1 E KORINTASVE 15:3-4

SHTJELLOJMË:

· Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.

· A beson në ringjallje? Përse është kaq e rëndësishme?

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

MËSIMI 4.1

NGJITJA

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
VEPRAT 1:6-12

VARGU KYÇ:

Mbasi i tha këto gjëra, ndërsa ata po e vështronin, u ngrit lart; dhe një re e përfshiu dhe ua hoqi prej syve të tyre.

Veprat 1:9

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

JEZUSI U NGRIT PREJ SË VDEKURI! A E IMAGJINON DOT SA JANË GËZUAR DISHEPUJT?

Miku i tyre më i mirë, mësuesi i tyre, Shpëtimtari i tyre është gjallë. Kjo është një kohë ngazëlluese për ta. Megjithatë gjërat kanë filluar të bëhen interesante. E gjithë bota do të përmbyset dhe Jezusi ka një punë për dishepujt. Jezusi ka edhe disa gjëra që duhet t'i bëjë vetë, Ai do të shkojë të përgatisë një vend për ne. Për sa i përket dishepujve, Ai do që ata ta ndajnë këtë lajm të mirë me gjithë botën. Jezusi ka bërë kaq shumë për ta, Ai ka qenë mentori i tyre. Dishepujt kanë kaluar kaq shumë gjëra me Jezusin. Ata kanë kaluar kohë me Të, por tani erdhi koha që ata ta shpërndajnë shërbesën e Krishtit nëpër botë. Jezusi do t'i lërë. Ky moment, i quajtur ngjitja, është i bukur dhe i shëmtuar në të njëjtën kohë. Nga njëra anë, miku i dishepujve do t'i lërë. Megjithatë, nga ana tjetër, Jezusi premtoi se do të vinte një ndihmë për ta dhe ata nuk do të ishin vetëm. Ai gjithashtu u dha një detyrë të veçantë në urdhërimin e madh. Këto janë kohëra emocionuese për ta. E tani, Jezusi do të shkojë në qiell, pranë Atit dhe lajmi i mirë është se një ditë Ai do të kthehet! Të gjithë ne kemi një punë për të bërë deri atëherë, duhet të ndajmë lajmin e mirë të vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së Jezusit me këdo.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Jezusi la pas dishepujt e Tij.
- Studentët do të dinë se Jezusi u ngjit në qiell dhe është me Atin.
- Studentët do të dinë se Jezusi do të kthehet.

FJALË KYÇ: Ngjitje: ngritje

MENDIM KYÇ: Jezusi u ngrit në qiell dhe përkohësisht i la dishepujt me një mision, të ndanin ungjillin nëpër botë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Në lajme (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 56, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Rreth me litar (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 79, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Duhet t'i shërbesh dikujt! Ndoshta grupi yt e bën këtë gjë. Nëse është ashtu, është diçka e mrekullueshme! A i shërbejnë studentët e tu grupeve më të vogla? Ndoshta ke disa studentë drejtues që shërbejnë dhe kjo është e mrekullueshme. Nëse jo, inkurajoji studentët vazhdimisht të qëndrojnë pranë drejtuesve të rritur. Jepu atyre mundësi t'u shërbejnë atyre që janë më të rinj se ata. Mund të jenë ndihmë e madhe për grupin e drejtuesve. Dishepujt nuk ishin thjesht në një shkollë me Jezusin, por Jezusi u mësoi atyre shumë gjëra dhe ata gjithashtu përjetuan shumë të tilla duke qëndruar me Të. Dishepujt e panë Jezusin çdo ditë, ata panë me sytë e tyre çfarë bënte dhe nuk bënte Jezusi. Ata panë si Ai fliste, hante, flinte etj. Jepu studentëve të tu mundësinë të qëndrojnë pranë atyre që shërbejnë që të mund të mësojnë dhe ndoshta një ditë të marrin të njëjtën përgjegjësi.

Për më shumë informacione për ndërveprimin e studentëve drejtues shih librin që mund të shkarkohet falas: *Awana Student Leaders: Who They Are, What They Do, How They Can Energize Your Ministry.*

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të tregonin për mësuesin e tyre të preferuar dhe si janë ndjerë ditën e fundit të shkollës duke ditur se mund të mos e shihnin më kurrë. Nëse është e mundur, fto një mësues apo mentor që ka pasur ndikim të madh në jetën tënde dhe kërkoji të ndajë me studentët e tu rëndësinë e të pasurit një mentor/mësues në jetën e tyre. Kjo do të hapë një dritare që do t'i lidhë studentët me botën tënde, ndërkohë që i inkurajon të kërkojnë mentorë për veten e tyre.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGU KYÇ:

Mbasi i tha këto gjëra, ndërsa ata po e vështronin, u ngrit lart; dhe një re e përfshiu dhe ua hoqi prej syve të tyre.

Veprat 1:9

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: VEPRAT 1:6-12

JEZUSI DËRGOI DISHEPUJT E TIJ NËPËR BOTË.

Pastaj të njëmbëdhjetë dishepujt shkuan në Galile, në atë mal që u kishte caktuar Jezusi dhe, kur e panë, e adhuruan; por disa dyshuan. Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: "Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen".

Mateu 28:16-20

JEZUSI U NGRIT NË QIELL.

Zoti Jezus, pra, mbasi u foli, u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë.

Marku 16:19

Mbasi i tha këto gjëra, ndërsa ata po e vështronin, u ngrit lart; dhe një re e përfshiu dhe ua hoqi prej syve të tyre.

Veprat 1:9

JEZUSI DO TË KTHEHET!

Dhe, si ata po i mbanin sytë e ngulitur në qiell, ndërsa ai po largohej, ja dy burra në rroba të bardha iu paraqitën atyre, dhe thanë: "Burra Galileas, pse qëndroni e shikoni drejt qiellit? Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell".

Veprat 1:10-11

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Bëj diçka! Krishti ka shkuar të përgatisë një vend për ne, por Ai gjithashtu na ka dhënë një detyrë deri në kthim të Tij. Ashtu siç dërgoi dishepujt, Ai na dërgon edhe ne. Ne duhet të shkojmë nëpër botë dhe të mësojmë gjithçka që Jezusi ka urdhëruar, gjithashtu ne duhet të pagëzojmë. Çfarë po bën ti tani për të arritur kombet për Krishtin? Ka shumë mënyra me anë të të cilave mund të përfshihesh në shpërndarjen e ungjillit nëpër kombe. Ja disa mënyra për t'u përfshirë tani:

- **Lutje —** Mund të lutesh për misionarët që kisha jote mbështet. Lutja është e rëndësishme! Ata që janë në fushëbetejë kanë nevojë për lutjet tona të vazhdueshme që ta çojnë ungjillin te njerëzit e paarritur. Ata gjithashtu përjetojnë ndodhi të ndryshme, të papritura që Ati i ka lejuar. Ji një luftëtar lutjeje për kishën tënde dhe për ata që çojnë ungjillin nëpër kombe.
- **Financat —** Ti mund të ndihmosh në ngritjen e mbështetjeve për misionarët. Shumë misionarë duhet të ngrenë fonde që të mund të vazhdojnë me punën që Perëndia u ka besuar. Ti mund të bashkëpunosh me ta duke i ndihmuar të ngrenë fonde. Mund të kontribuosh përmes fondeve që ti vetë ngre. Mund të bësh shitje në oborrin e shtëpisë dhe të gjitha fondet t'i japësh për misionarët. Mund të mos pish kafen tënde të preferuar apo ushqimin tënd të preferuar për një muaj. Ka shumë mënyra se si ti mund të ndihmosh në ngritjen e fondeve që puna e Perëndisë të vazhdojë.
- **Shko! —** Ti mund të shkosh. Lutu që Perëndia të të dërgojë. Mendo për verën e ardhshme dhe si mund t'i përdorësh javët që ke pushim nga shkolla për të ndihmuar një misionar. Provo si është t'i shërbesh Zotit në fushën e misionit. Shumë misionarë mirëpresin skuadra gjatë verës për t'i ndihmuar në mënyra të ndryshme. Sfidoje veten që, para se të kesh mbaruar gjimnazin, të kesh kaluar disa javë në fushën e misionit.

FJALË KYÇ:

Ngjitje: ngritje

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.1 mësuam se Jezusi u ngrit në qiell dhe përkohësisht u la dishepujve të Tij misionin për të ndarë ungjillin me botën.

DITA 3

LEXO: VEPRAT 1:6-7

Pyetja e dishepujve me shumë mundësi duket se është hapi logjik i radhës. Jezusi kishte vdekur për mëkatet tona dhe ishte ngritur prej së vdekurish. Çfarë e pengonte që të vendoste mbretërinë në atë kohë? Përgjigjja e Jezusit u kujton dishepujve se nuk janë ata që e përcaktojnë planin e Tij. Ky është plani i Perëndisë dhe Ai do të bëjë gjithçka sipas kohës së Vet (Veprat 3:21).

SHTJELLOJMË:

A je lodhur duke pritur që Perëndia të bëjë diçka që ti e do? Përshkruaj një rast kur je lutur për diçka dhe Perëndia nuk u përgjigj siç ti shpresoje.

DITA 4

LEXO: VEPRAT 1:8

Fjalët e fundit të Jezusit drejtuar dishepujve ishin që ata kishin një mision dhe se do të merrnin fuqi nga Fryma e Shenjtë për ta përmbushur atë mision. Dishepujt duhet të ishin dëshmitarë për Jezusin. Dëshmitar është një person që tregon historinë e diçkaje që ka përjetuar. Si këta dishepuj, edhe ne jemi të thirrur për të treguar historitë e gjërave që Perëndia ka bërë.

SHTJELLOJMË:

Me kë e ke më të vështirë të ndash besimin tënd, me ata që janë afër teje apo me ata që takon më rrallë? Përse mendon se ndodh kështu? Çfarë mendon se do të ndodhte nëse do ti kërkoje ndihmë Perëndisë për të ndarë besimin tënd me të tjerët?

DITA 5

LEXO: VEPRAT 1: 9-11

Jezusi mbaroi bisedën me dishepujt dhe pastaj u mor në qiell nga Ati. Ai premtoi se do të kthehej. Engjëjt thanë se Ai do të kthehej në të njëjtën mënyrë siç u largua. Jezusi kurrë nuk bën një premtim që nuk mund ta mbajë. Patjetër që Ai do të kthehet.

SHTJELLOJMË:

Nëse do të ishe me dishepujt, a do të ndieje ngushëllim apo shqetësim për atë që engjëjt thanë? Si ndihesh ndërsa pret kthimin e Tij?

DITA 6

LEXO: VEPRAT 1:12

Gati... nisu! Misioni fillon. E gjithë bota do të përmbyset nga shërbesa e apostujve. Lajmi i mirë i ungjillit do të transformojë botën, do të prekë dhe do të ndikojë në çdo aspekt të jetës. Asgjë dhe askush nuk do të mbetet i njëjtë.

SHTJELLOJMË:

Si ndihesh në fillim të një projekti të madh? I emocionuar? I nervozuar? Shpjego.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Ji i ndërgjegjshëm për ndikimin tënd

Luka 6:40 thotë: *Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, madje çdo dishepull që ka mësuar do të jetë si mësuesi i vet.* Studentët e tu do të bëhen si ti. Nëse kalon mjaft kohë me studentët e tu do të fillosh të ndikosh tek ata. Ndikimi yt do të lërë gjurmë, ashtu si këmba lë gjurmë në beton. Kur betoni thahet, gjurma është e përhershme. Çfarë gjurme po lë te studentët e tu? Si po të ngjasojnë ty si ndjekës i Krishtit? A e kalon kohën më të madhe duke u përpjekur që ata të pëlqejnë atë që ti ke qenë apo atë që Perëndia ka transformuar? Ji i ndërgjegjshëm për ndikimin tënd dhe efektet e tij. Këta studentë janë shumë të punueshëm dhe elastikë. Gjërat që ti thua dhe bën, kanë ndikim të gjatë tek ata.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit



PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
VEPRAT 2:40-47

VARGU KYÇ:

Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje.

Veprat 2:42

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

KUR MENDOJMË PËR KISHËN, SHUMICA PREJ NESH IMAGJINON NDËRTESËN. Mendojmë për vendin ku shkojmë të dielave. Me shumë mundësi, nëse do të pyesje studentët e tu për gjënë e parë që u vjen në mendje kur thonë fjalën 'kishë', shumica do të mendonte për një strukturë fizike. Megjithatë, Shkrimi na thotë se kisha nuk është ndërtesa. Kisha është shumë më tepër se një ndërtesë e bërë nga njeriu. Tani kisha është mishërimi i mbretërisë së Perëndisë në botë. Kisha është paraqitje e shkurtër e asaj që do të jetë në përjetësi kur Krishti të kthehet. Është shumë e rëndësishme mënyra se si kisha funksionon dhe sillet. Jezusi ndau te predikimi në mal si do të jenë ata që i përkasin mbretërisë së Perëndisë, Ai foli për lumturitë. Këto lumturi janë pasaporta e një qytetari të mbretërisë së Perëndisë. Kur kalon te dogana në aeroport u dorëzon një dokument që është përfaqësuesi yt kombëtar te njerëzit e vendit specifik ku dëshiron të hysh. Mënyra si sillesh dhe të gjitha përgjegjësitë e të qenët qytetar i vendit tënd prezantohet në atë dokument. Në të njëjtën mënyrë, lumturitë janë ato që tregojnë se si duhet ta prezantojë kisha veten përpara botës. Edhe pse Jezusi nuk përmend specifikisht fjalën 'kishë' gjatë predikimit në mal, pritshmëritë dhe përgjegjësitë për ata që janë pjesë të mbretërisë së Perëndisë janë shprehur mjaft mirë. Si kishë, ne duhet të jemi dështmitarët besnik të Perëndisë, duke dhënë dështminë e së vërtetës së Fjalës së Perëndisë që ka kaluar nëpër breza. Kisha duhet të jetë një komunitet ku njerëzit ndajnë me njëri-tjetrin, plotësojnë nevojat dhe kujdesen për ata që janë përreth tyre. Kisha duhet të jetë e kundërta e egoizmit që gjendet në botë sot.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se thirrja e kishës është të jetë mishërimi i mbretërisë së Perëndisë në botë.
- Studentët do të dinë se kisha duhet të jetë dështmitare besnike.
- Studentët do të dinë se kisha funksionon si komunitet.

FJALË KYÇ: Kisha: i gjithë trupi i besimtarëve që shpallin besimin e tyre në Jezu Krishtin kudo në botë

MENDIM KYÇ: Perëndia e vendosi kishën që të përfaqësonte mbretërinë e Perëndisë këtu në tokë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-

KOHA _____

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë.

Loja 1 — Luftë me jastëk (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 71, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Scramble i heshtur (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 85, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Kush ka një nevojë specifike?– Studentët e tu kanë prejardhje të ndryshme. Është e lehtë të dalësh dhe të plotësosh nevojat e dikujt që nuk e njeh apo sapo e ke takuar. Është veçanërisht e lehtë kur përdor gjërat e dikujt tjetër për t'i plotësuar këto nevoja. Bëjeni praktikë të rregullt në grupin tuaj ndarjen e nevojave personale. Ndoshta dikush në grupin tënd ka nevojë për ndihmë me detyrat e shtëpisë dhe një student tjetër është i mirë në atë lëndë. Kalojmë shumë kohë duke hamendësuar se gjithçka shkon mirë ose që problemet e të tjerëve nuk janë problemet tona. Megjithatë, kështu funksiononte kisha e hershme. Përpiqu që gjithmonë të gjeni mënyra që studentët të përdorin dhuntitë e tyre për të plotësuar nevojat e njëri-tjetrit. Sfidoji ta bëjnë këtë gjë dhe tregoju si ta bëjnë. Kështu do të ndërtosh një mënyrë të menduari tek ta, e cila do të ketë ndikim të madh ndërsa rriten në kishë.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të tregonin pesë arsyet kryesore përse shkojnë në kishë. Bëj një listë në ekran apo në PowerPoint. Kërkoju studentëve të ndajnë listat e tyre me njëri-tjetrin. Bëj një listë kryesore të arsyeve të tyre pastaj krahasoje me listën te Veprat 2 që tregon arsyet përse kisha duhet të mblidhet bashkë. Çfarë ndryshon? Çfarë është njësoj?

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje.

Veprat 2:42

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: VEPRAT 2:40-47

KISHA DUHET TË MISHËROJË MBRETËRINË E PERËNDISË.

Sepse ashtu si trupi është një, por ka shumë gjymtyrë, dhe të gjitha gjymtyrët e të njëtit trup, megjithse janë shumë, formojnë një trup të vetëm, kështu është edhe Krishti.

1 e Korintasve 12:12

Ne, pra, bëhemi lajmëtarë për Krishtin, sikurse Perëndia të këshillonte nëpërmjet nesh; dhe ne ju këshillojmë juve për hir të Krishtit: Paqtohuni me Perëndinë!

2 e Korintasve 5:20

KISHA DUHET TË SHPALLË ME BESNIKËRI UNGJILLIN.

Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut".

Veprat 1:8

KISHA DUHET TË FUNKSIONOJË SI NJË KOMUNITET BIBLIK.

Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje.

Veprat 2:42

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

A po sillesh ti si kisha? Me çfarë e kalon shumicën e kohës grupi yt? Si është kisha jote në krahasim me kishën te Veprat 2? Ndonjëherë është e lehtë të shpërqendrohesh nga të gjitha gjërat që ndodhin në botë dhe në kishë. Kalendarët mbushen shumë shpejt me ngjarje dhe veprimtari argëtuese. Bashkësia me njëri-tjetrin është e rëndësishme dhe kisha e hershme e kishte këtë bashkësi. Ata hanin dhe luteshin së bashku, por kishte dhe diçka tjetër interesante mes tyre. Nuk ishin grup i mbyllur. Ata ftonin të tjerë që t'u bashkoheshin, nuk u ndanë veçmas për të formuar organizatën e tyre. Ata ndihmonin këdo që ishte në nevojë. Ja disa pyetje që mund t'u bësh studentëve dhe vetes.

1. Si ngjason grupi yt me kishën te Veprat 2? Si ndryshon?

2. A e kalojmë shumicën e kohës të përqendruar te vetja apo te të tjerët?

3. Gjërat që bëjmë a kanë bekime të menjëhershme për ne apo kërkojmë të bekojmë të tjerët më parë?

4. A është grupi ynë një vend ku kushdo mund të vijë dhe të ndihet i mirëpritur?

5. Si përpiqemi ne të ftojmë dhe mirëpresim njerëz të tjerë në grupin tonë?

FJALË KYÇ:

Kisha: i gjithë trupi i besimtarëve që shpallin besimin e tyre në Jezu Krishtin kudo në botë

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.2 mësuam se Perëndia e vendosi kishën si përfaqësuese të mbretërisë së Perëndisë këtu në tokë.

DITA 3

LEXO: VEPRAT 2:40-41

Tremijë njerëz vendosën besimin e tyre te Jezusi në ditën e Pentekostit duke shënuar kështu nisjen e Kishës. Kjo është rritje! Tremijë njerëz janë SHUMË për një ditë. Kisha pati një nisje shumë të mirë. Predikimi i Fjalës së Perëndisë ishte shumë i fuqishëm.

SHTJELLOJMË:

A beson se Perëndia mund të përdorë fjalët e tua për të arritur të tjerë me ungjillin? Cili person pranë teje ka nevojë të dëgjojë të vërtetën e ungjillit?

DITA 4

LEXO: VERAT 2:42, 46

Kisha e parë dëgjoi mësimin e apostujve, mësimet e Jezusit përmes njëkësve të Tij më të afërt. Që prej atëherë, ne kemi dëgjuar ato mësime. Kurrë nuk do të ndalojmë së mësuari. Ndonjëherë mund të mos na pëlqejë, por çdo ditë të jetës tënde mëson. Perëndia dëshiron që ne të njohim atë që Ai na ka shfaqur për veten në Fjalën e Tij (2 e Timoteut 3:16-17).

SHTJELLOJMË:

Si do të ishte besimi yt po të mos kishe mësimet e apostujve (Shkrimin)? Si do të ishte besimi yt pa ndihmën e mësuesve dhe drejtuesve të tu? Shpjego.

DITA 5

LEXO: VEPRAT 2:43-46

Besimtarët e hershëm ndanin gjithçka. Në kuptimin më të mirë, ata u bënë shembulli i komunitetit. Ata kërkonin interesin e të tjerëve, nuk mbanin gjë për vete, njiheshin se ishin altruistë, jepnin falas dhe me gëzim. Ata luteshin bashkë, hanin bashkë dhe adhuronin së bashku. Ishin një nga ato grupet që i sheh së bashku dhe ndjen dashurinë që kanë për njëri-tjetrin. Ata përfaqësonin mbretërinë e Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

Cilat janë disa gjëra që ti i ndan me besimtarët e tjerë? A lutesh me ta? A ha me ta? Si ndryshon një bashkësi besimtarësh nga një grup miqsh që nuk ndajnë besimin e tyre në Krishtin?

DITA 6

LEXO: VEPRAT 2:47

Kisha nuk ndërtohej në bazë të përpjekjeve njerëzore, por me fuqinë e Perëndisë. Ai i rriste në numër. Ai i bekonte. Ai kujdeset për kishën e TIJ. Prandaj kisha nuk dështon. Njerëzimi është thjesht administrator i saj. Perëndia vetë është në kontroll të kishës së TIJ.

SHTJELLOJMË:

Sa shpesh lutesh për kishën tënde? Për drejtuesit e kishës? Bëj një listë me drejtuesit e kishës për të cilët do të angazhohesh të lutesh duke filluar që nga tani.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Koha për një vakt

Ushqimet dhe tavolinat e shtruara kanë pasur gjithnjë efekt mahnitës te njerëzit. Mblidhi studentët rreth një tavoline me ushqim të mirë dhe do të kesh ndërveprim. Kisha e hershme mblidhej për të ngrënë së bashku. Ndryshoji pak gjërat në grup. Në vend që të uleni si zakonisht, ndrysho tavolinën. Mund të jetë një tavolinë kuzhine apo në tavolinën e një restoranti të afërt. Sigurohu të ketë mjaft ushqim në tavolinë dhe ftoji studentët të sjellin diçka për ta ndarë me të tjerët. Do të habitesh kur të shohësh se si ushqimi i mbledh njerëzit. Të ulesh vetëm në një karrige, nuk krahasohet me një vend në tavolinë. Lër vend në tavolinë për studentët, por edhe për miq të rinj.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 43

Sauli nga Tarshish

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT: VEPRAT 9:1-22

VARGU KYÇ:

Në këtë çast i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit; pastaj u ngrit dhe u pagëzua.

Veprat 9:18

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

FILLIMI I KOHËS SË KISHËS NUK ISHTE FUSHË ME LULE. Fillimet e krishterimit ishin shumë të vështira dhe shumë kisha u përballën me persekutime për shkak të besimit të tyre. Kisha u rrit me ritme të shpejta, por kishte gjithashtu frikë të vazhdueshme nga sulmet, sepse shumë njerëz nuk e mirëpritën besimin se Jezusi ishte i vajosuri i Perëndisë. Një njeri në veçanti i përndiqte të krishterët. Ai quhej Saul dhe ishte i preferuari i komunitetit të judenjve. Ishte trajnuar nga më të mirët. Ai i referohet vetes si hebre nga hebrenjtë (Filipianëve 3:5). Sauli ishte gati dhe ishte në rrugë të mirë për të siguruar status të lartë midis drejtuesve fetarë të kohës. Megjithatë, një ditë gjithçka ndryshoi për të. Sauli po udhëtonte në rrugën për në Damask, kur Jezusi e ndali në mes të rrugës.

Sauli u verbua nga një dritë e mrekullueshme për tri ditë. Jezusi u përball me Saulin dhe nga ky takim jeta e Saulit do të ndryshonte përgjithmonë. Jezusi sfidoi praktikat persekutuese të Saulit ndaj ndjekësve të Krishtit. Sytë e Saulit u hapën dhe Sauli u bë Pali. Ky takim që pati ishte aq transformues saqë ndryshoi edhe emrin e tij. Ai nuk është më Sauli. Sauli ka dalë në dritë me Krishtin dhe tashmë është Pal. Jezusi ndryshoi drejtimin e Palit atë ditë. Ai i dha atij një qëllim dhe drejtim të ri. Sauli rifitoi shikimin dhe ky ishte vetëm fillimi. Që prej atij momenti, udhëtimi i tij do të shkundë botën. Perëndia e nxori Saulin nga errësira në dritë. Ai e sheh të gjithë pamjen e jetës sonë nga fillimi në fund. Perëndia e di si është shkruar historia jonë sepse Ai vetë e ka shkruar. Pali do të nxirrte të tjerë nga errësira dhe shkatërrimi i mëkatit në dritën dhe të vërtetën e ungjillit të Jezu Krishtit.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Sauli nga Tarshishi i persekutonte të krishterët.
- Studentët do të dinë se Sauli përjetoi një moment transformues në rrugën për në Damask.
- Studentët do të dinë se Perëndia e ndryshoi Saulin në Pal.

FJALË KYÇ: Konvertim: ndryshimi i plotë i besimit dhe personit

MENDIM KYÇ: Krishti na jep sy të rinj për të parë. Pali pati një takim jetëndryshues me Krishtin gjatë rrugës për në Damask.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Mos i humb gurët (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 36, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Gara me karamele (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 25, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Shërbejini të gjithëve. Me shumë mundësi, kisha jote nuk është e vetmja në komunitet. Duhet të ketë të paktën një apo dy të tjera. Ato mund të mos bëjnë gjërat që ti bën apo të besojnë të njëjtat gjëra si ti ato kanë nevoja dhe kjo është mundësi që studentët e tu t'u shërbejnë atyre. Kontakto me disa nga kishat vendase në zonën tënde dhe shih nëse ka mundësi që studentët e tu të plotësojnë nevojat e tyre. Kjo është një mundësi e mirë edhe për bashkimin e kishave në një projekt shërbese. Shih nëse ka ndonjë mënyrë që grupet të bashkëpunojnë për t'i shërbyer më shumë njerëzve. Mund të kontaktosh edhe për bashkëpunim me një besim tjetër gjithashtu. Mos kërko t'u shërbesh vetëm kishave të tjera, por kërko mënyra për t'i shërbyer edhe atyre që kanë besim tërësisht tjetër.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet t'u përgjigjeshin disa pyetjeve që do t'i ndihmonin të përmblidhnin dëshminë e tyre. Duhet t'u përgjigjeshin këtyre pyetjeve:

1. *Si ishte jeta jote para se të njihje Krishtin?*
2. *Çfarë përjetove kur ftove Krishtin në jetën tënde?*
3. *Si ka qenë jeta jote që atëherë?*

Ndaj me studentët edhe përgjigjet e tua për këto pyetje dhe jepu kohë edhe atyre të ndajnë.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Në këtë çast i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit; pastaj u ngrit dhe u pagëzua.

Veprat 9:18

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: VEPRAT 9:1-22

SAULI PERSEKUTONTE TË KRISHTERËT.

Por Sauli po shkatërronte kishën: hynte shtëpi më shtëpi, merrte me vete burra dhe gra dhe i fuste në burg.

Veprat 8:3

Ndërkaq Sauli, duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit, shkoi te kryeprifti, dhe kërkoi nga ai letra për sinagogat e Damaskut, me qëllim që, po të gjente ndonjë ithtar të Udhës, burra o gra, të mund t'i sillte të lidhur në Jeruzalem.

Veprat 9:1-2

SAULI PATI NJË TAKIM ME JEZUSIN.

Por ndodhi që, ndërsa po udhëtonte dhe po i afrohej Damaskut, befas rreth tij vetëtiu një dritë nga qielli. Dhe, si u rrëzua përtokë, dëgjoi një zë që i thoshte: "Saul, Saul, përse më përndjek?" Dhe ai tha: "Kush je, Zot?" Dhe Zoti tha: "Unë jam Jezusi, që ti e përndjek; është e rëndë për ty të godasësh me shkelm kundër gjembave."

Veprat 9:3-5

JEZUSI I DHA SAULIT NJË MISION TË RI.

Por Zoti i tha: "Shko, sepse ai është vegla që unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim përpara johebrenjve, mbretërve dhe bijve të Izraelit."

Veprat 9:15

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Historia jote është e fuqishme. Historia si njohe Krishtin mund të ketë ndikim të madh te miqtë e tu. A ke menduar ndonjëherë për historinë tënde (p.sh., dëshmia jote)? Disa prej jush mund ta konsiderojnë historinë e tyre të konvertimit të qetë. Shpesh mendojmë se historia e shpëtimit është e fuqishme vetëm nëse personi është shpëtuar nga një varësi e një kohe të gjatë apo nga një mëkat i thellë dhe i errët. Megjithatë, për një pjesë të mirë, historia e shpëtimit është e qetë. Ndoshta je shpëtuar në kampin e fëmijëve apo kur ke qenë 5 vjeç në dhomën tënde me mamin dhe babin. Megjithatë, pavarësisht sa i qetë duket përjetimi yt mund të përdoret në mënyrë të fuqishme. Ja disa pyetje rreth të cilave mund të mendoni dhe veproni gjatë kësaj jave.

1. Shkruaje historinë tënde! Praktikoje dhe provoje. Kush duhet ta dëgjojë historinë tënde?

2. Lavdëro! A ke ndalur ndonjëherë gjithçka për të lavdëruar Perëndinë për atë që Ai ka bërë për të të kthyer tek Ai?

FJALË KYÇ:

Konvertim: ndryshimi i plotë i besimit dhe personit.

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.3 mësuam se Krishti na dha shikim të ri. Pali pati një takim me Krishtin në rrugën për në Damask që ndryshoi gjithë jetën e tij.

DITA 3

LEXO: VEPRAT 9: 1-3

Sauli e urrente kishën dhe gjithçka për të cilën ajo luftonte. Misioni i jetës së tij ishte të shkatërronte kishën, por pastaj ai u pushtua nga drita e Krishtit. Ai nuk mund të mohonte sytë e tij (ose mungesën e tyre). As ne nuk mundemi. Kur drita e Krishtit vjen në jetën tonë, ajo ekspozon gjithçka. Ne nuk mund të fshihemi prej saj. Çdo copëz e jona shfaqet plotësisht përpara Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

A të kujtohet një kohë e jetës tënde pa Krishtin? A të kujtohet hera e parë që ke parë qartë të vërtetën e ungjillit? Përshkruaj përjetimin tënd.

DITA 4

LEXO: VEPRAT 9:4-7

Sauli dëgjon zërin e Perëndisë. Kur Perëndia i jep një urdhër Saulit, ai bindet. Zëri i Perëndisë ndryshon gjithçka. Kur Perëndia flet, gjërat ndodhin.

SHTJELLOJMË:

Cili pasazh i Fjalës së Perëndisë ka pasur më shumë ndikim te ti? Në çfarë mënyre ka ndikuar? Përse?

DITA 5

LEXO: VEPRAT 9:8-9

Pasi Perëndia e verboi, Sauli kaloi tri ditë në errësirë pa bukë dhe ujë (duket pak si Jona). Ndonjëherë Perëndia përdor kohët e errëta për të na shfaqur mëkatin tonë.

SHTJELLOJMË:

A ka përdorur ndonjëherë Perëndia diçka të keqe në jetën tënde për të treguar mëkatin tënd? Çfarë mësimi more?

DITA 6

LEXO: VEPRAT 9:17-22

Pasi Anania u lut për të, Sauli fitoi të parët përsëri. Ai filloi të shihte jetën dhe punën e tij më qartë. Perëndia i dha sy të rinj. Ai na i jep edhe ne gjithashtu. Ndryshimi është se me Saulin ishte e dukshme për të gjithë.

SHTJELLOJMË:

Si ka ndryshuar pikëpamja jote për botën që kur ke vendosur besimin tënd në Jezusin? Çfarë sheh me qartë tani? Shpjego.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Jashtë klasës

Ndonjëherë, gjatë vitit, kalo kohë jashtë ambientit të mësimit me studentët. Sigurohu të jesh në grup dhe kurrë vetëm për vetëm me një student. Është e rëndësishme të diskutosh me ta edhe brenda, edhe jashtë ambientit të zakonshëm mësimor. Nëse i takon vetëm në ambientin e mësimit, atëherë humbet shumë gjëra. Jezusi shkonte në vende të ndryshme me dishepujt e Tij. Dil me grupin për të pirë diçka, për të ngrënë një akullore apo diçka tjetër... thjesht gjej kohë për të folur e për të ndërtuar marrëdhënie. Nëse do ta bësh këtë gjë me studentët e tu do të kesh një përparësi gjatë kohës së diskutimit. Është e rëndësishme të ndërtosh marrëdhënie me studentët e tu jashtë kontekstit normal të grupit. Sigurohu t'i përfshish edhe në grupe më të vogla.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite—**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
FILIPIANËVE 3:8-14

VARGU KYÇ:

Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti.

Filipianëve 3:12

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

NË MËSIMIN E FUNDIT U NJOHËM ME PALIN DHE MËSUAM PAK RRETH HISTORISË DHE KONVERTIMIT TË TIJ. Pali është një shembull shumë i mirë për t'u përdorur në mësimin e ardhshëm, sepse ai e mori shpëtimin, por nuk kuptonte shumë gjëra. Pas takimit që pati në rrugën për në Damask, ai ndryshoi, por edhe jeta e Palit kishte rritje të vazhdueshme. Ai kishte marrë plotësinë e shpëtimit në gjakun e Krishtit që kishte paguar çmimin për mëkatin e tij. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ai sapo nisi një rrugëtim për të qenë gjithnjë e më i ngjashëm me Jezu Krishtin. Shumë prej studentëve të tu e kanë marrë dhuratën e jetës së përjetshme përmes vdekjes së Jezusit në kryq. Por edhe ti, edhe prindërit e tyre mund të dëshmoni se jeta e tyre ka nevojë për punë. Ka vend për rritje, për të mësuar dhe për të zbuluar më shumë për Krishtin dhe si mund të jenë më të ngjashëm me Të. Ky mësim përqendrohet në konceptin teologjik se besimi i tyre është diçka e pranishme, por ende e përsosur apo e plotësuar.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia i shpall mëkatarët jo fajtorë, por të drejtësuar për shkak të vdekjes së Jezusit si pagesë për mëkatet e tyre.
- Studentët do të dinë se procesi i rritjes shpirtërore, që ndodh kur besimtarët i japin Frymës së Shenjtë kontrollin e jetës së tyre, quhet shenjtërim.

FJALË KYÇ:

Shfajësim: Perëndia deklaron mëkatarët jo fajtorë, por të drejtësuar në bazë të vdekjes së Jezusit si shlyerje për mëkatet e tyre.

Shenjtërim: procesi i rritjes shpirtërore që ndodh ndërsa besimtarët ia japin kontrollin e jetës së tyre Frymës së Shenjtë

MENDIM KYÇ:

Jemi shpëtuar nga mëkatet tona dhe Perëndia na deklaron të shfajësuar. Megjithatë, arritja e ngjashmërisë me Krishtin është proces.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Librat e garës biblike (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 21, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Në zjarr (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 37, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Më e madhe nga ç 'mund të imagjinosh. Shumicën e kohës, përpjekjet tona për t'i shërbyer të tjerëve janë të sigurta, të mirëllogaritura dhe të planifikuara në detaje. Çfarë mund të bëjë grupi yt i studentëve duke u mbështetur tërësisht te Perëndia? A mund të mendoni për diçka të guximshme dhe të madhe që kërkon një hap besimi për t'u realizuar? Mblidhi studentët dhe lutuni që Perëndia t'ju dërgojë tek dikush për t'i shërbyer. Zgjeroje zonën përtej komunitetit tënd ose bashkëpuno me misionarë në pjesë të ndryshme të botës. Bëj një hap besimi, jo vetëm për gjërat e vogla, por krijo një eksperiencë ku studentët mund të mësojnë se ç'do të thotë t'i besosh Perëndisë për gjërat e mëdha që shkojnë përtej aftësive të tyre.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të përdornin hapësirën boshe në librin e tyre për të vizatuar se si e imagjinonin një udhëtim me Perëndinë dhe t'i përgjigjeshin pyetjes. Si do të ishte një udhëtim me Perëndinë? Filloje mësimin duke ndarë një eksperiencë tënden në udhëtim. A shkoi udhëtimi vaj? Apo kishte pengesa gjatë rrugës?

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGU KYÇ:

Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti.

Filipianëve 3:12

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: FILIPIANËVE 3:8-14

KRISHTI NA SHPËTON.

Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush.

Efesianëve 2:8-9

KRISHTI NA DEKLARON TË DREJTËSUAR.

Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë, me anë të të cilit edhe patëm, nëpërmjet besimit, hyrjen në këtë hir në të cilin qëndrojmë të patundur dhe mburremi në shpresën e lavdisë së Perëndisë.

Romakëve 5:1-2

KRISHTI DËSHIRON QË NE TË BËHEMI SI AI.

Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria.

1 e Thesalonikasve 4:3

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Fara dhe pemë — Mblidhi studentët dhe jepu dy shembuj. Në shembullin e parë tregoju një vazo me dhe, dhe një farë nën dhe. Kjo vazo është një shembull i besimit të tyre tani. Është e tashmja. Është i gjithë potenciali për t'u bërë një pemë është sa besimi i tyre. Besimi i tyre është aty, por nuk është pjekur ende. Ka vend për rritje ashtu siç në vazo ka vend për farën që të rritet. Në një vazo tjetër vendos një bimë apo një fidan që po rritet. Bëji studentëve pyetjet e mëposhtme:

1. A e ndihmoi diçka këtë bimë që të rritej?
2. Çfarë duhet të bëj që ta vras këtë bimë?
3. A ka ngjashmëri mes teje dhe bimës?
4. Cilat janë kushtet optimale që ti të rritesh në Krishtin?
5. Sa prej jush janë të kënaqur me të qenët thjesht një farë?
6. A sheh rritje në jetën tënde nëse kthen kokën te një vit më parë?

Mbaji të dyja vazot në një vend të dukshëm për studentët. Jepu studentëve përgjegjësinë për t'u kujdesur për to, për t'i ujitur dhe për t'i ndihmuar të rriten. Përfshije vazhdimisht bisedën në lidhje me rritjen e besimit të tyre dhe sa po rriten në ngjashmëri me Krishtin.

FJALË KYÇ:

Shfajësim: Perëndia deklaron mëkatarët jo fajtorë, por të drejtësuar në bazë të vdekjes së Jezusit si shlyerje për mëkatet e tyre.

Shenjtërim: procesi i rritjes shpirtërore që ndodh ndërsa besimtarët ia japin kontrollin e jetës së tyre Frymës së Shenjtë

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.4 mësuam se jemi shpëtuar nga mëkatet tona dhe Perëndia na quan të drejtë-suar. Megjithatë, rritja në ngjashmëri me Krishtin është një proces.

DITA 3

LEXO: FILIPIANËVE 3: 8-9

Pa Jezusin, gjithçka-arritjet e së shkuarës, suksesi, paratë, fuqia, edukimi etj,-është e pavlerë. Edhe veprat tona të 'mira' nuk na çojnë gjëkundi. Ne konsiderohemi të shfajësuar për shkak të asaj që Jezusi bëri në kryq. Drejtësia jonë gjendet në Të. Asnjë përpjekje apo punë e jona nuk na mundëson qëndrimin para Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

A mund të punosh mjaftueshëm për të qenë në rregull me Perëndinë? Përse po ose jo?

DITA 4

LEXO: FILIPIANËVE 3:10-11

Edhe pse Krishti na ka shpëtuar ne ende nuk jemi të përsosur. Proçesi i vazhdueshëm i të bërit të ngjashëm me Jezusin quhet shenjtërim. Ky proçes do të jetë i plotë vetëm kur të jemi ballë për ballë me Të.

SHTJELLOJMË:

Si je bërë më i ngjashëm me Jezusin që kur je bërë i krishterë? Si mund të bëhesh më i ngjashëm me Të në vitin tjetër?

DITA 5

LEXO: FILIPIANËVE 3:12

Pali tha se nuk ishte i përsosur, se ende nuk e kishte arritur përsosmërinë. Për ne, përsosja nuk është një standard i paarritshëm, është procesi i të bërit më shumë si Jezusi. Ne nuk kem arritur ende aty, kështu që akoma mëkatojmë. Megjithatë, mëkati nuk na kontrollon ne, Jezusi ka kontrollin tani.

SHTJELLOJMË:

Bëj një listë me gjëra që tregojnë se nuk je i përsosur. Tani bëj një listë me kërkesa lutje në bazë të listës së mëparshme. Si ndryshon jeta jote kur Jezusi ka kontrollin?

DITA 6

LEXO: FILIPIANËVE 3:13-14

Nëse do të përpiqemi të jemi si Jezusi duhet të lemë të shkuarën, sukseset dhe dështimet. Asnjëra prej këtyre nuk duhet të na pengojë të bëhemi ata që Perëndia na ka thirrur të jemi. Përqendrohu te çmimi!

SHTJELLOJMË:

Çfarë të pengon të bëhesh më shumë si Jezusi? Sukseset e tua? Dështimet e tua? Shpjego.

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Pyeti!

Bëji studentëve të tu pyetje të drejtpërdrejta (p.sh., Pra, Amy,... çfarë mendon ti?). Do ta kesh më të lehtë të bësh pyetje nëse u drejtohesh atyre me emër. Është e rëndësishme që studentët të përfshihen në diskutim. Shpesh, ne bëjmë pyetje duke shpresuar që dikush të japë një përgjigje. Ndonjëherë duhet të pyesësh drejtpërdrejt, por ki kujdes. Mos bëj pyetje të drejtpërdrejta nëse e di që një student e ka përjetuar diçka në jetën e tij. Këta studentë janë të ndjeshëm kështu që përpiqu të bësh pyetje të përgjithshme. Nuk duhet t'i vendosësh studentët në siklet duke i bërë pyetje që janë shumë personale për ta.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

A/PO KTHEHET!

Mësimi 4.5

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
1 E THESALONIKASVE 4:13-5:11

VARGJET KYÇ:

Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.

1 e Thesalonikasve 4:16-17

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

JEZUSI DO TË KTHEHET! Ai nuk u largua përgjithmonë, kur u ngjit për të qenë me Atin. Jezusi do të kthehet, por ne nuk e dimë kur do të ndodhë kthimi i Tij. Vetëm Ati e di kohën specifike të kthimit të Tij. Edhe pse të mos diturit e kthimit të Tij mund të jetë tensinuese për disa, kjo është koha që besimtarët të përgatiten për kthimin e Tij. Kur do të na vijnë familjarë për një festë apo thjesht për një vizitë, ne duhet të përgatitemi. Si besimtarë, ne duhet të përgatitemi për kthimin e Zotit tonë ashtu siç përgatitemi kur na vijnë familjarë për vizitë. Kthimi i Krishtit do të ndodhë sa hap e mbyll sytë. Krishti do të kthehet për të rrëmbyer kishën e Tij. Nuk do të ketë kohë për t'u përgatitur. Krishti nuk do të presë sa ti të bëhesh gati për kthimin e Tij. Ne duhet të jetojmë çdo ditë duke pritur kthimin e Tij. Për studentët, ky mësim do të përqendrohet në kthimin e Krishtit dhe në përgatitjen tonë për kthimin e Tij. Besoje ose jo, por mënyra si ne shohim kohët e fundit tregon shumë për zgjedhjet tona të përditshme. Studentët e tu duhet të dinë se Krishti do të kthehet, së shpejti.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Jezu Krishti do të kthehet.
- Studentët do të dinë se vetëm Ati e di kur do të kthehet Ai.
- Studentët do të dinë se të gjithë besimtarët duhet të jenë gati për kthimin e Krishtit.

FJALË KYÇ: Rrëmbim: rikthimi i Krishtit për besimtarët

MENDIM KYÇ: Jezusi po kthehet!

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Bowling top hockey (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 22, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Maratona me hoop (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 50, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Ninxhat e shërbesës. Ja një ide argëtuese për projektin e shërbesës në grupin tënd, e cila do të bashkojë gëzimin e shërbesës dhe elementët argëtues të një loje. Gjej mundësi shërbese në kishën tënde ose jashtë saj. Ndaji këto mundësi shërbese te studentët e tu ose lëri të zgjedhin vetë, por ka një kleçkë. Studentët duhet ta plotësojnë këtë projekt shërbese pa i parë askush. Ky është aspekti ninxha i këtij projekti. Është bekim t'i shërbesh dikujt pa e marrë vesh ai. Kjo gjë të jep edhe një moment të mirë mësimdhënie me studentët. Ndaj me ta që shërbesa nuk duhet të jetë gjithnjë e dukshme. Shih sa prej studentëve mund ta përfundojnë projektin e shërbesës së tyre pa i parë njeri!

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të vizatonin një rast kur u është dashur të prisnin dikë që do-nin. Filloje mësimin duke ndarë vizatimin tënd dhe trego gjithashtu historinë.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGJET KYÇ:

Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.

1 e Thesalonikasve 4:16-17

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: 1 E THESALONIKASVE 4:13-5:11

JEZUSI DO TË KTHEHET!

Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.

1 e Thesalonikasve 4:16-17

VETËM PERËNDIA E DI KOHËN.

Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s'e di, as engjëjt e qiejve, por vetëm Ati im.

Mateu 24:36

NE DUHET TË JEMI GATI.

Sa hap e mbyll sytë, në tingullin e burisë së fundit; sepse do të bjerë buria, të vdekurit do të ringjallen të paprisshëm dhe ne do të shndërrohemi.

1 e Korintasve 15:52

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Bëhu gati! Jezusi po kthehet! Kthimi i Tij është i afërt, kjo do të thotë se do të ndodhë së shpejti. Jezusi do të kthehet dhe do të kthehet për kishën e Tij. Ja disa pyetje që mund t'i mendoni me grupin:

1. Nëse do të dije se Jezusi do të kthehet nesër, a do të ishe gati?

2. A ka mundësi për të ndarë ungjillin që ti vazhdon t'i shtysh? Ndonjëherë mendojmë se kemi shumë kohë por, a kemi vërtet?

3. Çfarë duhet të bësh në jetën tënde që të përgatitesh për kthimin e Krishtit?

FJALË KYÇ:

Rrëmbim: rikthimi i Krishtit për besimtarët

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.5 mësuam se Jezusi do të kthehet.

DITA 3

LEXO: 1 E THESALONIKASVE 4:16

Jezusi po kthehet! Ai do të kthehet. Historia e Tij nuk ka përfunduar. Në fakt, historia e Tij nuk ka fund. Ai ka ende shumë gjëra për të bërë. Kur miq dhe familjarë të afërt na vijnë në shtëpi, ne presim me padurim ardhjen e tyre. Pastrojmë shtëpinë dhe rregullojmë dhomat për ardhjen e tyre. Duam të nxjerrim ushqimin tonë më të mirë dhe të lëmë një përshtypje të mirë. Pse? Sepse i duam

SHTJELLOJMË:

A je i emocionuar për rikthimin e Jezusit? I frikësuar? Indiferent? Përse po ose jo?

DITA 4

LEXO: 1 E THESALONIKASVE 4:13-15

Kur Ai të kthehet, ata që kanë vdekur dhe i kanë besuar Krishtit, do të ngrihen të parët. Jo, nuk po flasim për zombi. Zombit nuk kanë qëllim në ringjalljen e tyre të rreme. Ringjallja e tyre e neveritshme nuk ka të bëjë aspak me ringjalljen e vërtetë prej së vdekurish. Të krishterët do të rikthehen në jetë për të parë Shpëtimtarin e tyre të kthehet. Shpresa e tyre do të përmbushet. Nuk duhet të shqetësohemi nëse vdesim para se Ai të kthehet. Do të thotë thjesht se do të jemi të parët që do ta shohim Atë.

SHTJELLOJMË:

Si mendon se do të jetë pamja e ngritjes së atyre të krishterëve të vdekur që do të takojnë Zotin e tyre? Kë do të doje të shihje në atë ditë? Pse?

DITA 5

LEXO: 1 E THESALONIKASVE 4:17-18

Kur Ai të vijë, Jezusi do të na marrë që të jemi me Të përgjithmonë. Jo vetëm për pak kohë, përgjithmonë. Ja çfarë do të thotë të jesh i lumtur përgjithmonë. Nuk ka fund. Perdja nuk do të mbyllet dhe ekrani nuk do të erret.

SHTJELLOJMË:

Si do e përshkruaje shprehjen të lumtur përgjithmonë? Po sikur përjetësia me Jezusin të jetë edhe më mirë se aq?

DITA 6

LEXO: 1 E THESALONIKASVE 5:1-6

Jezusi do të vijë atëherë kur ne nuk e presim. Ai nuk do të dërgojë një ftesë me postë, nuk do të na marrë në telefon, nuk do të na dërgojë një mesazh në telefon. Ai thjesht do të shfaqet. Kështu që duhet të jemi gati. Çdo ditë e jetës tonë duhet të investohet në përgatitje për rikthimin e Mbretit tonë. Qëndrimi ynë duhet të jetë pritje e duruar.

SHTJELLOJMË:

A je gati që Mbreti të kthehet tani? Si po ndikon rikthimi i Jezusit në mënyrën si ti e jeton jetën? A duhet të ndikojë? Përse po ose jo?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Trego gishtin e madh ose telefonin!

Nëse studentët e tu marrin teknologji me vete në grup, diskutimi ndonjëherë mund të bëhet i vështirë. Më parë studentët pështpëritnin me njëri-tjetrin ose do të kalonin shënime për të shpërqendruar grupin, tani ata dërgojnë mesazhe. Mesazhet janë psherëtimat e reja. Nëse studentët marrin telefonat apo iPod-ët me vete kërkoju t'i lënë në qendër të tavolinës, me dridhje. Disa nga studentët mund t'i përdorin sepse kanë Biblën aty, prandaj mos ua merr telefonat. Nëse nuk ke shumë studentë që marrin telefonat me vete kërkoju të vendosin gishtat e mëdhenj të duarve në qendër të tavolinës në fillim. Përse? Kur studentët kanë duart në xhep ka më pak gjasa të përfshihen në diskutim. Duart e hapura janë një veprim mikpritës që do të ndihmojë studentët të përfshihen.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

Mësimi 4.6

SHPËRBLIME

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT:
2 E KORINTASVE 5:10
ROMAKËVE 14:10
ZBULESA 3:11-12

VARGU KYÇ:

Sepse ne të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit, që secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen.

2 e Korintasve 5:10

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

APOSTULLI PAL I THOTË KISHËS NË EFES JU NXIS TË JETONI NJË JETË TË DENJË PËR THIRRJEN TUAJ ... Si besimtarë, ne duhet ta jetojmë një jetë që i jep çdo ditë lavdi Perëndisë. Koha jonë këtu në tokë është e kufizuar. Çdo ditë, ne vrapojmë apo ndjekim dikë a diçka. Jemi duke vrapuar në një garë. Pali shpesh në Shkrim ka bërë krahasimin e një besimtari me një atlet që vrapon në një garë, i cili hyn për ta fituar atë garë. Si besimtarë, gara jonë në tokë do të ketë një fund. Në fund të jetës sonë do të vlerësohemi nga Jezusi për veprimet e kryera këtu në tokë. Gjërat që kemi bërë, ato që janë të pranueshme dhe të përjetshme, do të zgjasin përjetësisht. Do të marrim shpërblime dhe do të vendosim te këmbët e Jezusit. Veprimet që janë të papranueshme nuk do të zgjasin dhe do të digjen. Besimtarët duhet të jetojnë një jetë... të denjë për thirrjen sepse Jezusi po na sheh dhe na vlerëson. Ai do që veprimet dhe zgjedhjet tona t'i japin lavdi Atij dhe të zgjasin përgjithmonë. Ata që nuk besojnë, do të gjykohen sepse kanë besuar te vetja. Ata, bashkë me Satanin dhe engjëjt e tij, do të hidhen në liqenin e zjarrit, të ndarë përjetësisht nga Perëndia. Vendimet dhe veprimet tona kanë rëndësi. Ato kanë vlerë të përjetshme. Veprat tona nuk na shpëtojnë, por Perëndisë i interesojnë veprimet tona këtu në tokë.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se çdo besimtar duhet ta jetojë jetën duke kërkuar t'i pëlqejë Krishtit.
- Studentët do të dinë se besimtarët do të marrin shpërblime dhe do t'u kërkohet llogari për veprimet e tyre.
- Studentët do të dinë se jobesimtarët, satani dhe engjëjt e tij do të gjykohen dhe do të hidhen në liqenin e zjarrit, të ndarë përjetësisht nga Perëndia.

FJALË KYÇ: Tribuna gjykuese: platforma e fitimtarëve

MENDIM KYÇ: Ne do të shpërblehemi dhe do të japim llogari për gjërat që kemi bërë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Gara me bluzë (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 97, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Laj flokët (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 113, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Le të luajmë! Spitali nuk është një vend shumë argëtues, sidomos për fëmijët. Njerëzit zgjohen çdo ditë duke bërë analiza gjaku. Kalojnë shumë kohë vetëm, të shtrirë në një shtrat. Është një vend shumë i vetmuar. Ndonjëherë këta fëmijë nuk mund të dalin as nga dhomat e tyre. Ata kanë nevojë që dikush të shkojë tek ata jo vetëm për t'i inkurajuar dhe për t'u ngritur humorin, por edhe për t'u dhënë shpresë. Bëni punime, drama apo gjëra argëtuese me studentët në një spital të afërt. Kontaktoni personin përgjegjës në spital dhe caktoni një kohë ku ju dhe studentët tuaj mund të shkoni dhe të qëndroni, të bëni punime artistike dhe të gëzoni ata fëmijë dhe familjet e tyre. Kjo mund të jetë shërbesë e vështirë për disa nga studentët e tu, kështu që përgatiti përpara për gjërat që mund të shohin dhe të përjetojnë atje. Një nga gjërat më të bukura që mund të bëjmë si të krishterë është t'u sjellim shpresë dhe gëzim të gjithë njerëzve me të cilët takohemi.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **VideoClip —**
- **Inskenime —**
- **Mixer —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të përshkruanin momentin kur kanë fituar në një konkurs dhe kanë qëndruar në platformën e fituesit. Filloje mësimin duke bërë një ceremoni për ndarje çmimesh. Kjo është një mundësi e mirë për të vlerësuar studentët për gjërat që kanë bërë. Disa prej tyre mund të kenë punuar fort gjatë projekteve të shërbesës. Filloje mësimin duke vlerësuar çdo student për diçka unike që kanë bërë. Argëtohuni!

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

VARGU KYÇ:

Sepse ne të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit, që secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen.

2 e Korintasve 5:10

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: 2 E KORINTASVE 5:10; ROMAKËVE 4:10; ZBULESA 3:11-12

VRAPO PAS KRISHTIT.

Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, duke hedhur tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon vazhdimisht duke na joshur, le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh, duke i drejtuar sytë te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit, i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë.

Hebrenjve 12:1-2

FITO ÇMIMIN.

A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni.

1 e Korintasve 9:24

MOS U DORËZO!

Jezusi i tha: "Çohu, merr vigun tënd dhe ec!" Njeriu u shërua në çast, mori vigun e tij dhe eci. Atë ditë ishte e shtunë.

Gjoni 5:28-29

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Platforma e fituesit–mblidh disa kuti kartoni të përdorura për studentët. Mund të jenë copa të kutive dhe me to ndërto një platformë fituesi. Kalo copat e kutive të kartonit te studentët e tu. Jepu pak kohë të mendojnë për një apo dy gjëra që ata po bëjnë tani apo duan të bëjnë me jetën e tyre, të cilat do të jenë të pranuara dhe nuk do të hidhen në fund në zjarr. Kërkoju t'i shkruajnë te copat e kutive. (P.sh., Dua të arrij njerëz me ungjillin. Dua të ndikoj në komunitetin tim. Dua të njihem si një burrë apo grua që ndjek Perëndinë.) Pastaj, me radhë, kërkoju të ngjiten në platformën e fituesit, nëse mundesh vendos pak muzikë dhe kërkoju të ndajnë me grupin. Jepi shumë rëndësi kësaj. Përdore si një kohë për të inkurajuar studentët që të përpiqen dhe të bëjnë zgjedhje në jetën e tyre që do të zgjasin në përjetësi. Ndihmoji që të mendojnë për gjërat që duhet të zgjasin në atë ditë dhe jo të digjen.

FJALË KYÇ:

Tribuna gjykuese: platforma e fitimtarëve

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.6 mësuam se do të shpërblehemi dhe do të na kërkohet llogari për gjërat që bëjmë.

DITA 3

LEXO: EFESIANËVE 4:1

Mënyra si e jetojmë jetën si besimtarë është shumë e rëndësishme. Pali i inkurajon efesianët që të ecin denjësisht sipas thirrjes së tyre. Si besimtarë, veprat tona, gjërat që ne bëjmë, do të vlerësohen nga Zoti ynë Jezu Krisht, jo për shpëtim, por për bindje.

SHTJELLOJMË:

Si ndjekës i Krishtit, a është jeta jote një shembull që të tjerët duhet ta ndjekin? Si ecën ti denjësisht në thirrjen tënde? Cilat gjëra në përditshmërinë tënde do të ishin të pranueshme ose të papranueshme për Perëndinë?

DITA 4

LEXO: 1 E KORINTASVE 9:24

Të gjithë vrapojnë drejt diçkaje. Të gjithë ne ndjekim dikë ose diçka në jetë. Pali thotë se në një garë të gjithë vrapojnë për të kapur çmimin. Ai na sfidon të vrapojmë me qëllim për të fituar

SHTJELLOJMË:

Që po ndjek apo drejt kujt/çfarë po vrapon në jetën tënde? Kur bëhet fjalë për jetën tënde, a po vrapon me qëllim për të fituar apo je i kënaqur edhe vetëm me pjesëmarrjen?

DITA 5

LEXO: MATEU 6:19

Thesari më i çmuar është ai që zgjat përjetësisht. Arritjet e përkohshme vijnë, por nuk zgjasin. Vendimet dhe zgjedhjet që bëjmë çdo ditë do të kenë vlerë të përkohshme ose të përjetshme dhe zgjedhjet e vendimet tona kanë rëndësi.

SHTJELLOJMË:

Ku mendon se janë pjesa më e madhe e thesareve të tua? A kalon më shumë kohë dhe energji për të pasur gjërat tokësore që nuk do të zgjasin apo gjërat e përjetshme? Me cilat mendon se Krishti do të ishte më i kënaqur?

DITA 6

LEXO: ZBULESA 22:12

Ajo që thua dhe bën, ka shumë rëndësi. Gjithçka që bën dhe thua në jetën tënde shihet plotësisht nga Perëndia. Ti po vëzhgohesh dhe do të vlerësohesh. Ti i jep llogari Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

Si do të ndryshonte jeta jote duke ditur se Perëndia të sheh gjatë gjithë kohës? Çfarë s'do të bëje më? Çfarë do të filloje të bëje?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Ndryshim vendndodhjeje

Ndonjëherë ndryshimi i vendit mund të ndihmojë. Bëj një ndryshim duke i nxjerrë studentët jashtë ose ndrysho dhomën ku takoheni me grupin për disa javë. Kur krijojmë një rutinë është mirë të kemi një ndryshim që i bën gjërat interesante. Mund të takoheni edhe në një restorant apo bar të afërt. Studentët do të kënaqen, por sigurohu që mos të anashkaloni qëllimin e takimit. Fakti që ndryshoni vendndodhjen, nuk do të thotë të shmangi diskutimin.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite—**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

QIEJ TË RINJ TOKË E RE

Mësimi 4.7

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT 21-22:5

VARGJET KYÇ:

Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre. Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan."

Zbulesa 21:3-4

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

TË LUMTUR PËRGJITHMONË. Shumë njerëz nuk e besojnë këtë, por do të ndodhë. Në fund, Perëndia do të ndreqë gjithçka. Krishti ka mposhtur mëkatin dhe vdekjen përgjithmonë. Nuk do të ketë më lot, dhimbje dhe as vdekje. Do të jemi me Perëndinë përjetë. Perëndia do të krijojë qiej të rinj dhe tokë të re. Gjithçka do të jetë siç ishte më parë në kopsht. Jeta do të jetë më mirë se gjithçka që kemi imagjinuar. Nuk do të ketë nevojë për mbretër apo sundues sepse në mbretërinë e Perëndisë sundimi i përsosur i Krishtit do të zgjasë përgjithmonë. Gjithçka do të jetë e përsosur sepse do të jemi me Perëndinë.

FJALË KYÇ: Mbretëria e Perëndisë: sundimi i përjetshëm dhe i përsosur i Jezu Krishtit

MENDIM KYÇ: Perëndia do të krijojë qiej të ri dhe tokë të re. Besimtarët do të kalojnë përjetësinë me Të dhe do të jetojnë të lumtur përgjithmonë.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të dinë se Perëndia do të krijojë qiej të rinj dhe tokë të re.
- Studentët do të dinë se jeta do të jetë më e mirë se gjithçka kemi imagjinuar.
- Studentët do të dinë se do të jetojmë të lumtur përgjithmonë.

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

-
-

SEKSIONI 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimit. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqe për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 — Flickerball (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 42, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 — Cracker stacker (shih librin e lojërave AwanaYM Game Book, faqja 31, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës — Pastrimi i varrezave. Mblidhi studentët dhe gjeni një varrezë të afërt që ka nevojë për pastrim. Studentët mund të korrin barin, të heqin barërat e këqija ose të vendosin lule. Ndërsa bëni këtë, kërkoju studentëve të shohin gurët e varreve. Thuaji të venë re emrat e njerëzve në to. Kjo jetë nuk zgjat gjithmonë, të gjithë do të vdesin. Të gjithë do ta kalojnë përjetësinë diku. Kjo është mënyrë e mirë për t'u shërbyer njerëzve në komunitet, por gjithashtu jep mundësinë e një bisede interesante për të ardhmen.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë kësaj jave, studentët duhet të vizatonin pamjen që ata mendonin se kishin qiejt e rinj dhe toka e re. Ndaj edhe ti mendimin tënd me ta. Ndoshta mund të nisësh mësimin e grupit të madh duke bërë një listë të mendimeve të të gjithëve në lidhje me qiejt e rinj dhe tokën e re.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUPI I MADH)

VARGJET KYÇ:

Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre. Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan."

Zbulesa 21:3-4

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT: ZBULESA 21-22:5

PERËNDIA DO TË KRIJOJË QIEJ TË RINJ DHE TOKË TË RE.

Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar, dhe deti nuk ishte më. Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jeruzalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet. Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre."

Zbulesa 21:1-3

JETA ME PERËNDINË DO TË JETË E MREKULLUESHME!

Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndia e tyre."

Zbulesa 21:3

TË GJITHË NE BESIMTARËT DO TË JETOJMË TË LUMTUR PËRGJITHMONË!

Dhe Perëndia do të thaje çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan."

Zbulesa 21:4

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

-
-
-

SEKSIONI 3: APLIKOJE (GRUPI I MADH)

APLIKIMI

Krijo një kujtim–Ti dhe studentët e tu keni qenë në një udhëtim këtë vit. Keni ecur së bashku nëpër 32 mësime. Kalojini momentet e fundit të këtij viti dhe këtij libri duke krijuar një kujtim. Mund të jetë diçka fizike që mund ta marrin me vete. Mund të bëni një libër kujtimesh ose video me momentet e tyre të preferuara të vitit. Mund ta bësh këtë edhe si një festë të përfundimit të vitit. Mund të bëni edhe një diskutim. Bëju studentëve pyetjet e mëposhtme:

1. Cili mendim kyç ka pasur më shumë ndikim te ti këtë vit?

2. Çfarë duhet të bësh me mësimet që ke marrë këtë vit?

FJALË KYÇ:

Mbretëria e Perëndisë: sundimi i përjetshëm dhe i përsosur i Jezu Krishtit

APLIKIMI YT:

SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUPI I VOGËL)

MENDIMI KYÇ:

Në mësimin 4.7 mësuam se Perëndia do të krijojë qiej të rinj dhe tokë të re. Besimtarët do të kalojnë përjetësinë me Të dhe do të jetojnë të lumtur përgjithmonë.

DITA 3

LEXO: ZBULESA 21:1-4

Perëndia ynë, që bëri gjithçka nga asgjëja, do të bëjë gjithçka të re. Si besimtarë në Krishtin, të gjithë ne do ta shohim! Do të jemi në praninë e Perëndisë përgjithmonë. S'do të ketë më ndarje, s 'do të ketë më vetmi. Do të jemi gjithmonë bashkë. Njolla e mëkatit nuk do të njollosë më lidhjen tonë me Të.

SHTJELLOJMË:

Cilën pjesë të përjetësisë me Perëndinë e pret me padurim? Me çfarë mendon se dëshiron Perëndia të kalojë përjetësinë së bashku?

DITA 4

LEXO: ZBULESA 21:6-7

Do të jemi pjesë e familjes së Perëndisë, do të jemi me Të dhe Ai do të jetë Perëndia ynë. Do të trashëgojmë të gjitha gjërat e mira të Perëndisë.

SHTJELLOJMË:

Përshkruaj kohën më të bukur që ke kaluar me familjen tënde. Çfarë mendon se do të jetë më mirë në qiell?

DITA 5

LEXO: ZBULESA 21:9-21

Edhe nëse ke parë qytete të mrekullueshme nëpër botë, nuk ke parë asnjë të ngjashëm me këtë. Qyteti i Perëndisë do të jetë vendi më i mirë! Pse? Jezusi është atje. Nuk ka drita apo neone që na tërheqin, Krishti dhe vetëm Krishti do të ndriçojë të gjithë qytetin.

SHTJELLOJMË:

Cili është qyteti yt i preferuar në botë? Çfarë mendon se ka më të mirë qyteti i Perëndisë?

DITA 6

LEXO: ZBULESA 21:22-22:5

Ne njohim vetëm fillime dhe funde. Ne njohim një botë nisjesh dhe mbarimesh. Është e mundimshme për trurin tonë të mendojë përjetësinë. Lavdia e Perëndisë nuk do të mbarojë kurrë. Nuk do të skadojë. Lavdia e Tij do të vazhdojë përgjithmonë.

SHTJELLOJMË:

Cilën pjesë të lavdisë së Perëndisë pret me padurim? Ideja e përjetësisë të frikëson apo të gëzon?

DITA 7

CILA ËSHTË E VËRTETA QË KE MËSUAR KËTË JAVË? ÇFARË DO TË BËSH ME TË?

NDIHMË THJESHTËSUESE

Përmbylle

Arritët deri në fund! Është koha për të festuar. Cakto një kohë për festuar në fund të vitit si një grup diskutimi. Si drejtues, kjo është mundësi për ty për t'i folur studentëve. Tregoju sa shumë janë rritur. Tregoju që je krenar për ta. Mund ta përdorësh këtë kohë si mundësi për të folur për qëllimet dhe ëndrrat e vitit të ardhshëm. Çfarëdo të bësh, përdore kohën për të reflektuar për gjithçka Perëndia ka bërë në jetën e studentëve të tu gjatë këtij viti. Jepja Perëndisë lavdinë për gjithçka Ai ka bërë.

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit

PJESËT KRYESORE TË SHKRIMIT 1:6-12; VEPRAT 1:6-12; VEPRAT 2:40-47; VEPRAT 9:1-22; FILIPIANËVE 3:8-14; 1 E THESALONIKASVE 4:13-5:11; 2 E KORINTASVE 5:10; ROMAKËVE 14:10; ZBULESA 3:11-12; ZBULESA 21-22:5

VARGJET KYÇ:

Veprat 1:9; Veprat 2:42; Veprat 9:18; Filipianëve 3:12; 1 e Thesalonikasve 4:16–17; 2 e Korintasve 5:10; Zbulesa 21:3-4

SEKSIONI 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

PERËNDIA DO TË PËRMBUSHË GJITHÇKA.

Jezusi do të caktojë dishepujt e Tij në botë që të ndajnë ungjillin. Ai do të vendosë kishën e Tij si përfaqësuese këtu në botë. Për të arritur johebrenjtë, Jezusi ndryshon jetën e Palit. Një takim që ndodh ndërsa ai ishte në rrugën e tij për në Damask dhe që do të ndryshojë gjithçka. Me këtë përmbysje të botës. mësuam se besimi ynë është diçka që e kemi, por edhe që duhet të rritet dhe të piqet në ne. Ne duhet të jetojmë një jetë të denjë për thirrjen dhe të sigurohemi se ecja jonë me Perëndinë është e kënaqshme për Të sepse Ai po kthehet! Askush nuk e di kohën e kthimit të Tij, por e dimë se Ai do të kthehet. Si besimtarë do të jemi me Të dhe Ai do të vlerësojë jetën tonë. Në fund, Perëndia do të gjykojë ata që i kanë besuar vetes dhe satanit bashkë me engjëjt e tij. Ai do t'i hedhë në liqenin e zjarrit ku do të ndahen përgjithmonë nga Perëndia. Perëndia do të krijojë qiej të rinj dhe tokë të re, ku ne do të qëndrojmë me Të dhe jeta do të jetë më e mirë nga ç'e kemi imagjinuar. Nuk do të ketë më vdekje apo dhimbje! Jo më lot. Të gjithë besimtarët do të jetojnë të lumtur përgjithmonë me Perëndinë.

OBJEKTIVAT E MËSIMIT:

- Studentët do të përsërisin shtatë mësimet e fundit.
- Studentët do të përsërisin vargjet, mendimet dhe fjalët kyç të shtatë mësimeve të fundit.
- Studentët do të përmbledhin shtatë mësimet e fundit në një përmbledhje të vetme.

FJALËT KYÇ: Ngjitje, Kisha, Konvertim, Drejtësim, Shenjtërim, Rrëmbimi, Tribuna Gjykuese, Mbretëria e Perëndisë

MENDIMET KYÇ: (Shih çdo mësim)

OBJEKTIVAT E TUA:

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

•

•

•

Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët kanë pasur lojëra të ndryshme. Shiko seksionin 'Vlerësoje' dhe kërko një lojë të cilën studentët e kanë shijuar shumë dhe luajeni sërish. Nëse njëri nga projektet e shërbesës ka pasur më shumë ndikim, merrni pak kohë për të ndarë për të. Kërkoju studentëve të ndajnë një dëshmi se si ndikoi te ta kjo eksperiencë.

PLANIFIKOJE TI-ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KALIMI:

Si do t'i bësh të kalojnë nga një sjellje e rrëmujshme në gatishmëri për të mësuar dhe për t'u përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE —

- **Videoklip —**
- **Inskenime —**
- **Mikser —**
- **Adhurim —**

LAJMËRIME:

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë sot para se të largohen?
JO MË SHUMË SE DY!!!

-
-

MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim — Gjatë shtatë javëve të fundit, studentët e tu kanë mësuar shumë për shpengimin e njeriut. Ata kanë mësuar disa fjalë kyç dhe disa vargje të njohur apo të rinj. Kërkoju studentëve ta fillojnë këtë përsëritje duke treguar si i ka prekur ky kapitull. Nëse grupi është i dhënë pas artit mund t'i përmblidhni shtatë mësimet në një dramë apo skeç ku tregoni përmbledhjen e të shtatë mësimeve.

PLANIFIKOJE TI - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantim:

MËSIMI 4.1

Vargu kyç: *Mbasi i tha këto gjëra, ndërsa ata po e vështronin, u ngrit lart; dhe një re e përfshiu dhe ua hoqi prej syve të tyre. (Veprat 1:9)*

Fjalë kyç: Ngjitje: ngritje

Mendimi kyç: Jezusi u ngrit në qiell dhe përkohësisht i la dishepujt me një mision, të ndanin ungjillin nëpër botë.

MËSIMI 4.2

Vargu kyç: *Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje. (Veprat 2:42)*

Fjalë kyç: Kisha: i gjithë trupi i besimtarëve që shpallin besimin e tyre në Jezu Krishtin kudo në botë.

Mendimi kyç: Perëndia e vendosi kishën që të për-faqësonte mbretërinë e Perëndisë këtu në tokë.

MËSIMI 4.3

Vargu kyç: *Në këtë çast i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit; pastaj u ngrit dhe u pagëzua. (Veprat 9:18)*

Fjalë kyç: Konvertim: ndryshimi i plotë i besimit dhe personit

Mendimi kyç: Krishti na jep sy të rinj për të parë. Pali pati një takim jetëndryshues me Krishtin gjatë rrugës për në Damask.

MËSIMI 4.4

Vargu kyç: *Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti. (Filipianëve 3:12)*

Fjalë kyç: Shfajësim: Perëndia deklaron mëkatarët jofajtorë por të drejtë në bazë të vdekjes së Jezusit si shlyerje për mëkatet e tyre

Shenjtërim: procesi i rritjes shpirtërore që ndodh ndërsa besimtarët ia japin kontrollin e jetës së tyre Frymës së Shenjtë

Mendimi kyç: Jemi shpëtuar nga mëkatet tona dhe Perëndia na deklaron të shfajësuar. Megjithatë, arritja e ngjashmërisë me Krishtin është proces.

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT:

•

•

•

MËSIMI 4.5

Vargu kyç: *Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin. (1 e Thesalonikasve 4:16-17)*

Fjalë kyç: Rrëmbim: rikthimi i Krishtit për besimtarët

Mendimi kyç: Jezusi po kthehet!

MËSIMI 4.6

Vargu kyç *Sepse ne të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit, që secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen. (2 e Korintasve 5:10)*

Fjalë kyç: Tribuna gjykuese: platforma e fitimtarëve

Mendimi kyç: Ne do të shpërblehemi dhe do të japim llogari për gjërat që kemi bërë.

MËSIMI 4.7

Vargu kyç: *Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre. Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan." (Zbulesa 21:3-4)*

Fjalë kyç: Mbretëria e Perëndisë: sundimi i përjetshëm dhe i përsosur i Jezu Krishtit

Mendimi kyç: Perëndia do të krijojë qiej të ri dhe tokë të re. Besimtarët do të kalojnë përjetësinë me Të dhe do të jetojnë të lumtur përgjithmonë.

SHËNIME:

FILLONI:

- Cila gjë apo koncept të ka mbetur në mendje gjatë shtatë javëve të fundit?
- Përse është i rëndësishëm për ty ky koncept?

JAVA 1

LEXO: VEPRAT 1:9

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Si po e shpall ungjillin si Jezusi udhëzoi dishepujt?

JAVA 2

LEXO: VEPRAT 2:42

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Pse është kisha e rëndësishme? Çfarë duhet të bëj kisha?

JAVA 3

LEXO: VEPRAT 9:18

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Si e njohe Jezu Krishtin? A po u tregon të tjerëve historinë tënde dhe historinë e Perëndisë?

JAVA 4

LEXO: FILIPIANËVE 3:12

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Si po rritet besimi yt?

JAVA 5

LEXO: THESALONIKASVE 4:16-17

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Si po përgatitesh për kthimin e Krishtit?

JAVA 6

LEXO: 2 E KORINTASVE 5:10

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Çfarë është platforma e fituesit? Çfarë do të bëjmë me shpërblimet që do të marrim?

JAVA 7

LEXO: ZBULESA 21:3-4

SHTJELLOJMË:

- Përshkruaj gjënë më të rëndësishme që more nga ky mësim.
- Kur bëhet fjalë për qiejt e rinj dhe tokën e re, çfarë pret me padurim?

VLERËSIMI:

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- **Përgatite —**
- **Luaj —**
- **Mësoje —**
- **Diskutoje —**

NDJEKJA:

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, informacionet e kontaktit të studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

Data	Emri	Kërkesat/ Ngjarjet/ Informacionet e kontaktit